

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE

NUMËR 337 • VITI 32 • DHJETOR 2018 • REBIUL AHIR 1440 • ÇMIMI 1 €



URIME USHTRIA KOSOVË!

Urimi i Myftiut Tërnavë për Ushtrinë e Kosovës nga Qabeja e bekuar


“Në këtë ditë të bekuar të xhumasë, në vendin më të bekuar në tokë, nga Meka fisnike e nën hijen e Qabesë, kibles së besimtarëve myslimanë, uroj qytetarët dhe institucionet e Kosovës, si dhe mbarë kombin tonë për formimin e ushtrisë së vendit tonë. Kjo ditë është e bekuar dhe e zgjedhur, teksa po bëjmë edhe hapin më të madh pas aktit të shpalljes së Pavarësisë, pra themelimin e Ushtrisë së Kosovës, e cila do të jetë gjithmonë forcë për ruajtjen e paqes dhe e cila nuk do të paraqesë rrezik për asnjë popull dhe vend fqinj, por do të jetë vetëm siguri për të gjithë. Nga Qabeja e bekuar, me duar të ngritura nga qielli, i drejtohem Allahut të Gjithmëshirëshëm që ta bekojë e ta ruajë Ushtrinë e Kosovës. O Allah i Gjithëpushtetshëm, bashkoji zemrat e popullit tonë dhe zemrat e prijësve tanë në atë që Ti je i kënaqur, për hir të gjithë atyre dëshmorëve që dhanë jetën e tyre për këtë ditë të madhe! Qofsh e bekuar përjetësisht, Ushtria e Kosovës!”

*Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë
Meke, 14.12.2018*



Në këtë numër:

- 2 Urimi i Myftiut Tërnavë për Ushtrinë e Kosovës nga Qabeja e bekuar
- 2 Editorial
- 5 Fjala e Myftiut Tërnavë në konferencën islame globale "Uniteti Islam – Rreziqet e etiketimit dhe të përjashtimit"
- 7 Islami fe e vlerave dhe e virtyteve
- 9 Komentimi i kaptinës "El-Hashr" – (7)
- 13 PIKËPAMJE TË ETIKËS ISLAME
- 17 A lexohet pas imamet në namaz?
- 18 Pejgamberi a.s. dhe të tjerët
- 23 Si kontribuon zekati në ndërtimin e ekonomisë së fortë kombëtare (1)
- 26 Trajtimi juridik islam rreth shitblerjes me kapar
- 28 Thirrja dhe prioritetet në metodologjinë e pejgamberëve (1)
- 31 Kosova e viteve të 70-ta. Si duhet të shkruheshin tekstet shkollorë
- 34 Revista "Zani i Naltë" rreth trajtimit të gruas
- 36 A po i kushtohet rëndësi trashëgimisë kulturore islame në Kosovë?!
- 39 Lajkomania - a jeni të preokupuar me rrjetet shoqërore?
- 42 Besimi në botën e ahiretit si motiv për një jetë më të mirë
- 44 Ruajtja e sigurisë dhe rëndësia e saj fetare e shoqërore
- 46 Poezi
- 48 Aktivitete
- 63 Konkurse
- 65 Fjalëtërthore



DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Ahmet Sadriu, mr. Ramadan Shkodra,
mr. Azmir Jusufi, Mustafë Hajdari,
mr. Ejup Haziri, mr. Vaxhide Bunjaku,
mr. Vedat Shabani dhe dr. Valon Myrta.

Sekretar në redaksi:

Mr. Rexhep Suma

Lektor & Korrektore:

Ilmi Rexhepi

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024
email: dituriaislame@hotmail.com
dituriaislame@yahoo.com
www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €
Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Iliri", Prishtinë

Dorëshkrimet dhe fotot nuk kthehen!



“Thuaj: “Ejani t’ju lexoj atë që me të vërtetë ju ndaloj Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i vritni fëmijët tuaj, për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë juve dhe ata, të mos iu afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e vritni njeriun, sepse vrasjen e tij e ndaloj Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoji thellë...”

(El Enam, 151- 154)

Përkushtimi ndaj virtytit dhe përsosjes morale

Islami respekton të drejtat e njeriut duke përfshirë lirinë e ndërgjegjes apo të drejtën për të jetuar sipas besimit të tij fetar dhe nxit rolin e zgjeruar të fesë në shoqëri. Nga socializmi dhe rryma ateiste modelimi i jetës së njeriut nga feja u pa si regresiv, antimodern dhe një tërheqje në mesjetë. Rryma të ndryshme e zbritën fenë në stokun e besimeve tradicionale, të vlefshme për sa i përket së shkuarës, por si anakronike për të sotmen apo si pengesë për zhvillimin modern politik, ekonomik dhe atë shoqëror. Ato proklamojnë një jetë me sjellje pa referencë hyjnore dhe pa një botë të pasosur.

Kurani nuk bën dallim mes çështjeve temporale dhe spirituale. Ligjërimi filozofik perëndimor (iluminizmi) ka proklamuar lindjen e njeriut të natyrsbëm, që është pa origjinë hyjnore, në mënyrë të bashkëlindur si i mbarë dhe i përmirësueshëm, vetë shpjegues dhe i vetëmjaftueshëm.

Njeriu, duke jetuar ekskluzivisht brenda temporalitetit (përkohshmërisë) të tij, nuk është veçse një ujk për njeriun dhe bota nuk është asgjë tjetër veçse një xhungël e drejtuar nga forca kafshërore (Hobs). Temporaliteti i vërtetë do të thotë liri nga vlera dhe qëllimi (Niçja).

Krejt ndryshe, Islami është një sistem i përgjithshëm moraliteti dhe dijeje, që mund të përballojë dhe të zgjidhë çdo situatë njerëzore me përgjigje kuptimplotë. Modernizimi i rremë është manifestuar në rrënimin e shoqërisë dhe në rindërtimin e saj në baza jo fetare.

Zbatimi i mësimave islame në sjelljet e një myslimani nuk është vetëm qetësim i ndërgjegjes, por, mbi të gjitha, një akt adhurimi për të fituar kënaqësinë e Krijuesit. Ndikimi i fesë në sjelljet e individit është një fenomen shoqëror në shoqërinë myslimane.

Myslimani nuk është i lirë që të mos përfillë rregullat morale dhe të rebelohet kundër vlerave të vendosura hyjnore. Qasja shekullore ka theksuar hedhjen poshtë të traditës dhe shpëputjen e të gjitha lidhjeve me të kaluarën, gjë që cenon kohezionin e shoqërisë. Ajo mbron ide dhe vlera të reja të bazuara ekskluzivisht tek arsyeja dhe të paidentifikuara nga feja dhe tradita.

Islami është fe e monoteizmit të pastër që vendos drejtësinë dhe ofron shembullin e mirë. Shoqëria është në zgrip të një krize të brendshme të thellë që mund të çojë në një gjendje barbarizmi veçanërisht nëse nuk frenohet rritja e kriminit, e narkomanisë dhe e dhunës, që kanë depërtuar tek të rinjtë.

Sjelljet e myslimanit duhen të përshkohen në të gjitha manifestimet e tij me ngjyrimet islame. Komuniteti mysliman, si një komunitet fetar i vetëpërcaktuar, është së paku në teori një komunitet i një “devocioni të pakompromis ndaj virtytit”. Komuniteti mysliman i vë veshin gjithnjë imperativit etik. Feja përcakton frymën dhe identitetin e njerëzve.

Të gjithë të dërguarit e Zotit, predikimet dhe metodat e tyre edukuese, i kanë filluar me ‘JO’ ose ‘Mos’. Kjo ‘JO’ apo ‘MOS’, i porosit njerëzit që të kenë kujdes në bërjen e veprimeve të tyre, sepse njeriu përjeton pakrahueshmërisht më shumë fatkeqësi nga bërja e disa veprimeve prej tij, sesa nga mosbërja e tyre. Më shumë lot njerëzimi ka derdhur nga pasojat e asaj që ka bërë, se sa të asaj që s’e ka bërë. Gjithnjë feja e Zotit, gjatë gjithë historisë, që nga i dërguari i parë i Zotit, Ademi a.s., e deri tek i dërguari i fundit, Muhammedi a.s., është bazuar në ndalesat që i ka bërë njeriut. Në dhjetë porositë kuranore, shumica e tyre janë ndalesa. Këto ndalesa, nuk janë bërë me qëllim që ta denigrojnë qenien njerëzore, por përkundrazi që ta lartësojnë dinjitetin e tij dhe ta çojnë atë drejt përsosjes morale.

Dr. Ajni Sinani

Fjala e Myftiut Tërnavë në konferencën islame globale “Uniteti Islam – Rreziqet e etiketimit dhe të përjashtimit”



*Të nderuar ministra, myftinj, ulema!
Të nderuar të pranishëm!*

Me lejon që, në fillim, të falënderoj kujdestarin e dy xhamive të shenjta, mbretin Salman bin Abdulaziz Al Saud për bujarinë e tij për mbajtjen në patronazhin e tij të kësaj konference të rëndësishme dhe princin e kurorës Mohammed bin Salman bin Abdulaziz Al Saud, duke lutur Allahun t'i shpërblejë me shpërblimin më të mirë për përpjekjet, mbështetjen dhe punën e tyre të vështirë për të bashkuar fjalën e myslimanëve dhe për të realizuar unitetin e ummetit islam.

Dëshiroj të falënderoj sekretarin e përgjithshëm të Lidhjes Botërore Islame, shkëlqesinë e tij dr. Mohammed bin Abdul-Karim Al-Issa për përpjekjet e tij të fisme e të vazh-

dueshme për të përhapur vlerat fisnike islame para të gjitha kulturave dhe në mbarë botën.

Të nderuar vëllezër, kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju drejtohem me këtë fjalë të shkurtër.

Unë nuk jam këtu për të folur për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e unitetit islam nga aspekti fetar. Kjo temë është trajtuar nga studiues dhe ulema të shquar dhe ata e kanë zgjeruar dhe pasuruar atë me njohuri, gjë që nuk është e panjohur për ju. Të gjithë ju jeni të informuar për këtë.

Por këtu do të doja, nga realiteti i përgjegjësisë sime dhe përvojës praktike, të ndaja me ju disa mesazhe përçarjen e të cilave synon dhe shpreson konferenca jonë. Sikurse është e njohur për ju në këtë kohë bashkëkohore, ne duhet të unifikojmë fjalën tonë, të bashkojmë radhët

tona dhe t'ia ofrojmë fenë tonë dhe trashëgiminë islame gjithë botës. Kjo, ngase kështu na urdhëron Allahu i lartësuar: “Kapuni të gjithë për litarin (librin) e Allahut e mos u përçani!”

Roli i dijetarëve dhe i hoxhallarëve ka qenë dhe është që t'u përmbahen gjithnjë mësimave islame dhe bazave të fesë, të fokusohen në dashurinë e Zotit, duke përhapur kështu dashurinë mes njerëzve, pavarësisht nga ngjyra, gjuha dhe besimi, duke kultivuar në shoqëri dashuri, respekt dhe lumturi. Braktisja e vlerave fetare dhe mungesa e predikimit dhe e zbatimit të tyre bëjnë që komunitetet të keqkuptojnë njëri-tjetrin, duke përfunduar në urrejtje dhe armiqësi.

Falë Allahut, Bashkësia Islame e Kosovës në mënyrë permanente ka pasur parasysh ajetin kuranor: “Kapuni të gjithë për litarin (librin) e Al-

lahut, e mos u përçani". Prandaj, në Bashkësinë Islame gjejmë të punësuar dhe nëpunës të diplomuar nga universitete të ndryshme islamike që nga Lindja e largët në botën islame e deri në Perëndim. Bashkësia Islame e Kosovës ka rreth 2000 punonjës me funksione të ndryshme, sikurse janë imamë, predikues, myezinë, profesorë, mësues, edukatorë dhe administratorë. Bashkësia Islame e Kosovës ka qasje gjithëpërfshirëse dhe jo përjashtuese.

Interpretimet e gabuara dhe mashtruese të mësimave fetare islame nga individë apo grupe jozyrtare, nga të paaautorizuar e nga të indoktrinuar, që u shërbejnë agjendave të caktuara, përbëjnë një nga faktorët më të rrezikshëm dhe një nga shkaqet kryesore të përjashtimit dhe ekstremizmit. Pavarësisht nga vështirësitë dhe sfidat me të cilat u përball Bashkësia Islame e Kosovës para, gjatë dhe pas luftës, ajo shfrytëzoi të gjitha mundësitë e saj dhe bëri përpjekje të mëdha për ngritjen e vetëdijes fetare të qytetarëve në tërë Kosovën. Ajo paralajmëroi dhe alarmoi për seriozitetin dhe rreziqet e etiketimit (diferencimit) dhe përjashtimit dhe tregoi rëndësinë dhe nevojën e unitetit dhe veprimit nën ombrellën e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në historinë tonë, dijetarët dhe hoxhallarët shqiptarë kanë paraqi-

tur modelet më të mira për ruajtjen e unitetit të kombit shqiptar në përgjithësi, qoftë fetar apo kombëtar. Ata gjithnjë kanë qenë thirrës për unifikimin e fjalës dhe për mosdiskriminim. Hoxhallarët ofruan modelet më të mira për koekzistencën e besimeve të ndryshme fetare të popullit shqiptar. Kjo është një vlerë që ne e çmojmë dhe që na bën krenarë.

Duke pasur parasysh se Kosova është një shtet me shumicë myslimane me 95 për qind, ajo përballë me më shumë sfida se çdo vend tjetër në Ballkan. Prandaj, institucionet zyrtare fetare kanë nevojë për mbështetje në zbatimin e programeve të tyre për të unifikuar komunitetin mysliman dhe për t'u përballur me rreziqet e etiketimit (diferencimit) dhe të përjashtimit. Kjo është gjendja e të gjitha bashkësive islame në Ballkan.

Këto takime të bereqetshme me nivel kaq të lartë në këtë vend të bekuar, duhet të na japin një shtysë të fortë për të bërë edhe më shumë përpjekje për të përhapur kulturën e gjithëpërfshirjes në shoqëritë tona dhe për të sensibilizuar kundër etiketimit dhe përjashtimit që çojnë në ekstremizëm dhe radikalizëm.

I bëj thirrje kësaj konference të rëndësishme që të ndërmarë hapa konkretë për adresimin e këtyre dukurive negative që i vishen fesë

islame. Për rrjedhojë, e quaj dhe e theksoj si të domosdoshme nevojën që të bashkëpunohet dhe që të mbahen raporte me institucionet zyrtare përgjegjëse për zhvillimin e çështjeve fetare në vendet e Ballkanit, përkatësisht me bashkësitë islame.

Nga ky podium pranë Qabesë së bekuar, u bëj thirrje qeverive në vendet myslimane dhe madje edhe në vendet jomyslimane që të punojnë me rekomandimet që dalin nga konferenca e RABITAS (Lidhjes Botërore Islame), që bëjnë thirrje për unitetin e myslimanëve dhe për paraqitjen e një imazhi të ndritshëm të fesë sonë të vërtetë në forume të ndryshme ndërkombëtare.

Pa dyshim se është e dukshme përpjekja e madhe nga sekretari i përgjithshëm i RABITAS për ta sendërtuar këtë objektiv, andaj e lus Allahun e Plotfuqishëm ta ndihmojë dhe ta bekojë atë në hapat dhe përpjekjet e tij.

Në fund, më lejoni që ta falënderoj edhe një herë dhe të shpreh konsideratat e mia për Mbretërinë e Arabisë Saudite për përpjekjet e saj të vazhdueshme për të bashkuar fjalën e myslimanëve.

*Myftiu Naim ef. Tërnavë
Mekë, 12 dhjetor 2018*



Hytbe e Myftiut Tërnavë në Podujevë

Islami fe e vlerave dhe e virtyteve



Mirësitë e Islamit

Islami është feja që Zoti zgjodhi për njerëzimin. Është fe e përsosur në mësim dhe porosi, fe që objektiv kryesor ka ruajtjen e dinjitetit dhe shpëtimin e njeriut, krijesës më të rëndësishme të Zotit. Në Kuran dhe Sunnet kemi tekste të shumta që na flasin për mirësitë e Islamit dhe mësimet e tij madhështore.

Allahu thotë:

﴿الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا﴾

“...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj...” (El Maide: 3)

Në këtë ajet, Allahu na tregon se feja islame është përsosur e plotësuar, që nënkupton se normat, mësimet dhe këshillat e tij janë po kështu të përsosura. Për këtë shkak, Zoti do që Islami të jetë feja e robërve të tij.

Islami është feja e përsosur në:

- Besim, sepse është fe mono-teiste, fe që besimin e parashtron në mënyrë racionale, fe që dijen e përshkruan si çelës kryesor të besimit, fe që urdhëron besimin në të gjithë pejgamberët, fe që bën thirrje për bashkimin e të gjithë njerëzve nën hijen e fjalëve të Zotit...

- Adhurime, sepse urdhëron që adhurimet t'i përkushtohen vetëm Allahut, adhurimet të kenë mision

dëllirjeje dhe pastrimi shpirtëror, fe që namazin e sheh si ndalues nga mëkatet, agjërimin si frenues prej tyre, zekatin si solidaritet që nuk zhduk vetëm varfërinë, por edhe koprracinë, urrejtjen, smirën, haxhin si pastrim të tërësishëm...

- Moral, sepse gdhendjen e tipareve dhe formësimin e tyre e ka caktuar si mision. I Dërguari i Allahut, Muhammedi a.s. ka thënë: “Jam dërguar për përsosjen e virtyteve të moralit.”

- Marrëdhënie shoqërore, pasi që besimtarët i paraqet në raport me njëri-tjetrin si gjymtyrët e trupit për njëra-tjetrën, si pasqyrë ku ne shohim veten duke parë të tjerët...

Islami është feja e natyrshme e koso-varëve

Kanë qenë pikërisht këto mësimet ato që kanë shtyrë njerëzit anembanë botës t'i përgjigjen me të madhe kësaj feje dhe të vazhdojnë pandërprerë. Islami është feja ku secili gjen krenarinë dhe dinjitetin; mashkulli dhe femra, burri dhe gruaja, i riu dhe i vjetri, i devotshmi dhe mëkatari...Po, Islami ka barazuar mashkullin dhe femrën, duke caktuar që vlera të mos përcaktohet nga gjinia, siç kanë qenë deri në kohën kur është shfaqur ai, në vlera dhe virtyte. Allahu thotë:

﴿إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ﴾

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...” (El Huxhurat: 13)

Islami ia rikujton burrit se gruaja nuk është plaçkë, nuk është mall që blihet e shitet, nuk është robëreshë, por është shenjë e ekzistimit të Zotit dhe vend ku mashkulli, para çdo gjëje tjetër absolutisht, gjen prehjen shpirtërore.

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً ۚ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ﴾

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Er Rrum: 21)

Islami është feja që respektimin e prindërve e ka ngritur në nivel të adhurimit për Zotin, sikur që respektimin e të rinjve e ka bërë imazh dallues të tij. Allahu thotë:

﴿وَاَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا ۚ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا﴾

“Adhuroni Allahun dhe mos i shohëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit...” (En Nisa: 36)

Pejgamberi Muhamed a.s. ka thënë: “Nuk është prej nesh (nuk na përfaqëson ne dhe as mësimet tona) ai që nuk nderon të vjetrin dhe nuk mëshiron të riun.”

Islami ngre të devotshmin, por edhe mëkatari i hap derën e pendimit. Ja çfarë thirrje të bukur Zoti u drejton mëkatarëve:

﴿قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَى أَنْفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِنْ رَحْمَةِ اللَّهِ ۚ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا ۚ إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ﴾

“Thuaj: “O robërit e Mi që i keni bërë keq vetes me gjynahë, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (Ez Zumer: 53)

Këto vlera madhështore i kanë shkuar shtati karakterit të popullit tonë, andaj në masë të madhe u janë përgjigjur atyre. Krenaria, guximi, mikpritja, besa, nderi dhe sakrificat, si virtyte të njohura historikisht të shqiptarëve, krejtësisht natyrshëm i janë përgjigjur thirrjes hyjnore, dhe si rezultat kemi këtë pranim masiv të fesë islame nga shqiptarët. Jo vetëm historikisht, por edhe nga vetë prizmi i mësimetve islame, pranimi i fesë nuk mund të ketë ndodhur ndryshe veçse si përgjigje e natyrshme. Kjo sepse Zoti e ndalon që dikujt t'i imponohet feja.

Së këndejmi, Islami është bërë sinonim edhe i kulturës dhe i vlerave tona. Islami është bërë identitet yni me të cilin jemi krenarë. Islami do të jetë identiteti i këtij populli, i pëlqeu dikujt apo jo. Sikur që nuk i shesim vlerat tona, nuk e shesim as fenë. Është gjëja më e çmuar që kemi.

Islami dhe ekstremistët, dy botë të kundërta

Të kthehemi te përsosmëria e fesë.

Islami është fe e përsosur në ligje, norma dhe mësimet. Kjo nënkupton se askush nga njerëzit, kushdo qoftë ai, nuk ka të drejtë të fusë duart e t'i bëjë ligjet e normat sipas mënyrës së vet. Kjo nënkupton po kështu se edhe interpretimet që u bëhen mësimetve të Islamit nuk kanë legjitimitet përderisa nuk pajtojnë me objektivat e tij, pavarësisht nëse interpretuesit pretendojnë se po mbështeten në Kuran apo Sunnet. Islami është ashtu siç do Zoti, jo siç duan njerëzit. Islami është feja e shpallur nga Zoti për të realizuar të mira, shpirtërore e materiale, për të ofruar siguri e paqe, për të nderuar e jo denigruar krijesën më të dalluar të Zotit, njeriun, andaj, çdokush që vepron në kundërshtim me këta objektiva, ai ka vepruar në kundërshtim me Islamin.

Porosia

Nga ana ime, si kryetar dhe Myfti juaji, do të mundohem që, me përgjegjësinë më të madhe, të punoj që të ruajmë këto vlera fetare e kombëtare, ta ruajmë paqen dhe sigurinë, të jemi sa më pranë besimtarëve tanë me këshilla, udhëzime, ndihma materiale, të punojmë dhe bashkëpunojmë me të gjithë që vendin, të cilin Zoti na e zgjodhi për të lindur e për të jetuar, ta çojmë përpara.

Në fund, më lejoni që t'i drejtohem me lutje të Madhit Allah që ta begatojë popullin dhe vendin tonë me mirësi e begati, me siguri e stabilitet, me paqe e harmoni!

Podujevë, 22 dhjetor 2018

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës “El-Hashr” – (7)

Madhështia e Kuranit dhe disa nga Emrat e bukur të Allahut

“Sikur ta zbrisnim (shpallnim) këtë Kuran mbi ndonjë kodër (mal), ti do ta shihje atë (kodër) të përulur e të bërë thërriime nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne u sjellim njerëzve, që ata të mendojnë. Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Njohësi i së padukshmes dhe i së dukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!- (El-Hashr, 21-22)

لَوْ أَنزَلْنَاهُ هَذَا الْقُرْآنَ عَلَى جَبَلٍ لَّرَأَيْنَاهُ خَاشِعًا مُّتَصَدِّعًا
مِّنْ خَشْيَةِ اللَّهِ ۚ وَتِلْكَ الْأَمْثَالُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ
يَتَفَكَّرُونَ ﴿١٢﴾ هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ عَالِمُ
الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ ۚ هُوَ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ ﴿٢٢﴾

Vlera e ajeteve 21-24

Në lidhje me vlerën e këtyre ajeteve, i Dërguari i Allahut s.a.v.s., ka thënë: “Kushdo prej jush, kur të zgjohet, thotë tri herë: “Eudhubil-lahi es-Semiil Alim mine shejtani rraxhim”-“Kërkoj mbrojtjen e Allahut, Dëgjuesit dhe të Gjithëdijshtit nga cytjet e shejtanit të mallkuar”, dhe i lexon tri ajetet e kaptinës “El-Hashër” (22-24): “Ai është Allahu, përveç të

Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Njohësi i së padukshmes dhe i së dukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! Ai është Allahu përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Sundues i përgjithshëm, I Pastër (prej të metave që i mvishen), Shpëtimtar (që shpëton njerëzit prej ndëshkimit), Sigurues (që siguroi njerëzit me premtimin e vet dhe peygamberët me mrekulli), Mbikëqyrës (që mbikëqyr dhe përcjell çdo send), I Plotfuqishëm, Mbizotërues, I Madhërishëm. I

Lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë! Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi Formëdhënësi. Të Tij janë emrat më të bukur. Atë (Allahun) e madhëron çka në qiej e në Tokë dhe Ai është Ngadhënjyesi, I Urti”, Allahu do t’i autorizojë 70 mijë meleke-engjëj që të luten për të, derisa të ngriset (të vijë mbrëmja), dhe në qoftë se ai person vdes gjatë asaj dite, ai vdes si shehid (dëshmor), dhe po ashtu ai që i thotë këto fjalë kur të bjerë në gjumë, e ka të njëjtën gradë (derisa të zgjohet)”



Lidhja e këtyre ajeteve me ato paraprake

Pasi që Allahu xh.sh. në ajetet paraprake sqaroi gjendjen e hebrenjve dhe të mynafikëve, i urdhëroi myslimanët me devotshmëri dhe frikë-respekt ndaj Tij, në mënyrë që të përgatiten për Ditën e Vështirë të Gjykimit. I Lartmadhërishtmi, po ashtu tërhoqi vërejtjen, se ai që e “harron” Zotin, Ai do t’i bëjë ta harrojnë edhe vetveten, duke u preokupuar e harlisur pas kësaj dynjaje, e duke e lënë pasdore udhëzimin e Kuranit famëlartë. Mbase pikërisht, tash në vazhdim të këtyre ajeteve, Allahu xh.sh. e madhëron çështjen e Kuranit fisnik, edhe nëpërmjet shembujve që mund të jenë alegorikë, por edhe të vërtetë, se po t’i zbriste ky Kuran, ndonjë kodre, ajo do të kërrusej e thërrmohej nga frika e Allahut fuqiplohtë. Ndërkohë, ajetet e fundit të kësaj sureje, kanë përshkruar disa nga Emrat e bukur të Allahut dhe cilësitë e Tij, të cilët emra shpërfaqin madhësitinë e Tij absolute, duke e zhveshur Atë nga çdo mangësi, që nuk përkon me Larmadhërinë e Tij.

Koment:

21. Sikur ta zbrisnim (shpallnim) këtë Kuran mbi ndonjë kodër (mal), ti do ta shihje atë (kodër) të përulur e të bërë thërrime nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne u sjellim njerëzve, që ata të mendojnë.

Kurani famëlartë, si dritë udhëzimi, synim kryesor ka që njerëzit t’i nxjerrë nga errësira e injorancës, në dritën e së vërtetës. Në ajetet e tij, ka shembuj e mësimë për njerëzimin, që të mos ngarendin pas kotësive, por të lidhen për parime të shëndosha, të cilat ua përmirësojnë jetën në këtë botë, dhe i bëjnë fitues edhe të shpërblyeve të përjetshme të Ahiretit.

Vetëm me emrin Allah plotësohet dëshmia islame e cila është “La ilahe ila Allah, Muhammedun resulullah”. Me këtë emër të lartë hyjnor, fillojmë çdo punë, dhe me këtë emër hapen kapitulat e Kur’anit, do të thotë me (Bismil-lahi Rrahmani Rrahim).

Në kohën, kur Kurani i zbriste të Dërguarit a.s., kurejshët, skajshmërisht i injoronin ftesat hyjnore nga ana e të Gjithëmëshirshmit. Zemrat e tyre ishin të ngurta dhe të ngulfatura nga mosbesimi. Thjesht, tek zemrat e një shumice prej tyre, drita e udhëzimit, me vështirësi po depëronte. Mbase për këtë arsye, Allahu xh.sh. Ua solli këtë shembull, që t’ua bëjë më dije, se po t’ia zbriste këtë Kuran një kodre të madhe, do ta shihje ti o Muhamed, por do ta shihnin edhe të tjerët, se si do të kërrusej, përulej e copëtohej ajo nga frika dhe respekti ndaj Allahut, sepse edhe kodra është një krijesë e nënshtruar ndaj Tij. Në lidhje me përkuljen dhe sexhden e kodrave ndaj Allahut, dhe se si nga brendia e tyre gufojnë lumenj që rrjedhin rrëqe, na ka dëftuar Allahu xh.sh. në Kuran kur thotë:

“O male dhe shpezë, lartësoni (me tesbih) së bashku me të (Davudin)!” - (Es-Sebe’ë, 10)

“... Ka nga gurët prej të cilëve gufojnë lumenj, e ka disa prej tyre

që çahen dhe prej tyre buron ujë, madje ka prej tyre që nga frika ndaj Zotit rrokullisen tatëpjetë (nga maja e kodrës)” - (El-Bekare, 74)

Ja, kësi shembujsh u sjell Allahu njerëzve të paudhëzuar, në mënyrë që ata të mendojnë e meditojnë. Vetëm në këtë mënyrë, mbase mendja mund të motivohet që të logjikojë me arsye të shëndoshë, dhe ta gjejë rrugën e udhëzimit, në të cilën e fton Allahu i Gjithëmëshirshëm.

22. Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Njohësi i së padukshmes dhe i së dukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!

Prej këtij ajeti, e deri në fund të sures El-Hashr, kemi të përmendur 16 emra të bukur të Allahut, të cilat ajete, kanë përmbledhur gati numrin më të madh të këtyre emrave hyjnorë. Besimtari jeton nën hijen e këtyre emrave të bukur, sepse afrimi tek Allahu është caku dhe synimi i secilit prej nesh, sepse vetë Allahu xh.sh. thotë: “Allahu i ka emrat më të bukur (mirë), prandaj Atë thirrni me ta” - (El-A’ëraf, 180).

Dijetarët, pa dallim, janë unikë rreth faktit se këta emra të bukur të Allahut, në të vërtetë janë cilësi të Tij, me të cilat Ai e ka cilësuar dhe përshkruar Vetveten.

Prej këtyre emrave-cilësive ka të tillë që përshkruajnë Madhësitinë e Tij si: El-Adhim-Madhështori, El-Muteali-I Gjithëlartësuar, El-Mexhid-I Lavdishmi, El-Kud-dus-I Pastërti, Dhul Xhelali vel Ikram-Atij i takon madhështia dhe nderi. etj.

Pastaj ka prej këtyre emrave që dëftojnë për kreativitetin e Tij si Krijues: El-Bari-Shpikësi-Filluesi i krijimit, El-Musavviru-Formëdhënësi, El-Haliku-Krijuesi, El-Bedi-Shpikësi, etj.

Ka cilësi të tjera që përshkruajnë fuqinë e Tij hyjnore si: El-Kavijj-I Forti, El-Kadir-I Fuqishmi, El-Kahhar-Mposhtësi, El-Muhejmin-Mbizotëruesi etj.

Pastaj ka të tilla që përshkruajnë dhe shprehin diturinë dhe urtësinë e Tij hyjnore si: El-Aliim-I Gjithdijshmi, El-Hakim-I Urti, El-Habir-I Gjithëinformuari, etj.

Ndërsa ka prej këtyre emrave që përshkruajnë mëshirën dhe butësinë e Tij ndaj robërve të Tij si: Er-Reuf-I Dhembshuri, Er-Rahman-I Gjithëmëshirshmi”, Er-Rahim-Mëshirëploti, El-Gafur-Falësi, El-Halim-Përdëllimtari, Et-Tevvab-Pendimpranuesi, El-Letif-I Buti, etj, por, që të gjithë këta emra-cilësi, edhe pse në dukje mund të kenë ngjashmëri me disa cilësi që i posedojnë edhe krijesat, assesi nuk mund të krahasohen me cilësitë e tyre, sepse Allahu është i Vetmi Zot i kësaj gjithësie, në sundimin e të Cilit nuk mund t’i përzihet askush. As nuk ka shok e as të ngjashëm me Të: “Asnjë send nuk është si Ai...” (Esh-Shura, 11)

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim)...”

Ky ajet, si edhe dy ajetet e tjerë në vazhdim të sures, fillojnë me përmendjen e emrit “Allah”, emër i cili dëfton për Qenien Absolute, dhe me të cilin përfshihen të gjitha cilësitë dhe atributet e tjera hyjnore të Tij. Sipas shumë dijetarëve, ky emër simbolizon edhe emrin më të madh e më të bukur të Tij, sepse është më gjithëpërfshirësi dhe më madhështori nga të gjithë emrat e tjerë të Zotit.

Ky është njëri prej mendimeve më të forta dhe më të pranueshme nga dijetarët, sepse ky emër përmban vërtet shenjtërinë hyjnore. P.sh., kur të përmendet i vetëm, është “Allah”, nëse i hiqet elifi i parë, prapë mbetet “Lil-lah”- “Për Allahun”, nëse hiqet lami i parë, mbetet “Lehu”- “I Tij”, po nëse hiqet edhe lami i dytë, prapë mbetet “Hu” ose “Huve”- “Ai”.

Transmetohet nga Aishja r.a. se një ditë i Dërguari i Allahut xh.sh. i kishte thënë asaj: “Oj Aishe, a e dite se Allahu ma dëftoi një emër të Tij, me të cilin po të lutej, Ai do

të përgjigjej ?Aishja thotë: E përbeva Pejgamberin në babë e nënë që të ma mësonte atë emër, por ai më tha: “Nuk bën të ta mësoj, oj Aishe”. Atëherë thotë Aishja r.a., u përkula në shenjë nderimi, u ula për disa çaste dhe pastaj u ngrita, ia putha kokën të Dërguarit a.s. dhe me përlulësi e luta: “Të lutem, ma mëso atë emër, o i Dërguar i Allahut!, kurse ai prapë ma ktheu: “Nuk bën të ta mësoj, oj Aishe, sepse me atë emër nuk bën të kërkojë ndonjë gjë të kësaj bote”.


Pasi i dëgjova këto fjalë, thotë Aishja r.a., u ngrita, mora abdest, i fala dy rekate dhe fillova të lutesha: “O Zoti im, unë po të lutem Ty, o (Allah), po të lutem o i Gjithëmëshirshëm - (Er-Rahman), po të lutem o Mirëbërës - (El-Berr) dhe Mëshirëplotë - (Er-Rahim), po të lutem me të gjithë emrat e Tu të bukur që ke, me ata që unë i di dhe me ata që nuk i di, që të më falësh e të më mëshirosh mua”. Atëherë, thotë Aishja r.a., e pashë Resulullahin s.a.v.s. duke buzëqeshur dhe më tha: “Ai emër i madh i Allahut, është në njërin prej këtyre emrave me të cilët e lute Atë”.

- Në koleksionin e Tirmidhiut transmetohet nga Esma’ë bin Jezid, se i Dërguari a.s. ka thënë: “ Emri i Madh i Allahut është në këto dy ajete: “Ve ilahukum ilahun vahid, la ilahe il-la huve er-Rahmanu er-Rahim”- “Zoti juaj (që meriton adhurimin) është një, Allahu, nuk ka zot pos Tij, është mëshirplotë dhe mëshirbërës” (El-Bekare, 163) dhe ajeti i dytë i kaptinës Ali Imran: “Allahu la ilaheil-la huve el-Hajjul Kajjum” – “Allahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është Mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm”, (Ali Imran 2)

Në lidhje me këtë hadith, Tirmidhiu pohon se është në gradën sahih.

Nga aspekti gjuhësor, kuptimi i këtij emri të bukur të Tij është “I adhuruar”, do të thotë i Vetmi që është i denjë për adhurim, nga çdo krijesë në këtë ekzistencë, qoftë nga engjëjt, exhinët, njerëzit, toka, qiejt me të gjitha yjet dhe planetët brenda kësaj gjithësie etj.

Emri “Allah” është emër i përveçëm dhe nuk është i prejardhur, do të thotë nuk rrjedh prej ndonjë fjale tjetër. Si term, përdoret vetëm për të dëshmuar



Besimtari është i mëshiruar gjatë jetës së tij, i mëshiruar gjatë vdekjes, në varr, në ringjallje, tek Ura e Siratit, gjatë Llogarisë dhe i mëshiruar me hyrjen në Xhenet.

Ekzistencën e Domosdoshme dhe Absolute. Çdo emër tjetër i bukur i Allahut vjen si shtesë me të, kur janë së bashku. p.sh. “Huvallahu ledhi la ilahe il-la huve”- “Ai është Allahu që nuk ka zot tjetër përveç Tij...” (El-Hashr,23) ose “Allahu la ilahe il-la huve rabbul Arshil adhim”-“Allahu është një, nuk ka Zot tjetër përveç Tij, Zot i Arshit të madh”, (En-Neml, 26) etj.

Në Kur'an ky emër është përdorur 2699 herë, ndërsa nëse ia shtojmë edhe emërtimin që rrjedh po prej këtij emri atëherë ai del se është përmendur mbi 2700 herë.

Me këtë emër hyjnor nuk është emërtuar dhe as që mund të emërtohet dikush tjetër. Madje ky është edhe një sfidim hyjnor për mbarë njerëzimin, sepse Allahu xh.sh. thotë : “A di ti për Të (Allahun) emërtues tjetër?! ” - (Merjem, 65)

Me fjalën Allah, janë hapur mbi tridhjetë e pesë ajete kuranore të shpërndarë nëpër kaptina të ndryshme të Kuranit. Vetëm me emrin Allah plotësohet dëshmia islame e cila është “La ilahe il-la Allah, Muhammedun resulullah”.Me këtë emër të lartë hyjnor, fillojmë çdo punë, dhe me këtë emër hapen kaptinat e Kur'anit, do të thotë me (Bismil-lahiRrahmani Rrahim).

“... Njohësi i së padukshmes dhe i së dukshmes”

Allahu i Gjithëdijshëm, e di çdo të fshehtë në këtë ekzistencë, të

cilën e ka krijuar. Ai është njohës i të padukshmes dhe i të dukshmes. Asgjë nuk mund t'i fshihet dijes së Tij. Asgjë në këtë gjithësi nuk mund të ndodhë, pa lejen, vullnetin dhe dëshirën e Tij. Ai në Kurnin famëlartë thotë: “Çelësat e fshehtësive janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë dhe s'ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (Lehvi Mahfudh).” – (El-En'am 59)

“Gajb” është tërë ajo që është e fshehur nga të pamët dhe shikimet tona. Nëse njeriu ka pengesa të natyrave të ndryshme, që e privojnë atë nga njohuritë e së fshehtës, kjo nuk vlen për Krijuesin absolut, i cili e ka krijuar dhe e mbikëqyr procesin e tërë kësaj që e shohim dhe që nuk e shohim.

I Gjithëmëshirshmi

Ky emër i bukur i Allahut, është përmendur si një prej emrave më të mëdhenj të Allahut, e që nënkupton se Ai shtrin mëshirën e Tij mbi të gjitha krijesat në këtë botë, pa dallim, qofshin ata besimtarë apo jo, njerëz apo exhinë etj.

Çdo gjë në këtë tokë, është dhuratë dhe mëshirë nga Allahu për krijesën njerëzore. Ai kur na bëri mëkëmbës në Tokë, na shikoi me “Syrin” e mëshirës, duke na dhuruar udhëzimin, bereqetin dhe rrizkun. Madje, askujt nuk ia kushtëzoi as besimin, sepse krijoi edhe botën tjetër-Ahiretin dhe pas Llogarisë, në bazë të veprave tona, të na shpërblejë me Xhenet apo të na ndëshkojë me zjarrin e Xhehenemit.

Mëshirëploti!

Përderisa emri apo cilësia para-prake e Allahut “Er-Rrahman” nënkupton mëshirën për të gjitha krijesat, pa dallim, tash ky emër tjetër i bukur i Allahut “Er-Rra-

him”, dëfton për mëshirën e posaçme dhe specifike të Tij ndaj besimtarëve në veçanti, sidomos në botën e ardhshme.

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Ai (Mëshirëploti) ju mëshiron juve e edhe engjëjt e Tij, për t'ju nxjerrë juve prej errësirave në dritë dhe Ai ndaj besimtarëve është shumë i mëshirshëm.” – (El-Ahzab, 43).

Allahu xh.sh. ndaj besimtarëve ka qenë dhe është vazhdimisht i mëshirshëm. Besimtari është i mëshiruar gjatë jetës së tij, i mëshiruar gjatë vdekjes, në varr, në ringjallje, tek Ura e Siratit, gjatë Llogarisë dhe i mëshiruar me hyrjen në Xhenet. Mëshira e Tij e pakufishme vërehet në çdo proces të jetës sonë, andaj duhet të jemi falënderues për këto mirësi

Porosia e ajeteve 21-22

- Allahu xh.sh. ka nxitur në meditim rreth Kuranit famëlartë, duke tërhequr vërejtjen që në asnjë çast të mos heqim dorë nga udhëzimet e tij, sepse në ajetet e tij ka dritë e udhëzim.

- Sjellja e shembujve të ndryshëm në Kuran, si me kodrën, në këtë rast, është nxitje dhe motiv për njerëzit që të meditojnë rreth madhësisë së fjalëve të Allahut.

- Allahu e di të fshehtën dhe të dukshmen, dhe atij nuk mund t'i fshihet asgjë nga fshehtësitë e kësaj ekzistence.

- Mëshira e Allahut për krijesat e Tij në këtë botë është e barabartë për të gjithë, ndërsa në Ahiret, Mëshira e Tij e pakufishme do t'i përshkojë vetëm besimtarët.

- Të përmendurit e Allahut është detyrim i çdo besimtari në çdo kohë, në mëngjes e mbrëmje, në gëzime e dëshpërime, në rrugë e në shtëpi. Për këtë jemi të urdhëruar nga i Lartmadhërishti në Kur'anin fisnik: “Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj (me shpërblim). Më falënderoni e mos më mohoni” - (El-Bekare, 152) - vijon-

Nexhat Ibrahim

PIKËPAMJE TË ETIKËS ISLAME

Islami është në mesin e feve monoteiste që e ruajti burimin e vet, kundrejt Judaizmit dhe Krishterimit, që patën burim të vërtetë, por me kalimin e kohës humbën burimin dhe shtrembëruan rrugën. Fillimi i Islamit ishte Meka, Arabia, kurse sot Islami dhe myslimanët gjenden thuajse në të gjitha vendet e botës, kurse numri i tyre po ecën drejt numrit dy miliardë.

I. HYRJE

Nëse dikur numri më i madh i myslimanëve gjendej në Azi dhe Afrikë, një numër i tyre ka filluar të zhvendoset edhe në Amerikë e Evropë. Kudo që janë, myslimanët paraqesin fuqi punëtore të denjë dhe faktor moral me rëndësi. Por, kohëve të fundit, me indoktrinimin dhe nën dirigjimin e grupeve të caktuara, disa grupe të vogla myslimanësh bëjnë veprime joislame, që kanë nxitur indinjatën e popullsisë vendase. Për këtë qëllim dëshirojmë të bëjmë një prezantim të doktrinës etike islame dhe të paraqesim publikisht bindjen tonë se feja islame është fe e paqes, e përparimit dhe rigorozisht është kundër dhunës e regresit material e shpirtëror.

610 e.r. kurse përfundimi ishte më 632 e.r. Shtylla e dytë, Hadithi, është mishërimi i fjalës, i këshillës, sugjerimit, veprimit apo heshtjes së Pejgamberit a.s.. E tërë kjo quhet Sunet, përkatësisht jetësimi në praktikë i tërë mësimave fetare nga Pejgamberi Muhammed a.s.. Kurani është shpallja e fundit për njerëzinë, përkatësisht projeksioni i fundit historik i udhëhequr nga providenca hyjnore. Pas Kuranit nuk ka shpallje tjetër, as pejgamber tjetër, sepse Kurani dhe Muhammedi a.s. do të jenë udhëzimi njerëzor deri në Fundin e Botës.

Në fillim feja islame tregoi sens të mjaftueshëm ndaj gjendjes së pranishme, duke u përgjigjur se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet

vepruar. Këtë e bënin në njëfarë forme edhe Judaizmi e Krishterizmi, por meqenëse burimet e tyre hyjnore ishin humbur dhe mendja njerëzore kishte ndërhyrë, edhe idetë por edhe veprimet kishin degraduar në masë të madhe. Islami në fazën fillestare kishte nevojë të mëdha të brendshme dhe racionale për ndryshime individuale, shoqërore, gjë që rezultoi edhe me përpjekje të shumta fetare, morale, sociale etj.¹. Këtë e dëshoi vetë Allahu xh.sh. duke shpallur qindra ajete për përdorimin e të gjitha mundësive njerëzore, të përshtatshme, intelektuale dhe biologjike, në perceptimin dhe veprimin e tyre. Me kalimin e kohës perceptimet dhe përpunimet e urdhëresave fetare qenë

II. BAZAT E ETIKËS ISLAME: VLERAT DHE PREMISAT THEMELORE

Islami bazohet në dy shtylla kryesore, Kuran dhe Hadith. Kurani është fjala e shkruar e Allahut, dërguar njerëzisë nëpërmjet Muhamedit a.s.. Në të gjenden parimet dhe udhëzimet kryesore për këtë botë (dynja) dhe për botën përtej (ahireti). Fillimi ishte në vitin



zhvilluar, por duke kyçur në vete edhe mendjen njerëzore. Kriter i gjithë kësaj u vendos Fjala e Tij (*"Qoftë i lartësuar Ai që i shpalli robët të Vet Furkanin, që të jetë qortim (vërejtje) për botët."*) (El-Furkan, 1).

Sundimi hyjnor, si edhe në fetë e tjera qiellore, ishte kriteri për të dalluar të mirën dhe të ligën. Kjo në Kuran është demonstruar edhe nëpërmjet tregimit të Adem-it a.s. dhe Havasë, aftësisë së tyre për emërtimin e gjësendeve, rënies së tyre në mëkat, pendimit të tyre, Kabilit si sinonim të së keqes dhe Habilit si sinonim të së mirës. Djalli tregoi arrogancë me shkeljen e kufijve të përcaktuar dhe u përjashtua nga mëshira e Krijuesit, melaiket si qenie njëdimensionale iu përulën urdhrit dhe treguan urtësi përballë Krijuesit, njeriu për herë të parë e humbi rastin që të jetojë brenda kufijve të përcaktuar hyjnorë, por për shkak të natyrës së tij korrigjuese sërish do ta ketë mundësinë e kthimit të statusit të hershëm. Betejat e njeriut në gjetjen e mjeteve për mendime dhe veprime ekuilibruese në pajtim me kërkesat për përulje, duke u sfiduar dhe konfirmuar, e bëjnë atë kreator e sajues relativ të fatit individual, grupor e shoqëror. Shenja mbuluese e tërë aktivitetit njerëzor, të përsipirtshëm, moral, intelektual dhe biologjik është devocioni, përkushtimi, që Kurani e njeh me shprehjen *takvā*: *"O njerëz, Ne ju kemi krijuar ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që ta njihni njëri-tjetrin. Më fshikëni në mesin tuaj tek Allahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij; Allahu, me të vërtetë, është shumë i dijshtëm dhe i informuar mirë."* (El-Huxhurat, 13)

Kurani këtë parim e realizon nëpërmjet asaj që e quajmë *"bashkësi të drejtë"*: *"Dhe ashtu*

Imam Maturidiu e pastaj edhe Imam Esh'ariu nuk do ta mohojnë rolin e arsyes dhe do ta pranojnë si mekanizëm ndihmues për vërtetimin e gjërave të fesë e etikës dhe do ta kontestojnë vlerën e saj sipërore.

ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të jeni dëshmitarë kundër njerëzve dhe i Dërguari do të jetë dëshmitar kundër jush." (El-Bekare, 143)

Kurani e afirmon natyrën e dyfishtë të njeriut, natyrën individuale dhe kolektive, materiale dhe shpirtërore, por këto dy antipode në shikim të parë nuk i sheh në konflikt të ndërsjellë, por i sheh si përplotësim të njëra-tjetrës. Bashkësia muslimane, si e drejtë (*ummeten vesaten*), është fusha, niveli social dhe kulturor ku idealet kur'anore do të gjejnë manifestimin e tyre, për shembull në pikëpamjen ekonomike, shoqërore, intelektuale, përkatësisht në familje dhe të afërm, të varfër e skamnorë, udhëtarë e nxënësit etj.²

Afirmimi i këtyre parimeve nuk nënkupton edhe përdorimin e mjeteve represive për aplikimin në praktikë të këtyre postulateve. Islami vetëm i njohet njerëzit me këto obligime. Akuzat se Islami përdor dhunën për zbatimin e kërkesave fetare, madje duke e quajtur luftën në Islam si *të shenjtë* (holy), janë dashakeqe. Islami ka për qëllim të krijojë kushte që njerëzit

të jenë në gjendje të zgjedhin mes të mirës dhe të keqes, kurse përgjegjësia bie mbi individët, do ta pranojnë apo jo të mirën karshi të keqes.

Allahu thotë: *"Sikur të donte Allahu, do t'ju bënte një popull, por deshi t'ju sprovtojë në atë që jua dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiguni për punë të mira."* (El-Maideh, 48)

Muhammedi a.s. është ai që duhet ndjekur. Kurani, vetë Hadithi, por edhe letërsia në përgjithësi kanë për qëllim të zgjojnë dëshirën për ndjekjen e tij, por edhe dashurinë për të. Fjala dhe vepra e tij u bënë pjesë edhe e korpusit juridik, nëpërmjet kontributit të shkollave besimore dhe juridike në historinë e fesë islame.

Këtë e përcolli edhe shfaqja e supozimeve e premisave etike, të cilat i artikulonin vlerat etike, të bazuara në Kuran dhe Hadith, herë duke qenë më afër aspektit besimor e herë duke anuar kah perceptimi dhe artikulimi spekulativ, filozofik. Këtë formim e ndihmuan edhe kontakti dhe fërkimet me kulturat e qytetërimit e huaja, me të cilat myslimanët ranë në kontakt e madje edhe bashkëjetonin në një shtet të përbashkët, si në Lindjen e Afërt, Lindjen e Mesme, Egjipt etj.³

III. QASJA TEOLOGJIKE DHE TRADICIONALISTE

Qasja ndaj Islamit është e pakufizuar, por gjatë historisë dy qasje janë imponuar si kryesore: teologjike dhe tradicionaliste. Të dy drejtimit janë të frymëzuar nga burimet e shenjta islame (Kurani dhe Hadithi) dhe nga zhvillimi i procesit racional vetëreflektues⁴.

Qasja tradicionaliste si bazë fillestare kishte traditën gojore lokale me premisa të kulturës paraislame, që pastaj do të ecte drejt kulturës që

bazohej në tekstet e shpallura.

Qasja teologjike si bazë fillestare kishte burimet islame, por pjesërisht kishte edhe ndikimin e përkthimeve nga kulturat e huaja (në filozofi, medicinë, astronomi etj.), por më vonë nën ndikimin e qasjes vetjake, të bazuar, krahas qasjes tradicionale, edhe në aplikimin e mjeteve racionale në shpjegimin e urdhrave kuranorë, që do të njihet me shprehjen *kelam*. Këtë do ta lehtësojnë arabët kristianë e hebrenj, por edhe vetë ata myslimanë, të cilët kishin njohuri nga kulturat e tyre fetare, filozofike, etike, shkencore etj.. Synimi parësor i shkencës së re, të kelamit (apologjetikës) para së gjithash ishte teologjik, në kuptimin e përdorimit të mendjes me qëllim të lehtësimit të të kuptuarit dhe arsyetimit të fjalëve të Zotit.

Brenda diskutimeve të gjata, të zjarra të vështira, në skenë doli grupi mu'tezilist, me frymë të skajshme racionaliste, i cili pohon se Zoti është i drejtë dhe merr në përgjegjësi vetëm ata që kanë liri dhe mundësi për zgjedhje, duke refuzuar grupin tjetër, të cilët pohojnë se njeriu është i predestinuar në veprime sipas vullnetit hyjnor. Ky grup është eliminuar historikisht, por ide të tyre kanë mbetur gjallë deri në ditët tona. Shafi'u refuzon mu'tezilen duke thënë se shpallja e jo spekulimi është burim dhe kriter për të gjitha gjërat, gjersa mu'tezilja pohon se mendja natyrore ka aftësi për njohjen e së mirës dhe së keqes. E qartë, nga ky vorbull përplasjes ideore rezultoi se tradicionalistët e tepronin në mohimin e rolit të mendjes, kurse racionalistët në theksimin e rolit të mendjes. Në këtë çështje ndihma erdhi nga grupimi më i madh që do të formohet, elhi suneti dhe xhemati, ku Imam Maturidiu e pastaj edhe Imam Esh'ariu nuk do ta mohojnë rolin e arsyes dhe do ta pranojnë si mekanizëm ndihmues për vërtetimin e gjërave të fesë e etikës dhe do ta kontestojnë vlerën e saj sipërore⁵.

IV. QASJA FILOZOFIKE

Intelektualët myslimanë duke lexuar e medituar për trashëgiminë antike filozofike e të tjera, ata edhe e integruan atë në botën myslimane. Krahas njohjes me të, ata u aftësuan ta vlerësojnë dhe shfrytëzojnë për nevojat e veta. Nga ky angazhim intelektual dolën personalitete të tilla si Kindiu, Farabiu, Ibn Sinani, Ibn Rushdi, Ibn Tufejli, Ibn Baxha e tjerë, të cilët e përkthyen trashëgiminë e vjetër greke, asiriane, persiane, e komentuan atë dhe e vlerësuan saktësisht⁶.

Në tërë këtë tradita etike myslimane ka rol të dyfishtë: vijimësinë e marrjes me filozofi dhe përkushtimin në sintezën e Islamit dhe mendimit filozofik⁷.

Kindiu (vd. 873) u angazhua për harmoninë mes filozofisë dhe religjionit, kurse Farabiu (vd. 950) për pajtimin mes idealeve morale të religjionit dhe synimeve të shtetit ideal. Ai mendonte se nëpërmjet filozofisë mund të kuptojmë si arrihet lumturia njerëzore, duke e ruajtur si faktor kyç rolin e religjionit. Funksionimin e re-

**Nëse dominojnë
virtutet te sunduesit
dhe qytetarët, aq më
lehtë do të mund
të arrihet lumturia,
synim i përhershëm
edhe i religjionit edhe
i filozofisë.**

ligjionit ai e ka krahasuar me themelimin e një qyteti. Ashtu si qytetarët duhet të posedojnë cilësitë që do t'i aftësojnë të funksionojnë si banorë të qytetit të drejtë, ashtu edhe besimtarët duhet t'i kenë normat e caktuara të cilat duhet t'i sendërtojnë për të funksionuar një bashkësi e drejtë religjioze. Këtë synon Farabiu në librin e tij *Medinet'ul-fadileh*. Nëse dominojnë virtutet te sunduesit dhe qytetarët, aq më lehtë do të





mund të arrihet lumturia, synim i përhershëm edhe i religjionit edhe i filozofisë.

Ibn Sinai (vd. 1037) mendonte se Pejgamberi a.s. manifestonte tërësinë e synimeve dhe veprave morale. Ai me ndihmën e Krijuesit ka arritur virtytet e domosdoshme morale që kanë sjellë deri te përkryeshmëria e tij dhe mundësinë që jo vetëm për vete por edhe për të tjerët të vendoste norma të caktuara. Kjo domethënë se Pejgamberi a.s. ka epërsi edhe ndaj filozofit edhe ndaj moralistit, të cilët janë të kufizuar brenda njerëzores dhe relatives. Sipas tij, bashkimi i filozofisë dhe religjionit përfshin jetë të harmonishme edhe në këtë edhe në botën tjetër.

Ibn Rushdi (vd. 1198) që përballur me detyrë të rëndë për një filozof mysliman, ta mbronte filozofinë nga sulmet e Gazaliut (vd. 1111) dhe të tjerëve. Gazaliu në veprën *Vetëshkatërrimi i filozofëve* i akuzoi rëndë filozofët myslimanë të ndikuar nga filozofia greke, kurse Ibn Rushdi e arsyetoi filozofinë me

faktin se vetë Kurani urdhëron përdorimin e arsyes dhe meditimit, duke thënë se qasja tradicionale dhe racionale kanë një synim, por që ky synim arrihet me rrugë të ndryshme⁸.

V. PIKËPAMJET SUFISTE

Sufizmi apo tesavufi është përmasa ezoterike, mistike e Islamit. Në kërkim të dashurisë dhe njohjes hyjnore, sufizmi thekson përkryerjen e jetës së brendshme vetjake. Sufizmi si prioritet ka aftësimin e myslimanit për gjurmim të unitetit me Zotin, por që si kusht ka zgjimin e tij shpirtëror⁹.

Sufizmi thekson lidhjen mes vetëdijes së brendshme morale dhe manifestimeve të tij të jashtme, ashtu që veprimi i mirëfilltë moral është vetëm ai i cili përfshin dhe përshkon tërë jetën. Për të pasur efekt në veprime janë pranuar edhe shumë praktika lokale, domethënë tradita të ndryshme lokale tipike të vendit të caktuar, që rezultoi me pranimin e Islamit si botëkupa-

tim dhe praktik në shumë vende të botës e sidomos në Indonezi e vendet përreth saj. Etika sufiste islame që bërë urë mes vlerave etike islame dhe praktikave lokale të popujve nëpër botë¹⁰.

VI. ETIKA MYSLIMANE NË BOTËN BASHKËKOHORE APO NË VEND TË PËRMBYLLJES

Praktika dhe ndikimi i trashëgimisë së ndryshme etike në Islam vazhdon në shkallë e nivele të ndryshme ndër myslimanët e botës bashkëkohore¹¹. Myslimanët, qoftë kur jetojnë në shumicën myslimane, qoftë si komunitete të rëndësishme në shtete jomyslimane, po kalojnë në një fazë tranzicioni. Në mesin e tyre vërehet edhe vetëdija për trashëgiminë vetjake dhe për nevojën që kjo trashëgimi t'u përshtatet rrethanave relative në këtë botën njerëzore të globalizuar. Pikërisht për këtë arsye, për çështjet etike nuk mund të flitet në mënyrë unike dhe monolite. Për të qenë sa më afër përgjigjeve të sakta duhen marrë parasysh diversiteti dhe pluralizmi dhe veçoritë e myslimanëve si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen¹².

1. Shib kapitullin e pestë të: Muhammed Ikbali, *Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam*, Logos-A, Shkup, 2006. 2. Shib: "Sadakatë u takojnë vetëm të varfërve, të gjorëve dhe atyre që e mbledhin atë (rrugë e nepunësit që punon në atë lëmë) dhe atyre që u duhen përfituar zemrat, dhe për lirim nga skllavëria, dhe të ngarkuarve në borshe, dhe për rrugën e Allahut, dhe udhëtarit të rastit. Këto janë dispozitat e Allahut. Se, me të vërtetë, Allahu është i Plotëdijshëm dhe i Gjithëdijshëm." (Et-Teveb, 60) 3. Azim Nandzi, *Islamska etika*, në: Piter Singer (ed.), *Uvod u etiku*, Sremski Karlovci - Novi Sad, 2004, fq. 158-165. 4. Shib: *Nexhat Ibrahim, Bazat e etikës islame*, Logos-A, Shkup, 2005, fq. 100-102 dhe 103-107. 5. Shib gjerësisht për medhabet dhe sektet në fenë islame: *Nexhat Ibrahim, Vepra 3 dhe 4*, Logos-A, Shkup, 2009. 6. *Nexhat Ibrahim, Bazat e etikës islame*, fq. 107-111. 7. Azim Nandzi, po aty, fq. 165-168. 8. *Nexhat Ibrahim, Bazat e etikës islame*, fq. 112-116. 9. Shib: *Ibn Rushd, Fjala vendimtare rreth fesë dhe filozofisë*, Logos-A, Shkup, 2017. Azim Nandzi, po aty, fq. 168-170. 10. Azim Nandzi, po aty, fq. 171-172. 11. *Nexhat Ibrahim, Bazat e etikës islame*, fq. 117-119 dhe 177-200. 12. Azim Nandzi, po aty, fq. 172-173.

A lexohet pas imamit në namaz?

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush fal namazin në xhemat, leximi i imamit është i mjaftueshëm për të.”

Muktediu (personi që fal namaz në xhemat pas imamit) nuk e ndjek imamin duke lexuar në kijam, pavarësisht a është fjala për namazet në të cilat imami lexon me zë apo kur lexon në vete. Dëshmi për këtë janë fjalët e Allahut: “*Kur lexohet Kurani, ju dëgjoni atë (me vëmendje) dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë.*” (El-Araf, 204)

Ebu Hurejre r.a., transmeton se ky ajet është shpallur me rastin e leximit të një muktediu në namaz me Pejgamberin a.s. Një transmetim të ngjashëm, gjithashtu e shënon edhe El-Bejheki.

Përveç ajetit kuranor, juristët hanefi qëndrimin e tyre e argumentojnë edhe me hadithin sahih, të cilin e regjistron Muslimi nga Katade r.a., i cili transmeton se i Dërguari i Allahut (savs), duke u shpjeguar sahabëve se si kryhet namazi, ka thënë: “*Kur të filloni për të falur namaz, drejtoni safat (rreshtat). Pastaj njëri prej jush le të bëhet imam. Kur ai të marrë tekbir edhe ju bëjeni atë, kurse kur ai të thotë: “Gajri-l-magdubi alejhim veled-dal-lin”, ju thoni “amin!” Allahi këtë do t’jua pranojë... Ndërsa kur ai të lexojë, ju heshtni!*”

Në një hadith tjetër hadith sahih, Ebu Hurejre r.a., transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “**Imami është vendosur për t’u ndjekur, kur ai merr tekbir edhe ju bëjeni atë, ndërsa kur ai lexon Kuran, ju heshtni!**”

Gjithashtu, në transmetimin sa-

hah, të cilin e shënon Et-Tahavi, Ed Darekutni, El-Bejheki, Ibn Ebi Shejbe dhe të tjerët, nga Xhabir ibn Abdullahu r.a., thuhet se Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Kur ndonjëri prej jush fal namazin në xhemat, leximi i imamit është i mjaftueshëm për të.*”

Siç është shënuar në një numër të transmetimeve, sahabët nuk kanë lexuar Kuran kur janë falur pas imamit. Malik b. Enes në *El-Muvatta’* shënon nga Nafiu se Abdullah ibn Omeri r.a. është pyetur se a është e nevojshme të lexojë në namaz kur dikush falet pas imamit, dhe ai është përgjigjur: “*Kur ndonjëri prej jush falet pas imamit, leximi i imamit është i mjaftueshëm për të. Ndërsa kur të falet vetëm, atëherë le të lexojë Kuran.*”

Nafiu shton: “*Abdullah ibn Omeri nuk ka lexuar Kuran në namaz kur është falur pas imamit.*”

Ebu Vail transmeton se Abdullah ibn Mesudi (r.a.) është pyetur për leximin pas imamit në namaz, dhe ai është përgjigjur: “*Hesht kur të lexohet. Në të vërtetë ka disa vep-*

rime në namaz të cilat mjafton që t’i bëjë imami në vend tuajin.”

Përveç kësaj, Muslimi shënon se Zejd ibn Thabiti është pyetur për leximin pas imamit në namaz dhe ka thënë: “*Nuk duhet të lexohet asgjë pas imamit.*”

Transmetimet me përmbajtje të ngjashme janë transmetuar nga: Ebu Hurejre, Abdullah ibn Abbasi, Ebu Derda r.a....

Ky qëndrim përfaqësohet nga Ebu Hanife, Ebu Jusufi, Muhamed esh-Shejbani dhe pasuesit e tyre. Muhamed esh-Shejbani ka thënë: “*Nuk ka nevojë të lexoni asgjë kur të faleni pas imamit.*”

Shumica e dijetarëve islamë konsiderojnë se muktediu nuk është i obliguar të lexojë Kuran në kijam, pavarësisht a është fjala për namazet në të cilat imami lexon me zë apo kur lexon në vete. Në mesin e tyre bëjnë pjesë edhe dijetarët e medhebit hanbeli dhe maliki.

<https://l.facebook.com/l.php?u=http%da-li-se-uci-za-imamom-u-namaz>

Përktheu: Miftar Ajdini



Nexhmi Hoxha

Pejgamberi a.s. dhe të tjerët

Historia dhe fjalët e Pejgamberit a.s. na tregojnë shembullin më të mirë se si duhet të sillemi karshi jomyslimanëve, me mirësi, mëshirë, moral të mirë, kulturë të mirë, falje, shoqërim të mirë, ndihmesë ndaj tyre, drejtësi. Shembuj të ndryshëm mund të nxjerrim nga jeta e tëDërguarit të Allahut, se si ai është sjellë me jomyslimanet.

Jeta e Pejgamberit a.s. karakterizohet nga ngjarje nga më të ndryshmet, qoftë në aspektin e thirrjes (dave-tit) e po ashtu edhe në aspektin e raporteve të tij me të tjerët, që në këtë rast përfshinte pjesëtarët e feve të tjera që vepronin në Mekë dhe në Medinë. Allahu xh.sh. nëpërmes ajeteve kuranore e porositi të Dërguarin a.s. që të ketë sjellje dhe moral të mirë me të gjithë njerëzit, pavarësisht fesë së cilës i takonin, madje Ai e quajti mëshirë për gjitha krijesat, në ajetin e 107-të, të sures El Enbija: “Vërtet ne të dërguam mëshirë për mbarë njerëzimin.”

Allahu i Madhëruar ia mohoi Pejgamberit a.s. shqetësimin e shtuar që mushrikët, banorët e Mekës ta pranonin Islamin. Për këtë Zoti në Kuran thotë: “Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë.” (Junus, 99)

Gjithashtu Kurani famëlartë nxit mysli-manët që të kenë sjellje të mira karshi jomyslimanëve. Allahu në Kuran thotë: “Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. Allahu

i do ata që mbajnë drejtësinë.” (El Mumtehine, 8). Allahu po ashtu e lejoi të ushqyerit me ushqimin që e përgatitin ithtarët e librit, e po ashtu edhe me prodhimet e tyre. Për këtë, Zoti në Kuran thotë: “Sot u bënë të lejuara për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet (të therurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju...” (El Maide, 5)

Përpos këtyre, Allahu në Kuran na fton që me ithtarët e librit të bëjmë dialog në mënyrën më të mirë. Allahu thotë: “Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe vetëm ashtu si është më së miri.” (Ankebut, 46). Gjithashtu Allahu në Kuran

Kurani për jomysli-manët

Kurani është kushtetutë e mysli-manëve. Ai ka vendosur ligje të përgjithshme, të cilave u është përmbajtur Pejgamberi a.s. dhe mysli-manët në të gjitha kohët dhe në të gjitha vendet.

Ajeti i cili merret për bazë për të vepruar me jomysli-manët është ajeti i 256-të, i sures El Bekare, i cili thotë: “Nuk ka dhunë në fe”. (El Bekare, 256)

Kjo argumenton se Zoti nëpërmjet Kuranit nuk e detyron askënd që ta pranojë Islamin duke e urryer atë, njerëzit i la të lirë që ta zgjedhin fenë e tyre.



na urdhëron që të sillemi mirë me njerëzit në fjalët, veprat tona dhe të jemi të drejtë ndaj çdonjërit, pa marrë parasysh besimit, kombit apo racës. Allahu në Kuran thotë: “Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve...”. (En Nahl, 90). Po ashtu Ai thotë: “...dhe njerëzve u thoni fjalë të mira...” (El Bekare, 83)

Kurani na mëson se ka dallim ndërmjet sjelljes së mirë, bashkëpunimit me ta dhe dashurisë dhe pasimit të tyre, këto të fundit janë të ndaluara, ngase ata duan më shumë kufrin sesa imanin. Për këtë Zoti në Kuran ka thënë: “Nuk gjen popull që e beson Allahun dhe ditën e gjykimit e ta dojë atë që e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre ose farefisi i tyre...” (El Muxhadele, 22)

Allahu i Madhëruar në mëson sjellje të mirë edhe me prindërit të cilët janë të besimeve të tjera, mirëpo na e ndalon që t'i pasojmë ata. “E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i paso ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre...” (Llukman, 15)

Urtësia e Pejgamberit a.s. me jomyslimanët

Shembulli i Pejgamberit a.s. duhet të jetë model për të gjithë mysliimanët, për këtë Zoti në Kuran ka thënë: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut.” (El Ahzab, 21).

Historia dhe fjalët e Pejgamberit a.s. na tregojnë shembullin më të mirë se si duhet të sillemi karshi jomysliimanëve, me mirësi, mëshirë, moral të mirë, kulturë të mirë, falje, shoqërim të mirë, ndihmesë ndaj tyre, drejtësi. Shembuj

Se Pejgamberi a.s. kishte marrëdhënie të mira me të krishterët, e dëshmon edhe fakti se atë në fillimin e shpalljes ai kishte përkrahjen morale të disa të krishterëve, siç ishte Vereka ibën Neufeli etj.

të ndryshëm mund të nxjerrim nga jeta e të Dërguarit të Allahut, se si ai është sjellë me jomysliimanet.

Pejgamberi a.s. e ndaloi që t'u shkaktohen padrejtësi dhe dëme jomysliimanëve. Për këtë kemi hadithin, të cilin e transmeton Abdullah ibën Amër ibën Asi, në të cilin thuhet: “Kush e mbyti një jomysliiman (më të cilët kemi marrëveshje), nuk do ta shijojë erën e xhenetit, era e xhenetit ndihet në një largësi prej 40 vjetësh.” (Transmeton Buhariu, 3166).

“Kush e mbyti një jomysliiman (elhu dhimmeh), nuk do ta shijojë erën e xhenetit.” (Transmeton Imam Ahmedi, 18072).

Në hadithin që e transmeton Ebu Davudi thuhet: “Padysim se kush i bën ndonjë padrejtësi një jobesimtari (me të cilin keni marrëveshje), apo i pakëson diçka prej tij, apo e ngarkon me diç që nuk mund ta përballojë, apo i merr diçka jo me dëshirën e tij, unë jam dëshmitar i tij (jomysliimanit) Ditën e Gjykimit.” (Transmeton Ebu Davudi, 3052).

Esma, bija e Ebu Bekrit r.a. ka thënë: “Në kohën e Pejgamberit a.s. ka ardhur te unë nëna ime, e

cila ishte idhujtare, ajo dëshiron te të mbante lidhjet me mua, e për këtë e pyeta Pejgamberin a.s.: “Nëna ime ka ardhur te unë dhe ajo ka dëshirë të mbajë lidhjet me mua. A të mbajë lidhjen me nënën? Pejgamberi a.s. tha: “Po mbaj lidhjet me nënën tënde.” (Transmeton Buhariu, 2620).

Kjo tregon se Pejgamberi a.s. i nxiste mysliimanët që të kenë sjellje të mira dhe t'i mbajnë lidhjet farëfisnore me ta, përkundër besimit-fesë së tyre.

Aisheja r.a. ka thënë: “Një grup i hebrenjve hynë te Pejgamberi a.s. dhe i thanë: “Essemu alejkum” (Vdekja qoftë për ju). Aisheja tha: “E kuptova çka thanë dhe u thashë: Edhe për ju qoftë vdekja dhe mallkimi.” I Dërguari a.s. tha: “Ngadalë oj Ajshe. Allahu xh.sh. e do butësinë, mirësjelljen në çdo punë. A nuk i dëgjove ata se çka thanë?!” Dhe tha Pejgamberi a.s. “vealejkum (edhe për ju).” (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, 2165).

Kjo vërteton sjelljen e Pejgamberit a.s. ndaj jomysliimanëve, edhe përkundër ofendimeve të tyre, ai u soll me butësi dhe mirësi, ai asnjëherë nuk i ofendoi dhe nuk i nënçmoi ata. Këtë sjellje i Dërguari a.s. e kërkoj edhe nga Aisheja, e nëpërmjet saj edhe nga ne.

Ebu Musa el Eshariu r.a. tregon se hebrenjtë teshtinin në prezencë të Pejgamberit a.s. me shpresën që ai t'u thoshte: “Zoti ju mëshiroftë!”, mirëpo ai u thoshte atyre: “Zoti ju udhëzofte dhe ua përmirësofte mendjen tuaj!”. (Transmeton Imam Ahmedi, 19586).

Transmetohet nga Enes bin Malik, i cili ka thënë: “Një djalosh i ri hebre i shërbente Pejgamberit a.s. dhe ai një ditë u sëmur. Pejgamberi a.s. shkoi ta vizitonte. Ai u ulte koka e tij dhe i tha: “Pranoje (Islamin)”. Djaloshi shikoi babanë e tij që ishte prezent. Babai i tij i tha: “Pasoje Ebu Kasimin (Muhamedin)” dhe ai pranoi Islamin. Doli Pejgamberi a.s. duke thënë: “E falënderoj Allahun, i cili e shpëtoi

nga zjarri i xhehenemit.” (Transmeton Buhariu, 1356).

Të gjitha këto hadithe dhe shumë të tjera si këto na tregojnë sjelljen e Pejgamberit a.s. karshi jomyslimanëve, me të cilët ka jetuar bashkërisht. Këto janë mësim për myslimanët se jomyslimanët gëzojnë të drejta në shoqërinë islame, siç janë e drejta për jetesë, e drejta për përkujdesje, e drejta e besimit, e drejta e punës dhe kërkimit të furnizimit, e drejta e mbajtjes së pozitave të ndryshme në shtet dhe ushtrimit të profesioneve të tyre, garanci për implementimin e marrëveshjeve me drejtësi. Këto janë vetëm disa prej të drejtave themelore që i gëzon çdo njeri, por të cilat i gëzojnë edhe jomyslimanët në shoqërinë islame.

Siç përmendëm më herët në hadithet më lartë, se Pejgamberi a.s. na e ndaloi padrejtësinë ndaj jomyslimanëve, marrjen nga pasuria e tyre me dhunë, t'i shkelim të drejtat e tyre apo t'i mbysim ata pa të drejtë.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e lëndon një jomysliman (dhimmij) më ka lënduar mua, e kush më lëndon mua e ka lënduar Allahun.” (Transmeton Ebu Davudi)

Pra, prej gjërave që myslimanët kanë obligim t'ua ruajnë jomyslimanëve janë ruajtja e jetës së tyre, pasurisë së tyre, nderit të tyre dhe sigurimi i mjeteve të nevojshme gjatë sëmundjes apo pleqërisë së tyre.

Periudha mekase e Pejgamberit a.s.

Gadishulli Arabik ishte vendi në të cilin banonin pjesëtarët e besimeve dhe feve të ndryshme. Këtë gjendje e gjeti edhe Pejgamberi a.s. dhe shpallja e fundit nga ana e Allahut, ku në Mekë kishte pjesëtarë të besimeve të ndryshme, si politeistë, besimtarë të pastër nga feja e Ibrahimit a.s., hebrenj, të krishterë etj.

Pejgamberi a.s. u ballafaqua me gjithë këta pjesëtarë dhe gjitha këto besime. Thirrjen e tij ia dedikoi të gjithëve pa ndonjë përjashtim se cilës fe i takonte. Ai e filloi thirrjen e tij si i Dërguar me ftesën e përgjithshme, që të adhurojnë vetëm një Zot dhe që të largohen nga adhurimet e kota. I ftoi në këtë besim me fjalët e Allahut xh.sh.

Marrëdhëniet e Pejgamberit a.s. me idhujtarët

Banorët e Mekës me rrethinë me shumicë ishin idhujtarë. Pejgamberi a.s. prej momentit të parë të thirrjes në besim në një Zot, hasi në kundërshtime të ashpra, sidomos nga paria e Mekës. Tregohet nga historianët, se Pejgamberi a.s. u ngjit në kodrën Safa dhe i ftoi kurejshitët që të mblidheshin dhe u tha: “O Benu Fihri dhe o Benu Nadir! Sikur t'ju thosha se prapa meje gjendet kalorësia e armikut e cila do t'ju sulmojë, a do të më besonit?” Të gjithë u përgjigjën: “Po.” Atëherë Pejgamberi a.s. ua tërhoqi vërejtjen në ndëshkimin e ashpër që i pret për mosbesimin në një Zot. Atëherë reagoi Ebu Lehebi dhe tha: “A për këtë na ke ftuar! Qofsh i shkatërruar” (Tefsiri i Taberit).

Ky ishte ballafaqimi i parë direkt i Pejgamberit a.s. me jobesimtarët, mirëpo Pejgamberi a.s. nuk ishte i njëjtë sikurse jobesimtarët, ai nuk ua ktheu këtë me vrazhdësi, por gjithnjë u fliste me butësi dhe me mirësi.



Fillimisht kurejshitet nuk e penguan Pejgamberin a.s., derisa ai filloi që t'i ftonte që të largoheshin nga idhujt e tyre dhe që të afroreshin te një Zot i vetëm, tek atëherë filluan që kurejshitet ta shprehnin urrejtjen dhe hasmërinë e tyre për Pejgamberin a.s. sa që tentuan edhe që ta largojnë nga Meka, mirëpo për shkak të pozitës së rëndësishme të familjes së tij, nuk arritën që ta largonin nga Meka, ashtu siç i kishin larguar edhe shumë thirrës për të besuar në fe të pastër. (Ibën Hisham, Jetëshkrimi i Muhamedit a.s.).

Pejgamberi a.s. gjatë qëndrimit të tij në Mekë dhe ballafaqimit të tij me idhujtarët, i ftoi që ta largonin fanatizmin e tepruar familjar, sa që i thirri që ta largonin mburrjen me të parët dhe me fisin e tyre, t'i largonin etiketimet e ndryshme, ta largonin mendjemadhësinë, duke ua kujtuar gjenealogjinë e krijimit të tyre, se janë nga Ademi dhe se Ademi është prej dheu, i ftoi që të largohen nga nënçmimet e fiseve ndërmjet vete, duke i kujtuar se këto janë punë që çojnë në xhehem. Në këtë kohë, fiset kurejshite bënë ndërmjet vete aleanca të ndryshme, për ta mbrojtur njëritjetrin, apo për ta luftuar dikë. Një aleancë të tillë, kurejshitet e bënë edhe kundrejt Benu Hashimëve dhe Benu Abdulmutalibëve, pa marrë parasysh myslimanëve apo jomyslimanëve të këtyre familjeve, duke i bojkotuar ata për një kohë, kështu që nuk blenë e as nuk shitën, e as nuk u martuan, derisa të mos e dorëzonin Muhamedin a.s. Kjo ishte gjendja dhe marrëdhënia e Pejgamberit a.s. me idhujtarët. Një sjellje të tillë, Pejgamberi a.s. nuk e zbatoi me rastin e çlirimit të Mekës kur u kthye si një fitimtar, mirëpo ishte i përlulur dhe me modesti hyri në Qabe. Kurejshitet prisnin me frikë vendimin e Pejgamberit a.s. ndaj tyre, dukeditur të bëmat e tyre kundër tij, prisnin ekzekutim ose dënim të ashpër. Por Pejgamberi a.s. me butësinë e tij dhe me mësimet e Fuqiplotit u tha atyre: "Jeni të falur!".

Marrëdhëniet e Pejgamberit a.s. me besimtarët e pastër të fesë së Ibrahimit a.s.

Ka pasur besimtarë të pastër të fesë së Ibrahimit a.s. që kanë jetuar deri në kohën e ardhjes së Islamit. Nga historianët e ndryshëm mësojmë se Pejgamberi a.s. është takuar me disa pjesëtarë të besimit hanefi, thuhet se edhe prindërit e Pejgamberit a.s. kanë qenë të tillë. Prej këtyre pjesëtarëve ishte edhe Ebu Dherri, prej fisit Gaferr, i cili çdoherë e ka mohuar gjendjen e injorancës dhe i ka urreyer ata që i kanë adhuruar idhujt, është falë për Zotin para ardhjes së Islamit, në periudhën trivjeçare para shpalljes së Islamit pa iu drejtuar kibles. Kjo tregon se ai ka qenë në rrugën e besimit të drejtë. (Ali Salabi, Jeta e të Dërguarit të Allahut)

Amër bin Abesete es Selemij tregon se në kohën e injorancës e ka ditur që njerëzit janë në një humbje, janë duke adhuruar idhuj dhe kjo rrugë nuk i shpie askund. Kam dëgjuar që një njeri në Mekë është duke shpërndarë thirrjen, i hipa devesë dhe u nisa për tek ai. E kam takuar Muhamedin a.s. duke u fshehur, populli i tij e sfidonin atë. U solla disa herë, derisa hyra në Mekë dhe u takova me të, e i thashë: "Çka je ti?" "Unë jam i dërguar i Zotit", iu përgjigj Pejgamberi a.s. "Çfarë i dërguari?" Ai tha: "Më ka dërguar Allahu." "Me çka të ka dërguar?", iu përgjigja. "Më ka dërguar për mbajtjen e lidhjeve farefisnore, për thyerjen e idhujve dhe për adhurimin e një Zoti të vetëm." "Kush është me ty në këtë punë?", i thashë. Ai më tha: "I liri dhe robi." Atëherë me të ishin Ebu Bekri, Bilali që tashmë i kishin besuar. I thashë: "Edhe unë do të të pasoj ty." Më tha: "Ti nuk mund të më pasosh mua në këtë

kohë. A nuk po e sheh gjendjen time dhe të popullit tim në këtë kohë. Ti kthehu te familja jote dhe kur të dëgjosh se kam dalë hap-tazi, atëherë eja dhe më paso mua." (Transmeton Muslimi, 1967).

Ky hadith më së miri tregon mënyrë e komunikimit dhe marrëdhëniet e Pejgamberit a.s. me pjesëtarët e këtij grupi të vogël të njerëzve, që besuan besimin e pastër të fesë së Ibrahimit a.s.

Marrëdhëniet e Pejgamberit a.s. me hebrenjtë

Në përgjithësi në histori, nuk ka të dhëna të mjaftueshme sa i përket hebrenjve në Gadishullin Arabik. Historiani izraelit Wolfenson në librin e tij "Historia e hebrenjve në tokat arabe" thotë se shkak i mungesës së të dhënave për sa i përket hebrenjve në kohën e injorancës në Mekë, qëndron në atë se shumë pak hebrenj pranuan fenë islame. Ajo që është ruajtur prej hebrenjve është gjithë ajo që ka të bëjë me hebrenjtë që pranuan fenë islame. (Wolfenson, Historia e hebrenjve në tokat arabe)

Referenca nga ku nxirren marrëdhëniet e myslimanëve me hebrenjtë e kohës së Mekës përfizohet te Kurani dhe nga ndonjë lajm prej jomyslimanëve. Historianët shënojnë se fërkimi i drejtpërdrejtë mes thirrjes së Muhamedit a.s. dhe hebrenjve ka qenë pikërisht përmes kurejshitëve. Ata me dijen e tyre, i nxisnin kurejshitet që ta pyesnin Pejgamberin a.s. për ta vërtetuar pejgamberinë e tij dhe në këtë mënyrë të tërthortë ata luftonin Pejgamberin a.s. Një fakt të tillë na e vërteton edhe ngjarja e dërgimit të dy emisarëve në Medinë për t'i pyetur parinë e hebrenjve për Pejgamberin a.s., për cilësitë e tij, për fjalët e tij, se ata janë pjesëtarë të librave të parë dhe janë më të dijshtëm se sa ne. Kur

shkuan emisarët dhe takuan rabinët, ata i thanë: “Ju jeni pjesëtarë të Tevratit, ju i njihnin cilësitë e të dërguarve, kemi ardhur që t’ju pyesim për njeriun i cili pretendon se është i Dërguar i Allahut. Na këshilloni!” Rabinët iu përgjigjën: “Pyeteni Pejgamberin a.s. për tri gjëra. Nëse ju përgjigjet për të gjitha, atëherë ai nuk është Pejgamber, nëse nuk ju përgjigjet për asnjërën prej tyre prapë nuk është Pejgamber, e nëse përgjigjet për disa e për disa jo, atëherë është Pejgamber i Allahut.” “Për çfarë ta pyesim?”, thanë emisarët. Rabinët thanë: “Pyeteni për djelmoshat që kanë jetuar në kohët e kaluara, për shpirtin dhe për njeriun i cili iu soll tokës rreth e qark, nga Lindja në Perëndim.” Kur u kthyen emisarët, e pyetën Pejgamberin a.s. me pyetjet që i kishin porositur rabinët. Pejgamberi a.s. u tha do t’u jepte të nesërmen përgjigje. Të nesërmen erdhën përsëri ta Pejgamberi a.s., mirëpo shpallja i ishte ndërprerë për pesëmbëdhjetë ditë, për arsyen se nuk kishte thënë: “Me lejen e Zotit (Inshallah)” (Ibën Is’haku, Jetëshkrimi i Pejgamberit a.s.).

Pas pesëmbëdhjetë ditësh zbritën ajetet e sures El Kehf, në të cilat Allahu xh.sh. i tregon për historinë e djelmoshave, historinë e Dhulkarnejnit dhe në suren Isra, e cila menjëherë gjendet pas sures El Kehf, i tregon për shpirtin, në të cilën thotë: “Të pyesin ty për shpirtin. Thuaju: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, juve ju është dhënë fort pak dije.” (El Isra, 85)

Marrëdhëniet e Pejgamberit a.s. me të krishterët

Në mesin e banorëve të Mekës në kohën e shpalljes së Islamit, gjendeshin edhe një grup i njerëzve të besimit të krishterë, të cilët ishin të ardhur në Mekë për shkaqe të ndryshme, ndër to përmendim skllavërinë, tregtinë, thirrjen në krishterim dhe profesione të ndryshme. Vlen të theksohet se të krishterët në Mekë nuk arritën që të

Pejgamberi a.s. për të shpëtuar nga mundimet e kurjeshëve u dha leje myslimanëve që të emigronin në Habeshe, pasi ishte siguruar që Nexhashiu ishte njeri i drejtë dhe tek ai nuk bëhej padrejtësi.

bëhen faktor ndikues, sa që aty pari në Mekë gjejmë vetëm ndonjë prift apo ndonjë asket, të cilët popujt e tyre i kishin dëbuar nga vendi i tyre. Nga kjo kuptohet se nuk ka pasur pranim të krishterimit në mënyrë të organizuar.

Prej asaj që vërtetohet se ka pasur banorë të krishterë në Mekë është edhe pretendimi i banorëve të Mekës se ishte një i krishterë ai i cili ia mësoi Pejgamberit a.s. Kuranin. Për ta demantuar këtë, Zoti në Kurani shpalli ajetin e 103, të sures En Nahl, në të cilin thuhet:

“Ne e dimë shumë mirë se ata thonë: “Atë (Muhamedin) është ka e mëson një njeri, mirëpo gjuha e tij nga i cili anojnë (supozojnë) ata është jo arabe, e pa qartë, e kjo (e Kuranit) është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë.” (En Nahl, 103).

Është e qartë se në periudhën mekase, armiqët e thirrjes islame ishin mushrikët e Mekës, kurse të krishterët nuk kishin marrëdhënie të drejtpërdrejta me Pejgamberin a.s., ngase edhe ashtu ata nuk ishin banorë autokton të Mekës. Shohim këtu se kurejshitët i akuzojnë të krishterët se janë duke e përkrahur dhe duke e mësuar Muhamedin a.s. nga Tevrat

dhe Inxhili. Këtë na e vërteton edhe fjala e Allahut xh.sh. në Kuran, në të cilën thuhet: “Dhe ata që nuk besuan thanë: “Ky (Kurani) nuk është tjetër vetëm se një gënjeshtër, që e trilloi ai (Muhamedi), të cilit i ndihmuan edhe njerëz të tjerë. Pra ata (idhujtarët) bënë shtrembërim e shpifje. Edhe thanë (për Kuranin) janë legjenda të të parëve, që ai (Muhamedi) kërkoi t’i shkruhen ato, e i lexohen atij mëngjes e mbrëmje.” (El Furkan, 4-5).

Se Pejgamberi a.s. kishte marrëdhënie të mira me të krishterët, e dëshmon edhe fakti se atë në fillimin e shpalljes ai kishte përkrahjen e disa të krishterëve, siç ishte Vereka ibën Neufeli etj. Pejgamberi a.s. për të shpëtuar nga mundimet e kurjeshëve u dha leje myslimanëve që të emigronin në Habeshe, pasi ishte siguruar që Nexhashiu ishte njeri i drejtë dhe tek ai nuk bëhej padrejtësi.

Në vitin e pestë të pejgamberisë, në muajin Rexhep bëri hixhret grupi i parë i myslimanëve. Ata ishin 12 burra dhe 4 gra, me në krye Othman ibën Affanin së bashku me të bijën e Pejgamberit a.s. Rukijen. Sahabët dolën fshehurazi, në errësirën e natës në drejtim të Minas për të vazhduar për në Habeshe. Pas tyre në ndjekje iu vunë dy burra nga paria kurejshite, Amër ibën Asin dhe Abdullah ibën Rebia. Këta të dy, me një plan të menduar mirë i dërguan dhurata priftërinjve dhe i treguan për qëllimin që kishin ardhur, mirëpo Nexhashiu deshi që ta dëgjonte edhe palën tjetër. Në emër të myslimanëve foli Xhaferi, i cili lexoi diçka nga Kurani, konkretisht nga surja Merjem. Atëherë Nexhashiut i rrodhën lotët, aq shumë sa që edhe mjekra iu lag. Bashkë me të qanë edhe priftërinjtë. Pas kësaj, Nexhashiu urdhëroi që t’u ktheheshin mbrapsht dhuratat që kishin sjellë dy delegatët kurejshë. (Safijurrahman el Mubarekfuri, Lulishtja e dritave).

Shohim se qëndrimi i të krishterëve karshi thirrjes së Muhamedit a.s. dhe myslimanëve ka qenë me një sjellje të butë, të urtë, nëse mund ta quajmë një pajtim të plotë me atë që ka thirrur Pejgamberi a.s., siç është rasti i Nexhashiut.

Ahmed Faruk El Helbavi

Si kontribuon zekati në ndërtimin e ekonomisë së fortë kombëtare (1)

Nga synimet e ligjshmërisë së zekatit është lëvizja e kapitalit, investimi i tij dhe ndalimi nga robëria e dërhemit dhe dinarit

Zekati është shtylla e tretë e Islamit dhe simbol i adhurimit. Po ai është një mbresë e cila karakterizohet nga vetë ekzistenca e vet, duke ia shtuar anën financiare që mund të kontribuojë në mënyrë aktive për zgjidhjen e shumë problemeve ekonomike në shtetet e botës islame, gjë që të shtyn të mendosh në sistemimin dhe ngjalljen e tij, në formë institucionale me përparësi të veçantë në kohën kur këto shtete vuajnë nga mashttrimet më të ndryshme ekonomike.

Feja e drejtë islame ka gjetur numër formash e metoda për të realizuar sigurinë shoqërore, e cila numërohet një nga bazat në të

TRE MILIARDË BANORË NGA BOTA NË ZH- VILLIM JETO- JNË NË VARFËRI ME MË PAK SE DY DOLLARË NË DITË

cilat ngrihet shoqëria në Islam. Në mesin e tyre është zekati, sadakaja, vakëfi, kefaretet, premtimet etj. Ato janë për të siguruar një

jetë të dinjitetshme për individin dhe të realizojë lumturinë e tij, ekzistencën e tij në një rreth me ngrohtësi e siguri, bashkim dhe paqe. Zekati të cilin e ka bërë feja jonë obligim, nuk jepet vullnetarisht, por është obligim i detyrueshëm për të mbrojtur të pamundurrit. Zekati është obligim pasurie, nxjerrja e tij është shenjë e imanit dhe argument i bindjes së thellë. Atë e jep myslimani për solidaritet shoqëror dhe mbjell miqësi e ngrohtësi e përhap bashkëpunim ndërmjet individëve dhe shoqërisë. Zekati nuk është një epërsi e të pasurve ndaj të varfërve, që e japin atë të pasurit dhe e pranojnë të varfrit si të përlulur, përkundrazi është e drejtë e të varfërve në pasurinë e të



pasurit. I Lartësuarit thotë: “*Dhe ata që nga pasuria e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar. Për hypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp.*” (El Mearixh, 24 dhe 25).

(Njeriu i pasur mbulon nevojat e veta familjare dhe tepricën ua jep të varfërve). Me atë gjest e ruan pasurinë dhe e zhvillon atë edhe më shumë. Zekati është mburoja e pasurisë nga ziliqarët dhe kriminelët mëkatarë. Për këtë Pejgamberi a.s. thotë: “Fortifikojeni pasurinë tuaj me zekat dhe shëroni të sëmurit tuaj me sadaka, përgatituni për bela (sfidë) me lutje.” (Taberani).

Sigurimi shoqëror dhe nevoja e tij

Sigurimi i ndërsjellë shoqëror do të thotë të jenë individët e popullit në sigurinë e shoqërisë së tyre. Dhe që çdo njeri që ka mundësi ose që ka pushtet ta ndihmojë me të mira shoqërinë e tij. Për të ruajtur durueshmërinë e ngritjes shoqërore dhe të ndiejë (kryejë) çdo kush detyrat në këtë rreth veprimi, nëse vonohet (si pasojë), mund të çojë te rrënim i tij. Ky kuptim përfshin sigurinë shoqërore dhe ndihmat shoqërore. Ato janë garanci shoqërore. Ne mjaftohemi të vërtetojmë se rrethana në të cilën jetojmë tash është shumë e nevojshme të kemi garanci shoqërore e cila shpreh vëllazërimin e besimit dhe frytin e lidhjes shpirtërore, ekonomike e kulturore, të cilat lidhin individ të shoqërisë me njëri-tjetrin. Andaj zekati është metodë për afim të hapësirës ndërmjet të pasurve dhe të varfërve. Përkundër asaj që Islami e sheh të natyrshëm dallimin ndërmjet të pasurve dhe të varfërve në furnizime, por megjithatë nuk ka thirr në atë që i pasuri të pasurohet më shumë dhe i varfëri të varfërohet më shumë dhe ashtu të zgjerohej hendeku ndërmjet dy grupeve, por përkundrazi, Islami ndërhyt dhe nxjerr ligje dhe i afron hapësirat ndërmjet tyre. Ka vepruar për kufizimin e tiranisë së të pasurve dhe për ngritjen e nivelit të të varfërve.

Islami e ka bërë zekatin që pastron shpirtin nga koprracia dhe shpëtim të

trupit nga mëkatet. Stimulon shpirtin me dhënien (e zekatit) dhe ilaç për sëmundjet shpirtërore e falënderime për begati, pastrimi i pasurisë nga ndotjet dhe që zhvillon shpirtin bujar dhe fisnik. (Kjo nxit) bashkëpunim ndërmjet myslimanëve, plotëson nevojat e të varfërve e ruan nderin e tyre nga zgjatja e dorës, duke lypur nga të tjerët. Pasi (ai) është e drejtë obliguese dhe nuk është vullnetare, që i pasuri t’ia lejonte të varfrit kur të donte.

Zekati është shembulli më i lartë për sigurim shoqëror

Zekati është një institucion për sigurim shoqëror. Kështu e cilësojnë shumë ulema, pasi që ai është i obligueshëm me vlerën e tij të caktuar. Zekati ka pasur sukses në shekujt e kaluar të Islamit të përfaqësuar në Ministrinë e Financave. Ai ka qenë në përgjegjësi të halifit në realizimin e zhvillimit ekonomik. Ka qenë mënyra më e qartë e luftimit të varfërisë dhe ka bërë sigurim shoqëror të ndërsjellë. E nxjerr urrejtjen nga zemrat e të varfërve ndaj të pasurve. I ka adaptuar besimtarët në shpenzime e bujari, e ato dyja janë mënyra e punës për atë që nuk ka pasuri. Kështu na bëhet e qartë se zekati ka qenë dhe është mjet real për të mposhtur varfërinë nëpërmes sigurimit, apo u jepet rast të rinjve për punë, duke u dhënë nga fondi i zekatit një shumë të caktuar që ai të filloi biznesin, ose të blej mjete për punë prodhuese. Dhe kështu, zekati bëhet mjet praktik i zhvillimit dhe mposhtje praktike e varfërisë. Kjo vërtetohet nga fjala e Pejgamberit a.s.: “Sadakaja nuk e mungon - nuk e pakëson pasurinë”. Ngase pasuria që shpenzohet, ajo zgjerohet - rritet. Prej saj përfitojnë shumë njerëz, përkundër asaj (kur ka hendek) ndërmjet të pasurve dhe të varfërve. Të varfëritë nuk arrijnë asgjë nga ajo pasuri. Të gjitha këto dobi të japin të kuptosh se zekati është punë e domosdoshme për të përmirësuar (jetën) e individit dhe shoqërisë.

Roli i zekatit në shërimin e ngecjes ekonomike

Ngecja ekonomike është nga problemet nga të cilat po vuan ekonomia botërore, po edhe vendet tona islame nuk kanë shpëtuar nga kjo ngecje. Ngase edhe (bota islame) është anëtare e kësaj shoqërie ndërkom-betare dhe për këto ngecje ekonomike ka disa shkaqe:

Shtimi i mallrave në depo, moszbatimi i tregtarëve-mos kryerja e detyrave të tyre financiare, pakësimi i institucioneve financiare që japin-bëjnë pagesa tatimi të nevojshme. Dhe ngjarje të tjera të ndryshme botërore. Dhe përkundër shumë përpjekjeve dhe propozimeve, për ilaçin e ngecjes ekonomike ende nuk është dhënë rezultat. Kjo ngecje ekonomike ka përfshirë gjithë botën. Dhe prej këtu kanë filluar disa studime në hulumtimin e metodave në ekonominë islame për shërimin e ngecjes ekonomike dhe është bërë e qartë se zekati ka ndikim madhështor në shërimin e ngecjes ekonomike dhe kjo nëpërmes metodave dhe mjeteve të shumta: Zekati ndihmon në prodhim dhe në uljen e papunësisë, domethënë ka fuqi në luftimin e papunësisë. Ai ka ndikim edhe në shpërndarjen e të hyrave të pasurisë kombëtare. Islami ka thirrur të dilet nga adhurimi i dërhemit

Dhe kështu, bota nuk njeh sistem ekonomik si sistemi islam në zgjidhjen e problemeve të tubimit të pasurisë jofunksionale, pa e investuar për përmirësimin e gjendjes jetësore të shoqërisë.

dhe dinarit e të punohet në lëvizjen e kapitalit, të investohet ai mall e të jepet në ato vende ku ka dobi shoqëria. Ka ashpërsuar fushatën ndaj atyre që e deponojnë mallin dhe e bëjnë kapitalin të mbyllur. I Lartësuarit thotë: *“O ju që besuat, vërtet një shumicë e parisë fetare e jehudive dhe e të krishterëve, në mënyrë të paligjshme e hanë pasurinë e njerëzve dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut. Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e Allahut, lajmëroji për një dënim të dhembshëm”*. “Atë ditë kur ajo (pasuri e deponuar) fërgohet në prushin e xhehenemit, e me të (ashtu zharavë) lyhen ballët, anët dhe shpinat e tyre (do t’u thuhet): “Kjo është ajo që e depozituat për veten tuaj, pra shijoni atë që e depozitonit!” (Et Tevbe, 34 dhe 35)

Islami nuk u ndal vetëm në luftimin e deponimit në kufi të bërjes haram dhe kërcënimit të ashpër. Por ka bërë hap praktik që e ka vlerën dhe ndikimin e tij për të vënë në lëvizje monedhat e deponuara, dhe nxjerrjen e tyre nga vendi ku janë deponuar që të luajnë rolin e vet në mëkëmbjen e ekonomisë. Ky hap përfaqëson obligimin e zekatit dhe e sqaron atë se dhënësi i zekatit e jep atë nga fitimi i tij dhe me atë e ruan kapitalin e tij, punon në zhvillimin-rritjen e pasurisë së tij. Ajo qartësohet nga thirrja e Pejgamberit a.s. për investime të nevojshme të mallit që të mos e hajë atë pasuri zekati (nëse rri i deponuar). Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e merr përkujdesjen e një jetimi në pasurinë e

tij, le të investojë atë që të mos e hajë atë (pasuri) sadakaja”.

Kur Pejgamberi a.s. e ka urdhëruar kujdestarin e jetimit të investojë mallin e jetimit (e të rritet ai mall), atëherë është më me përparësi që njeriu të investojë mallin e tij, që të paguajë zekatin nga fitimi i tij me lehtësi, jo (nga pasuria e deponuar). Andaj na është bërë e qartë edhe në kohën e tashme rreziku i deponimit dhe si ndikon në ngecjen e ekonomisë. Po që se nuk investohet, nuk ka aktivitet ekonomik. Kështu vjen deri te inflacioni dhe papunësia. Deponimi i monedhave shkurton fushatën e zgjerimit të prodhimit dhe vendet e punës.

Dhe kështu, bota nuk njeh sistem ekonomik si sistemi islam në zgjidhjen e problemeve të tubimit të pasurisë jofunksionale, pa e investuar për përmirësimin e gjendjes jetësore të shoqërisë. Zekati vepron shpejt, ngase ai e inkurajon poseduesin e mallit në mënyrë indirekte në investimin e mallit derisa të realizohet pasurimi i bollshëm që ia bën (obligim) dhënien e zekatit dhe kështu ka dobi poseduesi i mallit nga investimi i tij në fitim, e shoqëria kanë dobi, duke ua dhënë të drejtën atyre që kanë të drejtë në zekat.

Zekati është mjet i ilaçit të anomalisë ekonomike

Prioritetin më të madh ia kushtojnë ekonomistët në të gjitha shtetet e botës, ilaçit të anomalive ekonomike.

Zekati është mekanizmi për ilaçin e kësaj anomalie apo çrregullim financiar. Ne mundemi të njohim ilaçin e këtij çrregullimi nga dy drejtime: 1- Investimet. 2- Zekati dhe puna e projekteve. Dhe kështu mund të nxjerrim se zekati mund të jetë aksionar efektiv në ilaçin e shumë problemeve ekonomike në shumë shtete të botës, gjë e cila e bën, e ngjall obligimin e (dhënies) së zekatit, punë kjo që është me përparësi të ilaçit të çrregullimit ekonomik.

Disa hulumtues kanë vërtetuar se zekati është fitimprurës i lartë dhe me të bëhet e mundur të mbulohen shumë nevoja shoqërore dhe ekonomike posaçërisht islame.

Zekati dhe lufta e papunësisë

Është e qartë se zekati ndihmon çdo njeri që është i aftë për punë në prodhim. Ai gjen fuqinë prodhuese, duke ia bashkangjitur punësimin e fuqisë së papunë. Dhe me atë bëhet mposhtja graduale e papunësisë. Gjithashtu zekati është thirrje për rregullimin e stimulimin material që ndahet për nëpunësit (që punojnë në tubimin e zekatit). Është e qartë se, sa më shumë që mundohet nëpunësi për tubimin e zekatit, atij i shtohen të hyrat-të ardhurat nga zekati dhe kështu ngrihet pjesëmarrja e nëpunësve në të.

*Marë nga “Minberul-Islami” nr. 6., prill 2013.
Përktheu dhe përshtati: Bajrush Ahmeti*



Mr. Driton Arifi

Trajtimi juridik islam rreth shitblerjes me kapar

Njëra ndër veçoritë e sistemit ekonomik islam në përgjithësi, është edhe elasticiteti dhe përshtatshmëria e tij me rrethanat e ndryshme kohore apo ato të vendit, me kusht që të ruhen kriteret juridike islame në to.

Natyra e kontratave ekonomike-financiare është se ato në parim llogariten të jenë brenda kornizës së ligjshmërisë në jurisprudencën islame dhe si të tilla lejohen, përderisa nuk gjejmë ndonjë argument specifik që e ndalon atë, ose të mos bjerë ndesh me ndonjë rregull ose parim juridik të njohur në të drejtën islame. Megjithatë ka kontrata për të cilat, për shkak të paqartësisë ose mossaktësisë së argumenteve gjegjëse, lindin edhe divergjencat e juristëve islamë. E tillë është edhe shitblerja me kaparë.

Shitblerja me kapar, ani pse duket e re për nga natyra e saj, megjithatë, ajo daton qysh herët dhe ishte prezente edhe në periudhën profetike të Muhamedit s.a.v.s..

Nocioni dhe përkufizimi i kaparit në të drejtën juridike islame

Kapari si koncept në sistemin ekonomik islam ndryshe njihet me termin (*El-Arbunu*), ose e gjejmë edhe me shprehjen- *El-Urbunu*) në literaturën e hadithit por edhe në atë juridike, e që nënkupton:” atë gjë me vlerë ose shumë të parave që paguan blerësi për shitësin, me kusht që nëse ai blerësi e merr mallin e kontraktuar, shuma e tillë e dhënë si kapar të llogaritet pjesë plotësuese e pagesës

totale-çmimit, e nëse nuk e merr blerësi atë mall të kontraktuar, shuma e kaparit takon shitësit, dhe nuk ka të drejtë blerësi të kërkojë kthimin e saj tek ai”¹.

Në literaturën juridike islame kaparin në disa raste e hasim si lloj të veçantë të shitblerjes, e në disa të tjera e gjejmë si kushtëzim i caktuar që kushtëzohet nga ana e blerësit në cilëndo shitblerje, ose thënë ndryshe kushtëzim me të drejtë prishjeje të kontratës nga ana e blerësit-*Hijaru shart*.

Madje kapari është një shprehje që jo rrallë herë përdoret edhe në kontrata të qirasë në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Ai në fakt mund të cilësohet edhe si pagesë e dëmshpërblimit për bllokim të mallit nga ana e blerësit të tij, për shkak të moslejimit të ekspozimit të tij në treg për shitje. E nëse nuk ekzekutohet ajo kontratë, shitësi i atij malli është humbës në kohë, ngase i është vonuar shitja e mallit pa fajin e as dëshirën e tij.

Por, siç vërehet edhe nga definimi, kapari është një lloj garancioni nga ana e blerësit, me të cilin ai pretendon se do ta marrë mallin e kontraktuar e nuk do ta zhvleftësojë atë kontratë. Ndërsa vendosshmërinë e tij për ekzekutim të kontratës e shpreh me anë të pagesës së një shume të caktuar në vendin e kontraktimit të shitblerjes. Madje për të krijuar përshtypjen e seriozitetit, blerësi pajtohet që, atë shumë të dhënë si kapar, do të jetë i

gatshëm që t’ia dhurojë shitësit, nëse ai-blerësi nuk do ta ekzekutojë marrëveshjen e kontraktuar ose nuk do ta marrë mallin e blerë.

Nga ky definim vërehet se “kapari-*El-Arbunu* - ia konstaton një mundësi dhe të drejtë vetëm blerësit, atë të ekzekutimit ose edhe të prishjes së asaj kontrate.

Divergjencat e juristëve islame rreth ligjshmërisë së kaparit

Nëse hulumtohet në mendimet e dijetarëve klasikë islamë, do të vërehet se shumica e tyre kishin rezerva rreth ligjshmërisë së shitblerjes me kapar. Juristët hanefitë, malikitë dhe ata shafiitë konsideronin se ekzistimi i kaparit në një akt ose kontratë të shitblerjes e bën atë të paligjshme, dhe si i tillë nuk lejohet.² Ata në orientimin e tyre u argumentuan me hadithin e transmetuar nga Maliku e ai nga një njeri i besueshëm e ai nga Amër Ibn Shuaib, nga babai, e ai nga gjyshi i tij se:” *Muhamedi s.a.v.s. e ka ndaluar shitblerjen me kapar*”³.

Por, argument tjetër ata morën edhe faktin se në këtë mënyrë realizohet ngrënia e pasurisë së tjetrit pa të drejtë. Përpos kësaj në këtë lloj marrëveshje kemi edhe kushtëzim të një kontrate në një kohë të pacaktuar dhe të panjohur për palët kontraktuese, dhe kjo



ekzis-
ton një
rregull
e cila i
kanal-
i z o n
v e p -
rimet
e til-
la në
korni-
za ju-
ridike
e kjo
rregull
është:

ndalohet në të drejtën islame⁴.

Ndërsa mendimi i dytë lidhur me këtë lloj të shitblerjes është se kapari lejohet dhe është në përputhje me konditat dhe parimet ekonomike të shariatit islam. Këtë mendim e përkrah Seid Ibn Musejeb, Muhamed Ibn Sirini dhe Imam Ahmed Ibn Hanbeli e të tjerë. Këta të fundit argumentohen me faktin se Umeri r.a. e ka lejuar një gjë të tillë, ashtu siç transmeton Nafi Ibn Abdul Harith se ai ishte autorizuar nga Umeri r.a. për të blerë për të një shtëpi nga Safvan Ibn Umejje, që nëse pajtohet Umeri r.a. do të ishte në rregull, e nëse nuk pajtohet Umeri r.a., ai do t'ia paguajë Safvanit një shumë të caktuar të monedhave. Kjo në të vërtetë është vetë kapari.

Madje gjejmë se disa prej juristëve hanbelitë janë të mendimit që lënia hapur e kohës deri në definimin e ekzekutimit të shitblerjes ose jo, është e dëmshme, andaj duhet që patjetër të caktohet një limit kohor deri tek i cili blerësi do të deklarohej, nëse dëshiron ta marrë mallin e blerë për të cilin ka lënë kapar, ose jo.

Ata kanë bërë edhe arsyetimin logjik duke thënë se kjo shitblerje nuk ka kurrfarë kushti që do të cilësohej i paligjshëm në të drejtën islame, andaj nuk kemi arsye që ta konsiderojmë të pavlefshëm, dhe parimi në transaksionet dhe kontratat ndërnjerëzore është lejues dhe ligjshmëria e tyre, përderisa nuk gjejmë argument që e ndalon atë⁵.

Ndërsa sa i përket argumentimit të

shumicës së dijetarëve me hadithin e lartcituat, këta të fundit mendojnë se ai nuk është hadith që ngrihet në shkallë të mjaftueshme për argumentim, sepse në zinxhirin e tij gjendet një transmetues i paemërtuar. Kjo në fakt tregon për dobësi të hadithit dhe është arsye e mjaftueshme që të llogaritet i dobët-daif, ngase në të gjitha koleksionet hadithit ai transmetohet nga i njëjti zinxhir transmetuesish.

Duket se pikëpamjen e dijetarëve që ishin më tolerantë lidhur me normën e shitblerjes me kapar e ka përzgjedhur edhe Akademia e Fikhut Islam, nën ombrellën e së cilës veprojnë dhe janë anëtarë dijetarë nga të gjitha shkollat juridike e të cilët, ndër të tjera, pas diskutimeve të gjata, vendosën si në vijim:

- Lejohet shitblerja me kapar dhe një kushtëzim i tillë është i ligjshëm në të drejtën islame, vetëm me kusht që të bëhet përkufizimi i periudhës kohore deri në të cilën shitësi do ta priste pagesën nga ana e blerësit e që pastaj ai do t'ia pronësojë edhe realisht mallin e shitur atij.⁶

Arsye tjetër që mund të përforcojë ligjshmërinë e kaparit, është përdorimi i shpeshtë i tij në kontratat e shitblerjeve nga njerëzit gjithandej nëpër botë e rrjedhimisht edhe në botën islame.

Madje, kjo shtrohet si nevojë e kohës, meqë prirja e blerësve për t'i lënë të varur shitësit, pa ndier kurrfarë obligimi në raport me ta, është vërejtur se është shtuar tej mase në kohët e sotshme. Andaj sipas së drejtës islame

dëmi i shkaktuar duhet të evitohet”.

Në rastin konkret vërejmë se nëse shitësit i është thënë se malli i tij konsiderohet i shitur, ngase atë e ka blerë një blerës i caktuar, dhe ata dy kanë bërë kontraktimin e rregullt në mes vete, mirëpo blerësi ende nuk e ka bërë pagesën e shumës së kontraktuar, dhe kjo e bën atë blerës që të mos ndiejë përgjegjësi të mjaftueshme, madje mund të keqpërdorë këtë fakt, siç ndodh jo rrallë. Ai madje mund të mos ndiejë obligim në raport me shitësin dhe ndërkohë pas një periudhe kohore edhe ta prishë në tërësi kontratën e tillë, pavarësisht se shitësin ndoshta e ka lënë në pritje me muaj të tërë ose edhe më gjatë. Ky është një dëm i konfirmuar, e drejta islame synon evitimin e tij dhe dëmeve të tjera të ngjashme, nga cilado palë tjetër qoftë ajo.

1. Dr. Muhamed Revas Kal'ahxi, Mu'xhemu Lugatil-Fukaha (Fq. 276). Bot. Daru Nefais. Bejrut. Bot. I parë. 1996. 2. Dr. Vehbetu Ez Zuhejli, El Fikhu El Islami ve Edil-letuhu (5\3434). Bot. Darul Fikr il Muasir. Damask. Bot. I katërt. 2004. 3. Këtë hadith e evidenton Ebu Davudi në «Sunenin» e tij (Nr. 3502), Ibn Maxheh në «Sunen» (2192), pashtaj Imam Ahmedi në «Musned» (Nr. 6723), si dhe Imam Maliku në «Muvat-tanë» e tij (Nr. 2257). Por këtë hadith shumë hadithologë e kanë cilësuar si të dobët, ngase në zinxhirin e tij ekziston një hallkë e një transmetuesi emri i të cilit nuk është definuar. Shih: Et Telh'is El H'abir, Ibn Haxher El Askalanij (3\39). Bot. Mus-sesetu Kurtuba. Botim i parë. 1995. 4. Shihabud-din Err Rremlij, Nihajetul Mutaxh Ila Sherhil Minhaxh. (3\476). Bot. Darul Fikr. Bejrut. Bot. i parë. 1985. 5. Ibn Kudame, El Mugnij (4\175). Bot. Mektebetul Kahire. Kairo. 1968. Pa numër të botimit. 6. Ky vendim u mor nga Akademia e Fikhut Islam në seancën kërkimore të mbledhjes së tetë me radhë të mbajtur në Darul Bejda-Kasa Blanka-Marok, qershor 1993.

Mr. Rexhep Suma

Thirrja dhe prioritetet në metodologjinë e pejgamberëve (1)

Pejgamberët në metodologjinë e tyre të prioritetëve i mësuan popujt e tyre në shkollën e adhurimit të pastër me vetëdije dhe sinqeritet. Robëri e vërtetë është robëria e zemrës. Nëse kjo pjesë e trupit është e shëndosh ndjehet i shëndosh i tërë trupi.

Duke iu referuar historisë dhe jetës së të dërguarve, rezulton se ata gjatë misionit të tyre përdorën metodologji të ndryshme sepse edhe sfidat i patën të ndryshme, edhe pse që të gjithë kishin një objektiv, besimin e pastër në një Zot të vetëm. Këtë më së miri na e saktëson Kurani famëlartë si dhe hadithet e Muhamedit a.s. Për thirrjen e disa të dërguarve flitet në mënyrë të përmblendhur në Kuran, kurse disa ajete flasin hollësisht për misionin e disa prej tyre. Ne si besimtarë islamë nuk bëjmë asnjë dallim mes tyre, që të gjithë i pranojmë dhe i njohim si të dërguar të Allahut dhe nëse një pejgamber nuk e beson atëherë nuk i ka besuar të gjithë të dërguarit.

Popujt e mëhershëm u treguan kryeneç ndaj thirrjes hyjnore, siç thotë dijetari i madh i islamit shejh Abdulhamid Kishk: “Kjo është mendjemadhësia e gënjeshtarit. Nënçmimi i njerëzve dhe mohimi i së vërtetës. Ata e flakën të vërtetën dhe iu shmangën rrugës së drejtë, duke lakuar por edhe të tjerët duke i zhvendosur nga kjo rrugë. Veshën kostumin e tigrës dhe përdorën gjuhën kërcënuese dhe denigruese.”¹

Andaj p.sh. populli i Nuhut a.s. nuk e besoi vetëm atë, por Zoti tha se ata i kanë konsideruar gënjeshtarët të gjithë pejgamberët: “Edhe populli i Nuhut gënjeu të dërguarit.” (Esh-shuara,105).

Ashtu kemi edhe rastin e popullit të Hudit: “Edhe populli Ad nuk i besoi të dërguarit.” (Esh-shuara,123).

Populli i Lutit po ashtu: “Populli i Lutit të dërguarit i konsideroi gënjeshtarë.” (Esh-shuara,160).

Edhe populli i Ejks: “Edhe populli i Ejks të dërguarit i konsiderojnë gënjeshtarë.” (Esh-shuara,176).

Të gjitha këto përbëjnë argumente unifikuese të daves dhe lidhjet e saj të fuqishme të bëjnë që ai që e pranon një pejgamber duhet t'i pranojë të gjithë dhe ai që njërin prej tyre e konsideron gënjeshtar, që të gjithë janë gënjeshtarë.

Prioritetet e thirrjes së Ibrahimit a.s.

Kur jemi tek Ibrahim a.s.(baba i të gjithë profetëve), shohim se vëmendje të madhe i ka kushtuar çështjes së besimit (akides), luftimit të politeizmit. Për këtë Allahu xh.sh. thotë: “Përkujtoju (o i dërguar) kur Ibrahim i tha babait të vet Azerit: “A statuja (idhuj) adhuron për zotat? Unë po të shoh ty dhe popullin tënd në një humbje të sigurt.” (El-Enamë,74). “Ne i dhamë Ibrahimit herët të mbarën, sepse Ne kemi njohur mirë atë (ia dhamë të mbarën se e meritoi). Kur ai babai dhe popullit të vet u: “Ç’janë këto statuja që i adhuron?” (El Enbija, 51-52).

Në një ajet tjetër thuhet: “Kur babait të vet dhe popullit të vet i tha: “Çka është ajo që ju adhuron?” A në vend të Allahut doni zotat të trilluar?” (Es-Safat,85-86).

Ibrahimi a.s. shihte se devijimi i tyre shoqëror ishte si pasojë e politeizmit i cili i kishte shmangur ata nga e vërteta hyjnore të cilën e kishin komunikuar të dërguarit para tij.

“(Përkujto) Kur Ibrahim tha: “Zoti im! bëje këtë qytet të sigurt dhe më mbro mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve (statuja gurësh). Zoti im! ata vërtet i shmangin (nga rruga e drejtë) shumë njerëz. E kush më respekton mua, ai është imi (në fe), e kush më kundërshton mua, atëherë Ti je që fal dhe mëshiron.” (Ibrahim, 35-36).

Duke vështuar me vëmendje kritike gjendjen shoqërore të popullit të Ibrahimit, imagjinojmë se ishte një shoqëri që ishte zhytur thellë në paganizëm dhe daveti i tij kryekëput kishte të bënte me besim dhe nxjerrjen e tyre nga kjo idhujtari.

Populli i Lutit a.s. ishte kundër natyrës njerëzore

Kur kalojmë te historia e Lutit a.s. edhe pse disa thonë që kanë jetuar me Ibrahim a.s. në të njëjtën kohë, por kemi krejtësisht një peizazh tjetër të gjendjes së popullit të tij. Ajo shoqëri jetonte kundër natyrës njerëzore, ishin shndërruar në homoseksual.

“(Të mjerët ju) A shkoni pas meshkujve të kësaj bote. E gratë tuaja i leni anash, të cilat Zoti juaj i krijoi

për ju! Por ju jeni një popull që kaloni çdo kufij!” Ata i thanë: “O Lut, nëse nuk pushon (nga kjo që na thua), me siguri do të jesh i dëbuar prej nesh!” (Esh-Shuara, 165-167).

Përveç thirrjes për besim në një Zot, Luti a.s. prioritet kishte edhe thirrjen e tyre që ata të largohen nga e shëmtuara, gjë që ishte një risi që asnjë shoqëri tjetër e pejgamberëve nuk ishte ballafaquar me të. Andaj edhe fokusi i tij i thirrjes ishte po në këtë drejtim: “Përkujto kur popullit të vet Luti i tha: “A punoni të shëmtuarën, që asnjë nga popujt e botës nuk e bëri para jush”. Vërtet, ju të shtyrë nga epshet u afroheni burrave duke i lënë gratë. Po ju jeni popull i shfrenuar”. (El Arafë, 80-81).

Kurse në një ajet tjetër urdhëron: “(Dërguam) Edhe Lutin, i cili popullit të vet i tha: “Ju, bëni aq punë të shëmtuar sa askush para jush nga tërë bota nuk e ka bërë”. Ju jeni që kontaktoni meshkujt, që sulmoni njerëzit në rrugë, që në vendtubimet tuaja bëni punë të ndyta.” (El Ankebutë, 28-29).

Prioritet i Shuajbit a.s. përveç thirrjes në besim ishte vendosja e drejtë e peshores dhe matjes

Kur shpalosim ngjarjet e Shuajbit a.s. në popullin e tij, përveç besimit në një Zot, si dukuri e hasim se ata e kishin bërë shprehi ambiente që mos të peshonin drejt peshojën dhe matjen.

“E në Medjen (dërguam) vëllanë e tyre Shuajbin. Ai tha: “O populli im, adhuron Allahun (një), ju nuk keni zot tjetër pos Tij. Juve ju erdhi mrekullia nga Zoti juaj. Zbatoni drejt matjen dhe peshojën, e mos u bëni padrejtësi njerëzve në sendet e tyre, dhe mos bëni çrregullime në tokë pas përmirësimit të saj. Këto janë më të dobishme për ju, nëse jeni besimtarë.” (El Arafë, 85).

Kurse në një ajet tjetër kuranor thotë: “Medjenit (i dërguam) vëllanë e



tyre Shuajbin që ju tha: “O popull im, adhurojeni Allahun, ju nuk keni Zot tjetër pos Tij, mos matni as mos peshoni mangët, unë po shoh se jeni në gjendje të mirë jetësore, pra unë po frikësohem për ju nga dënimi që do t’ju përfshijë një ditë!” (Hud, 84).

Faraoni në kohën e Musait a.s. ishte një despot i vërtetë

Kurse kur jemi te koha e Musait a.s. kemi krejtësisht një gjendje kohore tjetër. Në atë shoqëri sundonte Faraoni i cili ishte shndërruar në despot dhe vrasës i popullit të tij, dhunonte të drejtat e tyre dhe i kishte veshur vetes attribute të Zotit: “Përkujto (o i dërguar) kur Musai i tha popullit të vet: “O popull imi, përkujtoni dhuratën e Allahut ndaj jush, kur në mesin tuaj dërgoi pejgamber, ju mundësoi të jeni sundues dhe ju dha çka nuk i dha askujt nga popujt. O popull imi, hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu ua premtoi, dhe mos u ktheni mbrapa, pse atëherë ktheheni të dëshpëruar.” (El Maide, 201-21).

Musai a.s. ashtu siç iu drejtua popullit të vet, ashtu iu drejtua edhe Faraonit zullumqarë: “I shkoni i thoni atij: “Ne jemi të dy të dërguar të

Zotit tënd, lëshoi Beni Israilët të vijnë më ne, e mos i mundo! Ne kemi ardhur me argumentet nga Zoti yt, e shpëtimi është për atë që ndjek rrugën e drejtë.” (Taha, 47).

Kështu, pra secili pejgamber u mundua të bënte reforma shoqërore dhe kishte specifikat e saj. Andaj, secili punonjës në këtë rrugë duhet së pari të forcojë besimin në Allahun te populli (xhemati) dhe së dyti secila shoqëri sot ka sfidat e saj që dijetarët e atij vendi duhet të angazhohen që së bashku të ofrojnë zgjidhje për problemet aktuale, kurse në nivele rajonale dhe botërore, s’ka dyshim se dijetarët e ymetit duhet t’i shtojnë takimet e tyre që botës islame t’i japin zgjidhje për problemet që po ballafaqohet shoqëritë islame në erën post-moderne.

Së pari duke u ndalur në tekstet e përgjithshme, ajetet kuranore na e zbërthejnë faktin se të gjithë popujt kishin të dërguar: “Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largohuni djajve (adhurimit të tyre)!” (En-Nahl, 36).

Komentatori i Kuranit, Taberiu, duke komentuar këtë ajet kuranor shprehet se Zoti me anë të këtij ajeti na e bënë të qartë se çdo popull para nesh kishte të dërguar, ashtu siç ka dërguar në mesin tonë që të adhurojmë të vetmin Zot dhe askënd tjetër.²

Feja e të gjithë të dërguarve ishte një, kishin një thirrje që thirrësit i ndjekin hapat e tyre. “Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: nuk ka Zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!” (El Enbija, 25).

Të gjithë pejgamberët që ishin para Muhamedit a.s. dhe librat e tyre nëse i përmbledhin me një fjalë, kanë të bëjë me faktin se baza e tyre ishte urdhërimi në bindjen ndaj Allahut si të vetmit që meriton adhurim, sqarimin se vetëm Ai është Zot i vërtetë dhe çdo adhurim dhe përkushtim tjetër pos Tij është i kotë.

Kurse sa i përket teksteve detajuese nga Kurani për thirrjen e disa pejgamberëve, Allahu thotë: “E patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai i tha: “O populli im, adhuroni vetëm Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin Tuaj në një ditë të madhe!” (El Arafë, 59).

Kurse në lidhje me thirrjen e të dërguarit Hud. a.s. Allahu thotë: “Dhe te (populli) Adi (dërguam) vëllanë e tyre Hudin, e ai tha: “O populli im, adhuroni (një Zot) Allahun, ju nuk keni zot pos Tij, a nuk po frikësoheni?!” (El Arafë, 65).

“Populli i Hudit, Adi, ka zënë hapësirë në shumë sure kuranore si në suren El Bekare, Ibrahim, Furkan, El Ankebut, Sad, Kaf. Dhe ishte populli i parë që pas tufanit kishte adhuruar idhujt.”³

Ndërkaq në lidhje me daven e Salihut a.s. thotë: “Edhe te (populli) i Themudit u dërguam vëllanë e tyre Salihun, e ai iu tha: “O populli im, besojeni Allahun (një) nuk keni zot tjetër pos Tij. Që ju erdhi argumenti nga Zoti juaj. Ja, kjo deveja është mrekulli për ju. Lëreni këtë të lirë të hajë në tokën e Allahut dhe kurrsesi mos e merrni me të keq, e t’ju kapë dënim i dhembshëm.” (El Arafë, 73).

Për thirrjen e Ibrahimit a.s. thotë: “Dhe Ibrahimin (e dërguam) kur ai popullit të vet i tha: “Adhuroni Allahun dhe keni frikë prej Atij, se kjo, nëse e kuptoni, është shumë më mirë për ju. Ju në vend të Allahut jeni duke adhuruar vetëm idhuj që i trilloni vetë si gënjeshtarë. S’ka dyshim se ata që i

adhuroni në vend të Allahut, nuk posedojnë furnizimin tuaj, pra kërkonin furnizimin te Allahu, adhuroni Atë dhe shprehni falënderimin Atij, pse te Ai do të ktheheni”. (Ibrahim, 16-17).

Por për Shuajbin a.s. Allahu thotë: “Edhe Medjenit (i dërguam) vëllanë e tyre Shuajbin që ju tha: “O popull im, adhuroni Allahun, ju nuk keni Zot tjetër pos Tij, mos matni as mos peshoni mangët, unë po shoh se jeni në gjendje të mirë jetësore, pra unë po frikësohem për ju nga dënimi që do t’ju përfshijë një ditë!” (Hud, 84).

Kurse për thirrjen e Isait a.s., thotë: “Bënë kufër (mohuan të vërtetën) ata që thanë: “Allahu është ai, Mesihu, bir i Merjemes”. E vetë Mesihu, (Isai) tha: “O Beni Israil, adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij Xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.” (El Maide, 72).

Kurse kur jemi te thirrja e Muhamedit a.s. në lidhje me të Allahu xh.sh. thotë: “Thuaj: “Ejani t’ju lexojë atë që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu të mendoni thellë.” (El Enamë, 151).

Sahabiu i nderuar, Alkame bin Mesud r.a. ka thënë: “Kush dëshiron të shikon në porosinë e Pejgamberit a.s. në të cilën ndodhet vula e tij, le të lexon ajetet 151 dhe 152 të sures El En’amë.”

Këto ajete edhe shumë të tjera të ngjashme na sinjalizojnë se të gjithë të dërguarit e Zotit, thirrën në besimin e pastër në një Zot, kurse ajo që ndodhi me vonë kur njerëzit devijuan vijën e shpalljes duke ndryshuar amanetin hyjnor të legjislatrave të mëhershme ishte ndërhyrje e pastër e tyre në këto shpallje. Dhe andaj patë nevojë dhe u ndje domosdoshmëria që Allahu të dërgon Muhamedin a.s. profet dhe ta shpall Kuranin si libër të fundit hy-

jnorë të zbritur për botën.

Atë e ruajti Allahu nga çdo devijim dhe ruajti pastërtinë shpirtërore dhe trupore nga të ligat dhe devijimet sociale që ishin prezentë në atë kohë, ku ishin devijuar vlerat dhe morali. U rrit dhe u formua nën kujdesin e të Madhërishmit për të bartë amanetin dhe fuqinë e Kuranit te njerëzimi. Ai shpërndau Islamin dhe vlerat e tij me urtësi, argumente dhe vizioni i tij ishte të ndryshoj së pari shoqërinë e Mekës, pastaj Medinës dhe madje rrezja e ndryshimit dhe frymës hyjnore përfshiu edhe shoqëritë dhe popujt e tjerë anekënd botës.

Ai filloi të komunikonte me shtetet fqinje duke dërguar sahabë që këtë shpallje t’ua komunikonin të tjerëve. Kështu që duke dërguar Muadhin në Jemen ia mësoi këtë metodologji të thirrjes duke i thënë: Transmetohet nga Muadhi r.a. se ka thënë: “Më dërgoi i Dërguari i Allahut e më tha: “Ti do t’i vish një populli prej Ehli Kitabit (të cilëve u është shpallë libri, të krishterëve apo jehudëve), andaj thirri ata në dëshmi se nuk ka zot përveç Allahut dhe se vërtet unë jam i dërguari i Allahut. Nëse ata kësaj i binden atëherë mësoi ata që Allahu i ka urdhëruar me pesë namaze çdo ditë e natë, e nëse edhe këtë e pranojnë, atëherë mësoi ata që Allahu i ka obliguar me sadaka (zekat) të cilën do t’ua marrish pasanikëve të tyre e do t’ua japësh të varfërve të tyre, e nëse edhe këtë e pranojnë, atëherë ruaju (mos merr) nga gjërat e çmueshme të pasurisë së tyre. Dhe ruaju nga mallkimi (nëma) e të dëmtuarit, sepse në mes mallkimit të tij dhe Allahut nuk ka perde (pengesë).” (Buhariu).⁴ Pra, këtua Muadhi ua shpjegoi formulën e Islamit, shehadetin, e cila është baza e fesë dhe pa të nuk pranohet asgjë.

1. Abdulhamid Kishk, Mea el mustafin el ahjar, Darun-beshir littibaati ven neshr ve tevzi, Kajro, pa vit botimi, f.18. 2. Ebu Xhafer Muhamed bin Xherir Et-taberi, Xhamiul bejan fi te’vili el kur’an,v.14, Daru el kutub el ilmije, Bejrut, botim i parë, 1992, f. 103. 3. El Imam Hafidh Ebu el Fida Ismail bin Kethir El Kureshi Eddimeshki, Kisasu el Enbija, Muessasetu En-nur linneshri ve ettevzi, Mensure, botim i 5, 1997, f.130. 4. Sahibul Buhari, Fet’hul Bari, .v.3,f.322, nr.1458.

Nuridin AHMETI

Kosova e viteve të 70-ta. Si duhet të shkruheshin tekstet shkollore

Dokumentet e hulumtuara së voni na tregojnë se si qëndronte puna me përpilimin, hartimin dhe ribotimin e teksteve për shkollat fillore dhe ato të mesme në Kosovë në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar, pra në kohën e ish-sistemit komunist.

“Historia e Kosovës duhet të shkruhet nga kosovarët, por nga kosovarët që jetojnë në vitin 2011, jo në vitet 1970 apo 1980, jo histori që është shkruar në periudhën e Enver Hoxhës apo Titos”.¹

Kjo është njëra nga deklaratat e ish-ministrit të Punëve të Jashtme të Turqisë z. Ahmet Davutogllu, dhënë gjatë vizitës së tij zyrtare në kryeqytetin e Kosovës. Kjo deklaratë, po edhe disa të tjera të zyrtarëve turq, kanë nxitur reagime nga më të ndryshmet në vendin tonë. Kjo është edhe njëra nga arsytet përse vendosëm që një citat të tillë ta vëmë në ballë të këtij shkrimi.

Ndër debatet më të zjarrra në vitet e fundit që janë zhvilluar në Kosovë dhe jo vetëm, është edhe ai për (ri)shkrimin e teksteve shkollore, pra të teksteve për shkollat fillore dhe ato të mesme.


Ndonëse u kërkua edhe rishkrimi i teksteve të tjera mësimore, si bie fjala i atyre të shkencave natyrore, për to nuk është se u bë e madhe kjo punë, ama për sa u përket teksteve të historisë dhe të letërsisë, u çua shumë pluhur dhe u bënë mjaft fjalë që anonin sa pro e sa kundër.

Kjo mori edhe më shumë hov sidomos pas vizitës së ish-ministrit të Arsimit të Turqisë në Prishtinë z. Omer Dincer, më 18 gusht 2011, i cili, sipas asaj që u prezantua në mediet tona- kishte kërkuar nga ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë së Kosovës, z. Ramë Buja, largimin e fjalëve fyese nga tekstet e historisë që kanë të bëjnë me turqit dhe Perandorinë Osmane.

Reagimet e opinionit ishin, si kurse u tha, pro dhe kundër kësaj

deklaratë të ministrit turk, dhe për këtë u shkruan edhe shkrime. Por, marrë në përgjithësi, kjo çështje nuk u prit mirë në mediet tona të shkruara dhe elektronike. Këtyre reagimeve të medieve dhe analistëve ish-ministri Ramë Buja u ishte përgjigjur, duke e mohuar se homologu i tij turk kishte kërkuar një gjë të tillë, duke u shprehur se: “As ai, pra ministri turk, nuk ka kërkuar që të ndërrohet historia, e aq më pak ne mund të lejojmë të ndodhë një gjë e tillë... Ajo që ka ndodhur, ka ndodhur. Ne nuk mund të bëjmë ndryshime. Ajo që është kërkuar, ka qenë edhe kërkesë e Komisioni Evropian që të hiqen nëse ka shprehje fyese, kaq nuk ka pasur asgjë tjetër”.²

Por, me gjithë këtë debat, që u zhvillua në Prishtinë, Tiranë, Shk-



up etj., shumë pak intelektualë patën guximin ta thonë se si ishte puna e shkrimit të teksteve shkollorë, posaçërisht të atyre të historisë edhe në vitet e mëhershme. Përkitazi me këtë, historiani prof. dr. Pëllumb Xhufi në një intervistë dhënë në një mediumi të shkruar, do të shprehej: “Në dijeninë time, në vitet 1930 Italia i bënte presion Zogut të “rektifikonte” disa pasazhe të historisë së Shqipërisë në frymën e “miqësisë” shqiptaro-italiane; në vitet 1950 akademikët sovjetikë “u sugjeronin” historianëve shqiptarë të evidentonin në tekstet e historisë vetëm anën pozitive të marrëdhënieve shqiptaro-slave. Dhe, më në fund, në vitin 2004, nën presionin e qeverisë greke, qeveria shqiptare pranoi të krijohej një komision i përbashkët greko-shqiptar për “rishikimin” e teksteve tona të historisë. Nënshkruesit e peticionit janë që të gjithë aq të rritur, sa t’u kujtohet ky fakt. Duhet të jenë, gjithashtu, aq të ditur sa ta kuptojnë se ç’donte të ndryshonte pala greke në tekstet tona të historisë.... Nga shembujt e mësipërm rezulton se të gjitha shtetet e mëdha kanë dashur të gjitha “ta ngjyjnë” paksa dorën në historinë tonë. Kështu, Italia dikur, Bashkimi Sovjetik, Greqia dhe, siç po duket, edhe Turqia. Por asnjëherë nuk është shënuar një reagim kaq i ashpër, sa ky i fundit ndaj Turqisë. Unë nuk e vë në dyshim se këtu ka një qëndrim të paragjykuar, prej nga vjen edhe një reagim kaq shumë shproporcional”.³

Pavarësisht nga ajo që u tha, nuk na u tregua se si ishte rregulluar më herët çështja e shkrimit të teksteve shkollorë të shkollave fillore dhe atyre të mesme në Kosovë.

Dokumentet e hulumtuara së voni, na tregojnë se si qëndronte puna me përpilimin, hartimin dhe ribotimin e teksteve për shkollat fillore dhe ato të mesme në Kosovë në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar, pra në kohën e ish-sistemit komunist.

Tekstet shkollorë në Kosovë më 1971

Këto përfundime nxirren nga Pleqësia e Arsimit të KSA të Kosovës e nga mbledhja e mbajtur në Prishtinë më 2 korrik të vitit 1971. Mbledhja mbahet në korrik, me qëllimin që përfundimet e nxjerra nga kjo pleqësi të hynë në përdorim në vitin shkollor më 1971, apo siç thuhet në dokumente, këto procedura duhet të përfundojnë “*më së largti gjer më 15 shtator 1971*”.⁴

Se si duhej të rregullohej shkrimi, botimi dhe ribotimi i teksteve shkollorë në këtë vit, kuptojmë nga vendimet apo siç është e potencuar në dokument Konkluzat e Pleqësisë së Arsimit të KSA të Kosovës mbi lejimin edhe përdorimin e teksteve dhe manualëve shkollorë, siç quhej atëherë, në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës.

Këto konkluzat ishin marrë nga Pleqësia e Arsimit e asaj kohe e Kosovës, të cilat më pas ishin vendosur në letër. Një kopje të këtij dokumenti e posedojmë edhe ne, i cili ruhet në Arkivin Shtetëror të Kosovës në Fondin e Bashkësisë Krahinore për Punë Shkencore, kutia numër 24.

Gjithsej, janë shtatë pika që ky komision i ka vendosur se si do të duhej të shkonte mbarëvajtja e teksteve shkollorë në këtë kohë në Kosovë.

Komisioni nxjerr përfundimin se në vendin tonë mund të përdoren vetëm ato tekste shkollorë që kanë pëlqimin e *organeve kompetente arsimore* dhe se patjetër këto tekste duhet t’i nënshtrohen *doemos procedurës së lejimit*.

Sigurisht, se për t’u përdorur një libër shkollor duhet pajisur me leje, që aso kohe e jepte Pleqësia e Arsimit të RS të Serbisë respektivisht Pleqësia e Arsimit të KSA të Kosovës.

Për mendimin tim, ajo që është

për t’u theksuar në këtë rast, është fjala për tekstet shkollorë të shkencave shoqërore, posaçërisht për fushën e gjuhës dhe historisë. Pleqësia e nxjerr konkluzionin dhe tërheq vërejtjen për vëmendje të shtuar ndaj këtyre fushave, për arsye të “*përmbajtjeve specifike*” - theksohet në konkluzion. Sidomos, Pleqësia porosiste që të kihej kujdes te përmbajtjet e teksteve ku flitet për ngjarjet dhe jetën e njerëzve të ish-Jugosllavisë.

Për të qenë me korrektë me lexuesin e nderuar, përmbajtjen e dokumentit në fjalë po e botojmë në tërësi, pa bërë ndonjë ndërhyrje.

“Konkluzat të Pleqësisë së Arsimit të KSA të Kosovës mbi lejimin e dhe përdorimin e teksteve dhe manualeve shkollorë të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Për një zbatim më të suksesshëm të nenit 2, pika 4 e Ligjit mbi Pleqësinë e arësimit të KSA të Kosovës që ka të bëjë me lejimin e teksteve dhe të manualeve shkollorë për shkollat fillore e të mesme/Fletorja zyrtare e KSA të Kosovës nr. 3.70. Pleqësia e arësimit në mbledhjen e datës 2 korrik 1971 nxori këto KONKLUZAT

Në shkollat fillore e të mesme në Kosovë mund të përdoren të gjitha ato tekste dhe manualë shkollorë që janë të lejuar prej organeve kompetente të arësimit.

Tekstet dhe manualët shkollorë që nuk janë lejuar prej organeve kompetentë, e që tani po përdoren në shkollat fillore e të mesme, duhet t’i nënshtrohen *doemos* procedurës së lejimit, dhe një procedurë e këtillë duhet të marrë fund më së largti gjer më 15 shtator 1971.

Tekstet dhe manualët shkollorë që nuk janë lejuar gjer në këtë afat nuk mund të përdoren në shkollat fillore dhe të mesme. Lejen për t’u përdorë tekstet dhe manualët shkollorë në shkollat fillore e të mesme e jep Pleqësia e arësimit të RS të Serbisë, respektivisht më parë këtë leje e ka dhënë Pleqësia e arësimit të RP të Serbisë, apo Pleqësia e arësimit të KSA të Kosovës,

KONKLUZA¹ MBI PLEQËSISË SË ARËSIMIT TË KSA TË KOSOVËS MBI LEJIMIN DHE PËRDORIMIN E TEKSTEVE DHE MANUALËVE SHKOLLORË NË KRAHINËN SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

Për një zbatim më të suksesshëm të nenit 2, pika 4 e Ligjit mbi Pleqësinë e arësimit të KSA të Kosovës-që ka të bëjë me lejin e teksteve dhe të manualëve shkollorë për shkolla fillore e të mesme /Platorja zyrtare e KSA të Kosovës nr. 3/70/, Pleqësia e arësimit në mbledhjen e datës 2 korrik 1961 nxori këto

K O N K L U Z A

1. Në shkollat fillore e të mesme në Kosovë mund të përdoren të gjitha ato tekste dhe manualë shkollorë që janë të lejuar prej organeve kompetente të arësimit.

2. Tekstet dhe manualët shkollorë që nuk janë lejuar prej organeve kompetente, që që tani po përdoren në shkollat fillore e të mesme, duhet t'i nënshtrohen domos procedurës së lejimit, dhe një procedurë e kështillë duhet të marrë fund më së largti gjer më 15 shtator 1971.

3. Tekstet dhe manualët shkollorë që nuk janë lejuar gjer në këtë afat nuk mund të përdoren në shkolla fillore dhe të mesme.

Lejen për t'u përdorë tekstet dhe manualët shkollorë në shkolla fillore e të mesme e jep Pleqësia e arësimit e RS të Serbisë, respektivisht më parë këtë leje e ka dhënë Pleqësia e arësimit e RP të Serbisë dhe Sekretariati republikan i arësimit, shkencës dhe kulturës së RS të Serbisë, apo Pleqësia e arësimit e KSA të Kosovës, respektivisht Pleqësia e arësimit dhe kulturës e Kosovës, e Metohisë dhe Sekretariati krahinor për arësim e kulturë.

4. Tekstet dhe manualët shkollorë që janë lejuar prej organeve kompetente të republikave socialiste të Jugosllavisë, mund të përdoren pa ndonjë leje të posaçme.

5. Tekstet dhe manualët e shkencave shoqërore /të gjuhës, historisë etj./ që shtypen të reja, nga shkak i përmbajtjeve specifike, duhet t'i nënshtrohen domos procedurës së lejimit nga ana e Pleqësisë së arësimit të KSA të Kosovës. Lejimi përfshin vetëm ato pjesë të përmbajtjes në të cilat flitet mbi ngjarjet, punën dhe jetën e njerëzve të Krahinës.

respektivisht Pleqësia e arësimit dhe kulturës e Kosovës, e Metohisë dhe Sekretariati krahinor për arësim e kulturë.

Tekstet dhe manualët shkollorë që janë lejuar prej organeve kompetente të republikave socialiste të Jugosllavisë, mund të përdoren pa ndonjë leje të posaçme.

Tekstet dhe manualët shkollorë që janë të gjuhës dhe historisë etj., që shtypen të reja, nga shkak i përmbajtjeve specifike, duhet t'i nënshtrohen domos procedurës së lejimit nga ana e Pleqësisë së arësimit të KSA të Kosovës. Lejimi përfshinë vetëm ato pjesë të përmbajtjes në të cilat flitet mbi ngjarjet, punën dhe jetën e njerëzve të Krahinës.

Tekstet - manualët që shtypen

rishtas si botim i dytë, i tretë etj., i nënshtrohen rishtazi procedurës së vlerësimit dhe lejimit, në qoftë se ndryshimet - plotësimet me karakter përmbajtjeje, metodologjike të përpunimit janë më tepër se 25% nga vëllimi që ato kanë tani.

Çdo tekst manual që është lejuar për t'u përdoruar në shkollat fillore e të mesme në faqen e dytë përmban klauzualën e obligueshme të lejes me numerin e vendit që është dhënë ajo.

Pleqësia e Arsimit e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

*Korrik 1971-Prishtinë.*⁵

Përfundim

Nga materiali arkivor i shfletuar dhe literatura përkatëse, kuptojmë se tekstet shkollorë në Kosovë gjithmonë janë përpiluar në për-

puthshmëri në klimën politike të kohës. Kjo vërehet edhe në një nga pikat e konkluzionit të vendimeve të kohës, ku thuhet se duhet të lejohen për përdorim vetëm ato tekste shkollorë, ku janë të përfshira "vetëm ato pjesë të përmbajtjes në të cilat flitet mbi ngjarjet, punën dhe jetën e njerëzve të Krahinës".⁶

Dhe kjo nënkuptohet se duhet t'u prezantohen ato ngjarje ku flitet pozitivisht. Kjo edhe lehtë është e verifikueshme. Po t'i shikosh tekstet shkollorë në gjuhën shqipe të kësaj periudhe, nga teksti i parë shkollor në gjuhën shqipe i botuar në vitin 1960 (Ali Hadri dhe Milan Perkaj, *Pasqyrë e historisë nacionale shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1960), e deri në fund të rënies së ish-sistemit, e vëren se askund nuk flitet, ta zëmë, për masakrat serbo-malazeze ndaj shqiptarëve gjatë viteve 1912-1913, pavarësisht se raportimet e kohës, dokumentet dhe mbamendja historike, ishin me mijëra shqiptarë që u masakruan pa dallim moshe e gjinie.

Ngjitja e komisioneve kohëve të fundit nga MASHT-i për përpilimin e teksteve shkollorë, nuk është diçka e re për vendin tonë, përkundrazi është e domosdoshme dhe e nevojshme.

Prezantimi i këtij dokumenti tregon, në pika të shkurtra, se si përpiloheshin tekstet shkollorë në Kosovë jo vetëm në vitet e 70-ta, por edhe para dhe pas këtij viti. Kjo tregon edhe se a ka nevojë dhe a duhen rishikuar tekstet e historisë dhe të letërsisë në vendin tonë.

1. Ahmet Davutogllu, "Leksion neootoman", Express, Prishtinë, 27 gusht, 2011. 2. "Mos boni 'bujë' për Historinë", Express, Prishtinë, 23 gusht 2011. 3. "Pëllumb Xhufi: Historia duhet të rishikohet. Peticioni nuk m'u ofrua, por nuk do e kisha nënshtrohet", (Intervistë), Panorama, Tiranë, 30. 03. 2013. 4. Arkivi i Kosovës, (më tej: AK), Fondi (më tej:F), Bashkësisë Krahinore për Punë Shkencore (më tej:BKPSH), Kutia(më tej:j.K), 24, Viti(më tej:V), 1971. 5. AK, F. BKPSH, K. 24, V. 1971. 6. AK, F. BKPSH, K. 24, V. 1971.

Fetije Gashi

Revista “Zani i Naltë” rreth trajtimit të gruas

Numri i parë i revistës “Zani i Naltë” është botuar në tetor 1923. Ajo është revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë deri në vitin 1939.¹ Duke shfletuar atë vërejmë se që në ballinë revista ka të shënuar përmbajtjen: Merret edhe me filozofi, moral, literaturë kombëtare, sociologji.

Ajo del njëherë në muaj. Vazhdimësi e këtij modeli është revista “Dituria islame” që del në Kosovë dhe aty shkruajnë autore vajza dhe gra por edhe ka shkrime të shumta për trajtimin e kësaj tematike të rëndësishme.

Islami sqaron të vërtetën

Feja e vërtetë është urdhëruar prej të gjithë të dërguarve të Zotit dhe për gjithë njerëzimin. Kjo u shpall gradualisht te njerëzimi në mënyrë që të edukohen ashtu si është më së miri. Islami me kuptim të përgjithshëm është emër i të gjithë shpalljeve të Allahut, nëpërmjet peygambereve të tij, të cilët bartën ato misione te popujt e tyre.² Pra edukimi më i mirë është edukimi që ka porositur Zoti. Revista “Zani i Naltë” që në numrin e dytë botim i vitit 1923 sjell një shkrim rreth edukimit të brezave përmes fesë. Me autorë A. Vafi me titullin: Frig’e Zotit asht kry e fillozofisë” ku ndër të tjera shkruhet: Pra ma i forti polic, ma i rrepti gjindarma për njerinë asht frig’e Zotit e jo tjetër”.³

Devijimet e ndyshimet në mendimet fetare na obligojnë që të kërkojmë në bazë të vërtetën rreth ndonjë tematike. Njohuritë kuranore që i paraqiten njeriut në lidhje me kri-

jimin janë dukuritë më të qarta të fuqisë absolute të Allahut xh.sh..⁴ Në këtë kënd është edhe trajtimi që i bëhet gruas nga Islami. Siç e

thotë revista.”Reformat qi mysli-manizmi bani në boten e femnës mund me i dëgjue drejt për së drejti prej Kuranit.”



Trajtimi më i mirë i gruas

Në suren e quajtur Gratë (En Nisa) Allahu i lartësuar bën thirrjen për njerëzit të kenë dronë në Krijuesin i cili krijoi nga një qenie pastaj bëri çiftin e parë (Ademin e Havanë) e prej tyre u shtua njerëzimi. Në këtë ajet thuhet: "O ju njerëz! Kijeni frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kijeni frikë Allahun me emrin e të Cilit përbetoheni, ruajeni farëfisn (akarbllakën), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju"⁵

Sureja En-Nisa është plot me rregulla e dispozita, të cilat rregullojnë çështjet të jetës së myslimanëve. Si çështje me rëndësi parashtron ato që kanë të bëjnë me gruan, me shtëpinë, me familjen, me shoqërinë e gjerë, por pjesën më të madhe ua kushton dispozitave rreth pozitës së gruas, andaj edhe ka marrë emrin Suretu En Nisa-Kaptina e grave. Prej këtu kuptohet sa rëndësi i jep Islami gruas në përgjithësi si vajzë, si motër, si grua, e veçanërisht si nënë.

Revista "Zani i Naltë" në numrin 3 të muajit tetor 1926 në vitin e tretë të botimit përmban shkrimin me titull "Në demokratit detyra sociale e gruas" ku që në fillim bënë përpjekje për ruajtjen e propagandimëve feministe sidomos tek të rinjtë të cilët nuk janë të informuar sa duhet me të drejtën që i jep Islami femrës. Nuk ka asnjë trajtim të vërtetë sa i përket femrës, i vetmi është Islami ngase vie nga Krijuesi që ka krijuar dhe e din pozitën që i ka dhënë për shoqërinë në përgjithësi. Revista në fjalë ka sjellë disa artikuj për këtë fenomen." Në numrat e vjetër të kaluam kan pasun këndue do artikuj mbi të drejtat e gruas, ato të drejta të kuluëme nga burimet e kthelltë morale, para syve t'atynë



që dinë të thellojnë problemet e jetës familjare.⁶

Bazë e shoqërisë

S'ka dyshim se gruaja është elementi kryesor në lindjen, rritjen dhe edukimin e njeriut. Andaj shkollimi dhe edukimi i vajzave është parësor. Edukimi dhe shkollimi i vajzave është obligim islam por edhe revista në fjalë e ka në fokus këtë çështje, ndër të tjera në artikullin e përmendur thuhet. "Për neve, ka një randësi ma të madhe nga të qenunit shumë e ditun, ma mirë të ketë gruaja një edukatë dalluese drejt të vërtetës tue pasun nji fuqië morale të qëndrueshme deri sa të jetë e përgaditun për mirëkqyrjen e detyrave q'i ngarkon natyra."⁷

Familja e veçanërisht gruaja shqip-

tare është pa dyshim elementi kryesor i ruajtjes së fesë dhe kombit. Trajtimi joadekuat ndaj gruas ishte gjithnjë shqetësim i hoxhallarëve sidomos sa i përket temës për ruajtjen e familjes. Shkrimi në revistën "Zani i Naltë" paraqet shqetësimin "Na thonë se dashnija familjare nuk ekziston nder ne", duke sjellë hadithin e të zgjedhurit të Zotit Muhamedit a.s. kur ishte pyetur: Kush është më i plotësuar dhe më i shëndoshi nga feja e Ai ishte përgjigjur: "Ai që shkon mirë, që ushqen dashni, që ndien nderim për familjen e vet."⁸

1. K.M.SH., Zani i nalt, 1923-1925, Tiranë, 2014, Parathënie f. XI. 2. Dr. Zija Abdullahu, Studim krahasimtar i feve, Prishtinë 2010, f. 26. 3. K.M.SH., Zani i nalt, 1923-1925, Tiranë, 2014, f. 49. 4. Kryesia e çështjeve fetare të Turqisë, Islami nëpërmjet haditheve, Islambull, 2017, f. 241. 5. Suretu En Nisa: 1. 6. K.M.SH., Zani i Naltë, 1923-1925, Tiranë, 2014, f. 81. 7. K.M.SH., Zani i Naltë, 1923-1925, Tiranë, 2014, f. 83. 8. K.M.SH., Zani i nalt, 1923-1925, Tiranë, 2014, f. 20.

Kasam Muhameti

A po i kushtohet rëndësi trashëgimisë kulturore islame në Kosovë?!

Shumë vende të zhvilluara që i njohim sot, me kujdes dhe xhelozitë të madhe mundohen që t'i ruajnë gjurmët e të parëve të tyre: gjuhën, fenë, zakonet..., por edhe trashëgiminë kulturore, fjala është për ndërtimet ose monumentet e vjetra, të cilat janë narrativë ose kallëzues konkretë të kohëve të kaluara, si dhe që ruajnë kujtesën materiale dhe shpirtërore.

Këtë kam pasur fatin ta shoh edhe me sytë e mi në disa vende të Lindjes dhe në disa të Perëndimit. Pra, kam vërejtur se janë ruajtur edhe gjëra të mira, por ç'është më e çuditshmja edhe të atilla që janë gjurmë të hidhura të së kaluarës ose të të parëve të tyre. Mendoj se është e rëndësishme për brezat e rinj kur mësojnë diç për

të kaluarën, të kenë mundësi që edhe ta shohin dhe ta prekin dhe të komunikojnë në mënyrë lëndore me kohën e kaluar. E njëjta gjë nuk ndodhi në disa raste edhe në trojet shqiptare. Fjala vjen: në Shqipëri, përveç disa objekteve monumentale fetare që u dëmtuan ose u prishën pjesërisht, madje edhe krejtësisht nga dora e njeriut, u shkatërruan edhe disa gjurmë të

vonshme të diktaturës komuniste, p.sh. busti i Enver Hoxhës e të ngjashme. Edhe në Kosovë ndodhi gati e njëjta gjë; Parullat e "Vllaznim Bashkimit" të ish-Jugosllavisë u zhdukën, gjithashtu, piktura e skulptura - të Titos, edhe përmendore u prishën, p.sh. siç ishte ajo në Landovicë afër Prizrenit që simbolizonte "Vllaznim Bashkimin". Natyrisht, se brezat e rinj vazhdi-



misht janë kureshtarë të dinë për të kaluarën, por si do t'u themi se kemi kaluar nëpër disa faza, dhe se kanë ekzistuar disa gjurmë, kurse sot nuk janë më?! Mirë ose keq, historia duhet të tregohet ashtu si ishte, nuk mund dhe nuk bën të tjetërsohet.

Gjenocidi serb ishte i planifikuar qysh herët në Kosovë, sidomos pas viteve të 1930-ta¹

Fati ynë që i tillë që të mos mund t'ua dimë vlerën gjërave të dobishme ashtu si duhet, por edhe ishim të paralizuar, ngase gati 100 vjet qemë: të sunduar, të shtypur nga një armik i egër - serb..., edhe objekteve kulturore nuk patëm mundësi t'u kushtojmë rëndësi. Ka prej tyre që u përkasin kohërave shumë të lashta - ilire, të periudhës Romake, Bizantine, si dhe Osmane;² Disa të tjera me qëllime të caktuara u shkatërruan në ish-Jugosllavi, siç pati ndodhur me qendrën e vjetër tregtare në Prizren, Xhaminë e Arastës, e cila është ndërtuar në fillim të shekullit XVI, por ajo u shkatërrua në vitin 1960, çuditërisht minarenë e saj e lanë të vetmuar.³ Edhe në periudhën e vonshme të sundimit serb, aty afër kompleksit të vjetër të Prizrenit më 27.03.1999, shkatërruan rezidencën e "Lidhjes së Prizrenit".⁴

Regjimit barbar-shoven Jugosllav-serb, nuk ia panë sherrin vetëm njerëzit - shqiptarë të Kosovës, por edhe arsimimi i tyre, objektet e tyre me rëndësi të veçantë historike e kulturore. Vetëm gjatë luftës së fundit në Kosovë 1997-1999, ushtria dhe policia serbe bëri gjenocid të tmerrshëm, përveç vrasjeve mizore, shkatërroi edhe: 218 xhami⁵, Çarshinë e Vjetër në Gjakovë, në Pejë dhe në Vushtrri.⁶

Shumë arkiva, pllaka, shkrime e dorëshkrime u kidnapuan, disa edhe u dogjën.⁷ Ndërsa disa të tjera, duke mos u ditur vlerën në të gjerët, për fat të keq, i shkatërruam vetë ose i asgjësuaam me dorën tonë.

Kishat ortodokse serbe më të avancuara sesa xhamitë e edhe kishat katolike-shqiptare

Në të kaluarën e tyre, sigurisht edhe tani, serbët ishin të lidhur ngushtë me kishat e tyre,⁸ anipse sistemi i tyre shtetëror është laik. Si duket, këtë më tepër e kanë bërë për t'u mburrur karshi nacionaliteteve të tjera në ish-Jugosllavi, si dhe gjatë aleancës së tyre të fundit Serbi&Mali i Zi, ngase të tjerat republika i përkisnin/asin Katolicizmit dhe

Islamit. Njëkohësisht këtë 'Fytyrë të zezë të tyre' me bekimin e klerikëve të tyre e bënë edhe për t'i nënçmuar, për t'i urrejtur të tjerët në ish-Jugosllavi, si edhe për t'i vrarë, siç ndodhi me shpartallimin e Jugosllavisë gjatë viteve të 1990-ta. Në këtë kontekst, pa luftë shpëtoi vetëm Maqedonia.

Edhe në Kosovë kishat ortodokse gëzonin dhe gëzojnë autoritet të madh. Të ruajtura në mënyrë të veçantë, të mirëmbajtura, sigurisht edhe të financuara nga Serbia. Madje, ato çuditërisht në vitin 2007 janë specifikuar dhe përligjur edhe përmes planit të Marti Ahtisaar-it (i Dërguari i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës) me 5 nene të posaçme si: "Kategori speciale juridike e trashëgimisë kulturore të Kosovës", pra duke e diferencuar etninë ortodokse serbe në raport me popullin shqiptar të Kosovës (pra jo si trashëgimi e përgjithshme kulturore e Kosovës).⁹



Cilat objekte mund ta gëzojnë statusin e trashëgimisë kulturore

Duke pasur interesim për këto çështje, gjatë një bisede me profesoreshën e nderuar prof. dr. Florina Jerliu (profesoreshë e arkitekturës në Universitetin e Prishtinës),¹⁰ veç të tjerash e pyeta se cilat objekte mund të jenë pjesë e trashëgimisë kulturore? Përgjigjja e saj ishte: “Objekte të trashëgimisë kulturore konsiderohen ato që kanë rëndësi të veçantë dhe që i kanë mbushur 100 vjet e më tepër (edhe pse standardet ndryshojnë nga viti në vit), por mund të jenë edhe më të reja që janë me rëndësi më të veçantë. P.sh. NewBorn-i në Prishtinë”.¹¹

Deri në vitin 2016, janë të evidentuara rreth 750 xhami, mbi 200 prej tyre janë ndërtuar pas luftës e këndej¹², kurse përfshirë Preshevën, Medvegjën e Bujanocin, gjithsej 798 xhami.¹³

Rindërtimi dhe ndërtimi i egër në emër të riparimit ose konservimit!

Siç vërejmë, disa objekte të vjetra islame nuk janë ruajtur ashtu si duhet, në radhë të parë nga fakti se strategjia e pushtetit serb ishte që me politikën e tyre edhe shoveniste t'i linte pas dore ose edhe t'i zhdukte gjurmët e vjetra të shqiptarëve të Kosovës, pra gjurmët etnike edhe ato fetare. Këtë taktikë të tyre, që nga viti 1912, ne të gjoerët nuk e kuptuam, dhe me padijen tonë në disa raste ramë në gracka që u shkonte përshtati serbëve. Nuk janë të rralla rastet që kapëm ternakopët dhe shkatërruam pa dhimbje mure të vjetra ose edhe themele me rëndësi të veçantë të thesarit tonë kulturor,

me idenë se do të bëjmë më mirë, do të rindërtojmë me çimento e beton. Për pasojë, ato sot kanë humbur natyrshmërinë e vjetërsisë dhe fatkeqësisht nuk i shohim në kuadër të trashëgimisë kulturore. Kështu, vetë me duart tona përdhosëm historinë e lavdishme të të parëve tanë.

Objektet fetare - islame janë edhe me rëndësi materiale dhe me atë shpirtërore

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e xhamive në shoqëri, pra ato janë në radhë të parë të destinuara për vendadhurim dhe për edukim të komunitetit musliman; ato të vjetrat, të riparuarat, të rindërtuarat ose të mbindërtuarat, pastaj te rejat; paraqesin thesar kulturor. Çështje interesante në Kosovë, se pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, populli aty ku ka pasur nevojë, me vetëfinancim ka investuar, rrallë herë me mbështetje të ndonjë fondacioni të huaj ose vendor. Që do të thotë se edhe kjo është një vlerë në vete që duhet respektuar, me një fjalë, ato automatikisht duhet ta kenë kodin e trashëgimisë kulturore, me rëndësi të veçantë, por edhe nën mbrojtje shtetërore. Pra xhamitë e ndërtuara deri më tani, aq sa ka, ose që ndërtohen në të ardhmen në Kosovë duhet të jenë edhe të mbrojtura.

Sa janë duke punuar institucionet shtetërore në këtë drejtim

Në bazë të disa hulumtimeve të mëparshme,¹⁴ kam vërejtur se në kuadër të trashëgimisë kulturore nga MKRS-ja janë të evidentuara

gjithsej 152 kisha, kurse 141 xhami,¹⁵ që do të thotë se sa u përket xhamive ka një mospërputhje me raportet zyrtare të BIK-ut. Kjo e fundit, nga afro 750 xhami që janë sot në Kosovë, prej tyre ka të evidentuara 304 xhami të vjetra që kanë më tepër se 100 vjet vjetërsi.¹⁶

Përgjegjësia kryesore i mbetet BIK-ut

Në të kaluarën historike të Kosovës BIK-u ka bërë shumë për popullin e tij, por edhe tani është koha që BIK-u të formojë ekip special dhe të përgatisë katalogje të objekteve islame (xhami, tyrbe, mesxhide, mejtepe, medrese..., etj.), pastaj: shkrimeve, dorëshkrimeve, mbishkrimeve... – të vjetra dhe ato t'i evidentojë dhe ndërkohë të bëjë edhe monografi ose enciklopedi me fotografi së bashku me historikun e tyre, dhe më pastaj t'ua ofrojë institucioneve shtetërore dhe të kërkojë prej tyre që të kujdesen më seriozisht për to.

1. Florina Jerliu, “Trashëgimia Kulturore e Kosovës Konceptet dhe Kontekstet e Mbrojtjes”. Botoi Ar-tini, Prishtinë 2017, f.21. 2. Oliver Jens Schmit, “Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ball-kanike”. Botoi Koba, Prishtinë, 2012, f.35. 3. dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=4501, qasja e fundit më:04.07.2017, 3.25 h. 4. Mr. sc. Parim Kosova, SI E DOGJËN KRIMINELËT SERBË - MUZEUN E LIDHJES - Fillimi. pashtriku.beeppworld.del.../parim_kosova_djegja_e_kshp_27.3.09.h..., qasja e fundit 07.07.2017, 19.30 h.. 5. Sabri Bajgora, Dësh-mi rrëgethëse të një gjenocidi-parathënie, në mono-grafinë “Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë”. Botoi BIK, Prishtinë 2000, f.8. 6. Azem Vllasi, “Kosova: Fillimi që nuk harrohet”. Botoi Koba, Prishtinë, 2017, f.690. 7. Noel Malcolm, “Kosova një histori e shkurtër”. Botoi Koba, botimi i 3-të, Prishtinë, 2011, f.439. 8. Orhan Bislimaj, “Marrëdhëniet ndërjetare në Kosovë (1990-2010)”. Botoi Logos-A, 2016, f.122. 9. Florina Jerliu, “Trashëgimia Kul-turore e Kosovës...” op.cit., f.77. 10. Shih më tepër sqarime për këtë: Florina Jerliu “Mbrojtja e Trashëgimisë Ndërtimore”. Botoi Libri Shkollor, Prishtinë 2016. 11. Bisedën e kemi zhvilluar më 01.07.2017, prej të cilës kam kërkuar sqarime profesionale. 12. <https://www.evropaelire.org/al/27752771.html>, publikuar më 23 Maj 2016, qasja e fundit 06.07.2017, 2.35 h. 13. <http://zeri.info/aktuale/42812/kosova-me-742-xhamil>, publikuar më 19 korrik 2015, qasja e fundit 06.07.2017, 2.45 h. 14. Shih një përmbledhje: Kasam Muhamedi në revistën “Dituria islame”, boton BIK-u, Prishtinë, nr.319, f.50. 15. http://www.mkrrks.org/repository/docs/LISTA_E_TRASHEGIMISE_KULTURORE_NEN_MBROJTJE_TE_PERKOSHME_2015.pdf, Nr. 116/2015 09.10.2015. E përpluar me programin PDF, me gjithësej 61 faqe. Qasja e fundit 27.01.2017, 10.30h. Gjithsej 1525 objekte të evidentuara. Kurse gjithsej 168 asete. 16. Shih revistën “Dituria Islame”, nga numri 179-213, të viteve 2006-2008, përgatitur nga Sabri Bajgora dhe Ramadan Shkoda.

Dr. Farhat Zafar

Lajkomania - a jeni të preokupuar me rrjetet shoqërore?

“Nga bukuria e Islamit të njeriut është ta lërë atë që nuk i intereson”. (Neveviu)

Kur i ke vërtetuar për herë të fundit aplikimet e tua për të parë numrin e lajkeve të postimit tënd? Para një minute, apo para një ore? Me rritjen e popullaritetit të medieve shoqërore, lajkomania infektion shumë individë. Kjo është që kur shkruajmë apo ndajmë postimet, bëjmë faqe dhe kalojmë kohën me qëllim të arritjes së famës virtuale në rrjetet shoqërore.

Njerëzit sot janë bërë të varur në paraqitjen e fotove në të cilat tregojnë rrobat e tyre, ushqimin dhe vendet ku shkojnë. Sipas raportit të “Informate Mobile Intelligence”, mesatarisht kalohet rreth 4,7 orë në ditë duke shfrytëzuar telefonët e mençur. Duhet të pyesim: Nëse jemi zgjuar 16 orë në ditë, sa është e mençur të harxhojmë kaq kohë pranë telefonave të mençur? Në këtë tekst do të flasim për shkapërderdhjen e kohës në telefonat e mençur dhe sa e dëmton kjo produktivitetin tonë.

është e mirë për ne apo që ne mund të na tërheqë në polemizim, bile edhe kur ka të bëjë me lajmet e rrëshme. I Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ka thënë: “Nga bukuria e Islamit të njeriut është ta lërë atë që nuk i intereson”. (Neveviu)

Kthimi i vëmendjes kah vetja nëpërmes rrjeteve shoqërore

Qëllimi kryesor i lajkimit në rrjetet shoqërore është tërheqja e vëmendjes nga ana e njerëzve që dëshirojnë të arrijnë famë nëpërmes të folurit për hallallin dhe haramin nëpërmes postimit. Ja disa gjëra me të cilat njerëzit tërheqin vëmendjen kah vetja nëpërmes rrjeteve shoqërore:

1. Martesa

Ndoshta ka të bëjë me personin i cili jeton me ne së bashku në të njëjtën shtëpi, por është bërë

trend urimi i ditëlindjes, njëvjetori ose shprehja e dashurisë në rrjetet shoqërore. Shprehja e dashurisë duhet të jetë gjë private, në veçanti në mes burrit e gruas, e jo që këtë ta shohë tërë bota. Kjo i ngjason shtëpisë nga qelqi, privatësia e së cilës shihet edhe nga jashtë.

2. Ushqimi dhe luksi

Është bërë krejt normale që dikush paraqet postimin: “Mu tani jam vendosur në hotel”, si dhe “Ky është mobili im i ri, laptopi i ri dhe vetura ime e re”. Në këtë mënyrë ne në realitet tërë botës i tregojmë begatitë materiale që na ka dhuruar Allahu xh.sh.

3. Bukuria

“Vëlla sa bukur po dukesh!”, “Nuk je plakur fare!”, “Çfarë recete po përdor?”, “Mami, je artiste!”. Këso komente për disa njerëz janë sikurse drogë dhe nuk mund të jetojnë pa këto. U është bërë ves që të veshën dhe dërgojnë foto me citate, e pastaj vrapojnë

Si rrjetet shoqërore ndikojnë te myslimanët?

Sot është bërë thjesht dhe lehtë të përgjigjemi dhe reagojmë për çdo gjë nëpërmes rrjeteve shoqërore. Reagohet në çdo gjë dhe për gjithçka, bile edhe imtësitë me qëllim të tërheqjes dhe kthimit të vëmendjes kah vetja. Islami na mëson që nuk duhet të përzihemi në diç që nuk



pas lajkimeve. Në kohën e fotoeditimeve djemtë dhe vajzat me dëshpërim lakmojnë për shikim fizik joreal, për selfim të pandërprerë, që të duken persona të rëndësishëm.

4. Agonia

Nuk paraqiten vetëm momentet e lumtura. Njerëzit paraqesin edhe agonitë e tyre dhe momentet e dhembshme të jetës me tërë botën, lidhjen e ndërprerë të dashurisë, divorcin apo çdo gjë që i mundon dhe vuajnë.

5. Obligimet fetare

Është një realitet pikëllues që sjellja e njerëzve në kërkimin e tyre për popullaritet shpesh kalojnë kufijtë e obligimeve fetare. Shumë besimtarë më me gëzim janë të preokupuar me fotografimin e Haremit të Mekës në vend që të bëjnë ibadet.

Dëmet që shkakton lajkomania

1. Humbja e kohës

Njerëzit nuk kuptojnë sa kohë kalojnë dhe harxhojnë në aktivitetet që ndërmarrin me dëshirë që të përfitojnë popullaritet dhe vëmendje. Këto janë sasi të mëdha kohore që mund t'i praktikojmë në përparimin e talentit tonë, ndërsa ne në realitet këtë produktivitet e harxhojmë në promovimin e mobilëve të mençur sikur kukullat në divan.

2. Rrit obsesionin dhe pasigurinë

Kur përpiqemi të fitojmë vëmendjen e njerëzve, ne i rritim aktivitetet tona që na sjellin lajkime. Zgjuar apo në gjumë, gjatë lutjes apo pranë tavolinës fillojmë të brengosemi për këtë. Në realitet, dobia e dynjasë ose humbja na bëhen më të rëndësishme se qetësia e brendshme dhe shpirtërore. Fillojmë të mendojmë çka mendojnë tjerët për ne dhe çfarë bëjnë njerëzit e tjerë. Kjo atëherë tek ne shkakton zili dhe xhelozë dhe na futin në rrethin e pafund të garimit.

Allahu xh.sh. thotë: *“Juve ju preokupoj përprekja për shumimin (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës)! Derisa të mos i vizitoni varrezat (të bëheni banues të tyre - të vdisni).”* (Et - Tekathur, 1-2)

Sa më tepër vendosim gjëra të natyrës materiale, aq më e madhe është mundësia që do të pikëllojmë shumë njerëz dhe refuzojmë nga vetja. Ky mund të jetë shkak që ata të ndihen keq, të turpëruar dhe jomirënjohës për shkak se ata nuk i kanë këto.

Këtu duhet marrë parasysh që secili që i bën lajk fotografisë suaj nuk është e domosdoshme edhe me qenë i lumtur për shkak të suksesit dhe lumturisë tënde, ngase mund të shokoheni pasi të dilni publikisht dhe kuptoni sa nuk jeni të vlerësuar në përputhshmëri me lajkimet në fotot e tua.

3. Pengon dhe shqetëson të tjerët

Kur ndajmë momentet e lumtura, udhëtimet dhe drekat në rrjetet shoqërore, duhet të ruhem nga syri. Syri i keq mund të jetë shkak i ndërprerjes së lidhjeve tona miqësore, sëmundja apo humbja e pasurisë.

Së fundi, duhet me qenë të vetëdijshëm që shumica nuk kanë ato që

ne kemi dhe gjinden në nevoja të mëdha. Sa më tepër vendosim gjëra të natyrës materiale, aq më e madhe është mundësia që do të pikëllojmë shumë njerëz dhe refuzojmë nga vetja. Ky mund të jetë shkak që ata të ndihen keq, të turpëruar dhe jomirënjohës për shkak se ata nuk i kanë këto. Poashtu duhet marrë parasysh që luksi që kemi, Allahu xh.sh. mund të na marrë lehtë kurdo.

4. Nxiti hipokrizi dhe josingëritet

Që një vepër të jetë e pranuar tek Zoti duhet të plotësojë dy kushte: Të ketë bazë në sunetin e Pejgamberit a.s. dhe të jetë e bërë me nijet të sinqertë, qëllimi i së cilës është vetëm kënaqësia e Allahut. Paraqitja në fe quhet akt hipokrizie. Kjo është kryerje e veprave në vend të nijetit për hir të kënaqësisë së Allahut, të kërkohet kënaqësia e njerëzve.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Më së shumti që frikësohem për ju është shirku i vogël”. I thanë: “I Dërguar i Allahut, ç’është shirku i vogël?” U përgjigj: “Syfaqësia! Vërtet Allahu do të thotë në Ditën kur robërit (njerëzit) do të llogariten për veprat e tyre: “Shkoni tek ata para të cilëve jeni paraqitur me veprat tua në dynja, andaj shikoni a do të gjeni ndonjë shpërblim”. (Sunen Ibn Maxhxheh)

Paraqitja nuk është e kufizuar vetëm në ibadet, sikurse namazi apo agjërimi, por ka të bëjë edhe në kryerjen e çfarëdo veprave të mirë siç është sadakaja, ndihmesa e të tjerëve që bëhet në vend të kënaqësisë së Allahut të madhërishtë, e kjo zvogëlon shpërblimin.



PERSONI, TË CILIN NJERËZIT E LAVDËROJNË PËR SHKAK TË DEVOTSHMËRISË DHE DITURISË, MUND TË MEND- DOJË SE NUK KA TË META DHE ËSHTË I PAGA- BUESHËM.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Vërtet veprat vlerësohen vetëm sipas qëllimeve dhe secili njeri do të fitojë vetëm atë që e ka pasur qëllim me veprën e tij, andaj nëse hixhretin e ka bërë në emër të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, hixhreti i tij është i Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ndërsa kush bën hixhret për dobi materiale apo për martesë, hixhreti i tij është për atë që ka pasur qëllim”. (Muttefekun alejhi)

5. Lind kryelartësinë te njeriu

Personi i cili pa marrë parasysh i tregon begatitë që ia ka dhënë Allahu, duke pritur nga njerëzit lajkët, beson se është i vlerësuar te njerëzit bile mund të mendojë se është i superfuqishëm. Kur ne tregojmë dhe publikojmë luksin tonë, pamjen dhe devotshmërinë, do të duhej të kujtojmë paralajmërimet e Pejgamberit s.a.v.s.: “Nuk do të hyjë në Xhenet ai në zemrën e të cilit ka një thërrmi të kryelartësisë”. Një njeri e pyeti: “Vërtet njeriu dëshiron që të ketë rroba dhe këpucë të bukura”. Në këtë Pejgamberi s.a.v.s. tha: “Vërtet Allahu është i bukur dhe e do bukurinë. Kryelartësia është refuzimi i së vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve”. (Muslimi)

Ndërsa mu kjo udhëheq kah forma më e keqe e kryelartësisë, e cila rezulton me rritjen e së ashtuquajturës devotshmëri. Personi, të cilin njerëzit e lavdërojnë për shkak të devotshmërisë dhe diturisë, mund të mendojë se nuk ka të meta dhe është i pagabueshëm.

Kur personi i tillë bie në kurthin e shejtanit të kryelartësisë dhe mendjemadhësisë, nuk ndalet duke kritikuar dhe nënçmuar të tjerët për të metat dhe gabimet e tyre. Nëse kështu sillemi, si mund të jemi të sigurt se veprat e mira na janë të pranuar?

Si të ndalemi duke gjurmuar për famë dhe popullaritet

1. Përmirëso vetëdijen (koshiençën) për veten

Shkakut kryesor që jeta jonë është e ngjyrosur me ngjyrat e huaja është mungesa e ngjyrave personale. Duhet veten ta njohim dhe ta pranojmë ashtu siç në realitet jemi. Duhet vetvetes t'i bëjmë lajke dhe ta harxhojmë kohën tonë me produktivitet. Kjo do të na japë siguri që në realitet nuk na nevojitet që tjerët të na vërtetojnë. Bëje listën e cilësive të tua të mira e të këqija, e pastaj analizo ç'është e mirë, e ç'është e keqe! Pastaj provo që t'i përparosh të mirat, ndërsa t'i mënjanoj anët e këqija të personalitetit tënd.

2. Mëso ta kontrollosh veten

Njerëzit të cilët hulumtojnë për famë dhe popullaritet janë të kyçur në paraqitjen kompulsive (nevojë e papur për paraqitjen e veprimeve të panevojshme të cilat personi i përjeton si të dhunshme) dhe lajkime. Kur të na vijnë mendime kompulsive duhet të pyesim a thua këto vepra janë të vlefshme të harxhojmë kohën tonë, apo ato me të cilat kërkojmë kënaqësinë e Zotit. Harxhimi i kohës në internet shkakton rënien e produktivitetit tonë. Kur bëhet fjalë për teknologji dhe medie shoqërore, duhet të kemi disiplinë që do të na sjellë shumë dobi. Kjo nënkupton të keni dëshirë të fortë dhe të sillni vendim që të tjerët mos të përzihen në jetën tuaj. Të shqelmosh rrjetet shoqërore nuk është punë e lehtë.

3. Të kesh qëllime të definuara dhe të pastra

Derisa bëjmë forma të ndryshme të ibadeteve duhet të kemi qëllim krye-

sisht që të fitojmë kënaqësinë e Zotit e jo syfaqësinë. Duhet me qenë të kujdesshëm që veprat mos të na refuzohen për shkak të qëllimeve të gabuara. Kontrolloni qëllimet tuaja duke menduar për vetveten. Vërtetoni cilat qëllime janë të pastërta, çdoherë kur bëni ndonjë vepër, vendosni qëllimin tuaj qendror që çdo gjë që bëni le të jetë për hir të Zotit.

4. Udhëhiqni kohën

Për të zvogëluar harxhimin e kohës në internet dhe rrjetet shoqërore, duhet ta rregulloni kohën që këto faqe mos t'i hapni atë ditë, pas një kohe. Kohën e lirë harxhoni në gjëra të dobishme sikur mësimi për Islamin, kërkimi i diturisë së dobishme, gjërave produktive dhe shfrytëzimin e kompetencave tuaja për mirëqenien e komunitetit ku jetoni. Njëherë kur vendosim këtë qëllim do të tërhiqemi nga bota e rrjeteve shoqërore, do të qasemi në jetën reale. Ndoshta bile edhe do të harrojmë që kemi pasur profil në rrjetet shoqërore.

Konkludim

Në momentin kur disa gjëra të gabuara në një shoqëri bëhen një kohë të gjatë, ato bëhen normë dhe protokoll i sjelljes. Kërkimi i vëmendjes në rrjetet shoqërore gjithashtu është bërë normë në shoqëri pa marrë parasysh efektet e dëmshme të këtij fenomeni. Të gjithë duhet të përpiqemi që ta ndërpresim këtë rreth vicioz.

Nëse dëshirojmë që të tërheqim vëmendjen atëherë le të përpiqemi ta tërheqim vëmendjen e banorëve të qiellit. A ka publik më të mirë se ata?

“Kur Allahu e do një rob të Tij, e thërret melekun Xhibril a.s. dhe i thotë: “Unë e dua filan, filan robin Tim, edhe ti duaje! Dhe Xhibrili e do. Pastaj Xhibrili i thërret banorët e qiellit (melekët) dhe u thotë: “Allahu e do filan, filan robin e Tij, edhe ju duani! Dhe ata e duan. Pastaj kjo dashuri lëshohet edhe në Tokë dhe ky njeri pranohet edhe nga njerëzit”. (Buhariu).

Burimi: www.akos.ba

Përkthye dhe përshtati: Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

Dr. Besim Arbanashi

Besimi në botën e ahiretit si motiv për një jetë më të mirë

Njeriu, e vetmja krijesë fizike të cilën e preokupon e ardhmja dhe fundi final i tij. Ai është kureshtar të dëgjojë e të dijë rreth rrjedhës së ndodhive pas përfundimit të tij nga kjo botë

Mëshira e Allahut nuk e la krijesën njeri në enigmë e të hutuar në lidhje me jetën e pastajme dhe ngjarjet e saja, madje jo vetëm që e njoftoi me atë jetë por edhe ia ilustroi detajet e saja në mënyra dhe peisazhe të ndryshme. Bile njohuritë e asaj jete dhe përjetimet e saja ia bëri myslimanit pjesë të fesë dhe kusht nga kushtet esenciale të besimit. Ky kusht është aq i rëndësishëm sa që gati ku do që përmen-det në Kur'an e hadith, besimi në Zotin, i bashkangjitet edhe besimi në jetën e pastajme.

Besimi në botën e ahiretit i jep kuptim jetës së njeriut ngase nepërmjet këtij besimi ai e kupton qëllimin e jetës në dunja.

Pa një besim të tillë njeriu do të ndjente një zbrazëti, madje edhe kotësi të kësaj jete, prandaj ky

besim është i rëndësishëm së veçantë për njeriun.

Nga mirësitë e këtij besimi, është edhe ajo se njeriu arrin të kuptojë që jeta e kësaj bote është kalimtare, dhe se ajo merr kuptim vetëm po që se shfrytëzohet si mekanizëm nëpërmjet të cilit arrihet të fitohet mirësia e botës tjetër.

Besimi në botën
tjetër shton ndjenjën
e përgjegjësisë së
individit

Njeriu që beson se me vdekje nuk mbaron gjithëçka, por se ai kalon në një fazë të "marrjes në pyetje", domosdo është më i vëmendshëm në jetën e kësaj bote, dhe gjithëçka që vepron e bën me vetëdijen se ato nuk shkojnë së koti, mirëpo i nënshtrohen një shqyrtimi që do të vlerësohet në botën tjetër. Kjo ngulit te besimtari ndjenjën e përgjegjësisë për veprimet e veta. Allahu xh.sh. thotë: "A mos mendon

njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë (pa kurrfarë përgjegjësie)."¹

Kush është i bindur në botën tjetër dhe beson në të fuqishëm, pa dyshim se do të veprojë punë që shfaqin rrespekt ndaj Allahut, do të motivohet për to, do të ikë nga mëkatet dhe punët e liga duke e jetuar kështu jetën e tij fisnike dhe të lumtur.²

Ai që arrinë të kuptojë se çfarë është përgatitur për besimtarët nga mirësitë dhe kënaqësitë e përhershme, pa dyshim që i tilli nuk e konsideron jetën e kësaj bote si gjithçka, është i bindur se ajo është e përkohshme dhe paraqitet në të si asket. I tilli synon ta fitojë botën tjetër, e cila meriton të veprohet për të, të lodhemi për të dhe të derdhet kontribut për hir të saj. Në Kuran qëndron:

"E, përgëzoji ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në xhennete në të cilët rrjedhin lumenj. Sa herë që u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Ky është që me te u ushqyem edhe më parë". Ngase, u silltet ushqim i ngjashëm (vetëm në formë, e jo edhe në shije). Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë."³

Besimi në botën tjetër dhe ndikimi i tij në jetën sociale:

Në sferën e jetës sociale, solidaritetit, mirëkuptimit, tolerancës e bashkëjetesës, besimi në botën tjetër është ndër indikatorët më të rëndësishëm pozitiv. Kjo lidhet me porosinë fetare se njeriu nuk është përgjegjës vetëm për raportin e tij personal me Krijuesin, por se atë e presin edhe përgjegjësi ndaj mesit ku jeton e vepron. Madje, shem-



buj nga literatura islame shënjojnë se përmes kujdesit ndaj të tjerëve dhe sjelljes së mirë sociale, njeriu mund të fitojë Xhennetin (duke pasur para-prakisht qëllime të tilla). Në këtë kuptim, kjo shënon një motiv shtesë për rindërtimin e sjelljeve sociale. Thotë Allahu xh.sh. në Kuran: “Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t’i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve dhe pasurinë që e do ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të singërtit dhe të tillët janë ata të devotshmit.”⁴

Besimi në botën tjetër motivim ndaj sfidave dhe sprovave të dynjasë

Në konceptin fetar islam, sfidat dhe sprovat janë një testim që u bëhet besimtarëve për të shpalosur ata besimin e tyre ndaj Zotit Fuqiplotë dhe për të demonstruar fuqinë shpirtërore për ballafaqim me atë që vjen nga ana e Krijuesit. Ky testim është i atillë që besimtarin e radhit në taborrin e durimtarëve dhe të të shpëtuarve, varësisht nga përceptimi dhe sjellja në raport me sprovën. Besimi se në botën tjetër do të shpërblehet durimi ndaj sprovave apo do të fshihet “sevapi” që do të fitohej përmes sprovës, motivon besimtarët që të jenë të durueshëm dhe t’i tejkalojnë sfidat me një bindje të fortë në atë që qëndron mbi sprovën dhe tej sprovës.⁵

Pa një sprovë të tillë nuk do të arrihej shpërblimi i madh në botën tjetër në saxe të përballimit të tyre me durim, siq thotë Allahu xh.sh. në Kuran: “Ne do t’ju sprovovmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, por ti përgëzoji durimtarët. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndëshme thonë: “Ne

jemi të All-llahut dhe ne vetëm te Ai kthehemi!” Të tillët janë ata që kanë bekime prej Zotit të tyre dhe mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit.”⁶

Pos tjerash, sprovimet e kësaj bote në raport me jetën tjetër sjellin edhe dobi të tjera, si:

- Shlyerje e mëkateve.
- Ngritje e gradave të xhenetit.
- Shijim i ndjenjës së nevojës për mbështetjen te Zoti i Madhërishëm.
- Hapje e dyerve të pendimit, nënshtrimit dhe përluljes ndaj Tij xh.sh.
- Pasje në kujtesë e njerëzve të sprovuar dhe dhembshuria ndaj tyre.
- Forcim i bindjes në vendimin dhe caktimin e Allahut xh.sh.
- Njohje me realitetin e njëmendtë të kësaj jete.⁷

Besimi në botën tjetër dhe ndikimi i tij në kontekstin psikologjik

“Fundit” në mendimin njerëzor zakonisht mbjell trishtim, frikë e pasiguri, por jo edhe te besimtarët, të cilët një fenomen të tillë e marrin si normal. Aq më tepër kur flitet për fund jetësor. Besimi në botën tjetër, si vazhdim i jetës dhe si jetë e pas “dynjasë”, motivon një siguri dhe qetësi të rëndësishme për stabilitetin psikologjik.

Në lidhje me këtë Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”⁸

Tashmë nuk është frika te “fundit” por te ajo se çka kemi vepruar nga mirësitë për ta fituar shpërblimin e përjetësisë? Besimi në vazhdimësinë e ekzistencës në një trajtë tjetër dhe mohimi i fundit jetësor, është një lloj shprese që lë ndikim pozitiv në mendimin njerëzor.

Shpresa për shpërblimin në ahiret i mundëson njeriut një jetë të qetë e të rehatshme në këtë botë. Ai nuk dëshpërohet nga mos arritja e shijimit të të gjitha të mirave të kësaj bote,

duke shpresuar në shpërblimin dhe kompenzimin që do t’i dhurohet atij në jetën e pastajme.

Me këtë besim njeriu arrinë që të kënaqet me pak. Në fakt mos ngopja është natyrë e njeriut, ngase i tillë u krujua, por kur ai kujton vdekjen dhe fundin, dhe kupton natyrën e kësaj bote ai kënaqet me pak. E kur njeriu kënaqet me pak, e shijon atë që ka, qoftë ajo edhe e pakët.

Duke besuar në një jetë, e cila është e ndërtuar mbi veprën e njeriut në këtë botë, ajo gjithësesi e motivon atë për punë dhe aktivitet.

Besimi në botën tjetër dhe ndikimi i tij në aspektet morale

Morali i njeriut është një nga mënyrat që, në bazë të konceptit fetar, njeriu e fiton ose e humb lumturinë e përjetshme. Nga këtu, ky besim motivon moral të lartë shoqëror duke thirrur në pastërti etike, për të fituar kënaqësinë e Zotit në këtë botë dhe në botën tjetër.

Muslimani gjithmonë praktikon normat morale dhe largohet nga ato jo morale nisur nga dëshira për shpërblimin dhe frika nga dënimi i Allahut. Kur ai pajiset me moral të mirë është i bindur plotësisht se Allahu do ta shpërblejë atë me një shpërblim të madhë për këtë. Po ashtu e di se ajo është rruga për në Xhennet. Në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a., Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush beson në All-llahun dhe botën tjetër le të mos e dëmton fqinun e tij, kush beson në All-llahun dhe në botën tjetër le të nderojë musafirin e tij, kush beson në All-llahun dhe në botën tjetër le të thotë të mirën ose të hesht”.⁹

1. 75-Kijame: 36. 2. Shib: Abdullah ibn Humejd, “El Iman bil jemmil ahireti ve etheruhu fi hajati el muslimi”, Boton: Daru ibn Huzejme, Rrijad, pa vit botimi. 3. 2-Bekare: 25. 4. 2-Bekare: 177. 5. Shih: Dr. Jusuf Kardavi, “Durimi në Kur’anin Fisnik”, boton Furkan ISM, Shkup 2002, f. 15 – 22. 6. 2-Bekare: 155-157. 7. <http://www.saaaid.net/arabic/119.htm>. 8. 16-Nahl: 97. 9. E transmeton Buhariu në Sahih, hadithi nr. 5672.

Hytbeja e xhumasë i kushtohet formimit të Ushtrisë së Kosovës

Ruajtja e sigurisë dhe rëndësia e saj fetare e shoqërore

Hyrje

Secili shtet mëton t'i ofrojë siguri popullit të vet. Për ta bërë një gjë të tillë sigurisht nevojitet organizimi i një force, e cila duhet të marrë përsipër ruajtjen e popullit. Fetarisht, organizimi i kësaj force nuk është thjesht detyrim shoqëror, por edhe kërkesë dhe detyrim fetar, sepse, në mungesë të sigurisë, nuk mund të zhvillohet lirshëm as jeta fetare. Nga këtu, feja sigurinë e konsideron begatinë më të madhe që ka një shoqëri. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush gdhin duke qenë i sigurt (personalisht dhe familjarisht), i shëndetshëm fizikisht dhe duke pasur furnizimin ditor, ai është sikur t'i jetë dhënë e tërë dynjaja.”

Në këtë hadith flitet për sigurinë e përgjithshme: fizike, shëndetësore dhe materiale, pra për mirëqenien, por siç mund ta vërejmë së pari është filluar me sigurinë fizike, për shkak të vlerës dhe rëndësisë që ka në raport me mirësitë e tjera. Vetëm ata që kanë përjetuar luftëra dinë të bëjnë krahasimin në vlerë dhe rëndësi ndërmjet sigurisë dhe mirësive të tjera.

Feja për rëndësinë e sigurisë

Siguria ka rëndësi të veçantë, sepse pa të jeta nuk ka kuptim. Në mungesë të saj, asnjë formë e jetës shoqërore nuk mund të zhvillohet lirshëm, andaj për të, duhet t'ia dimë Allahut, siç duhet t'ia dimë

Atij edhe për mirësitë e tjera. Allahu në Kuran thotë:

﴿فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ * الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ﴾
 “Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë), 4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.” (El-Kurejsh: 3-4)

Siguria ka rëndësi të madhe edhe për jetën psikike dhe emocionale të njeriut. Muhammedi a.s. lutej shpesh që Zoti ta begatonte me mirësinë e sigurisë, e thoshte:

“...O Allahu im, më mbulo të metat dhe më ofro qetësi e siguri (nga çdo gjë që më frikëson)...”
 Hadithin e transmeton Imam Ahmedi ndërsa Ahmed Shakiri konsideron se ka sened të saktë.)



Siguria shoqërore vjen si rezultat i përmirësimit shoqëror, i ndryshimit për të mirë, i avancimit me të drejtat e qytetarëve, i drejtësisë dhe barazisë shoqërore. Ja çfarë na mëson Kurani:

﴿وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا﴾

“Allahu u ka premtuar atyre prej jush që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojë në siguri....” (En Nur: 55)

Urdhri për të organizuar ushtrinë dhe vlera e ushtarëve

Duke qenë se shtetet kanë miq dhe armiq, atëherë ruajtja e shtetit nuk mund të jetë vullnetare. Për këtë shkak, formimi i ushtrisë dhe përgatitja janë domosdoshmëri, përveç të tjerash, edhe për të frenuar armiqët të cilët duan ta cenojnë

sigurinë tonë. Ja çfarë na mëson Allahu:

﴿وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهِبُونَ بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ وَعَدُوَّكُمْ وَآخَرِينَ مِنْ دُونِهِمْ لَا تَعْلَمُونَهُمُ اللَّهُ يَعْلَمُهُمْ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يُوَفَّ إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ لَا تَظْلُمُونَ﴾

“Përgatitni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë veç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.” (El Enfalë: 60)

Meqë siguria ka kaq vlerë, atëherë edhe ata që e ofrojnë atë kanë vlerë të madhe. Pejgamberi a.s. duke folur për vlerën e tyre thotë: “Dy sy nuk do t’i djegë zjarri i Xhehennemit: syrin që qan nga frika e Zotit dhe syrin që kalon natën duke ruajtur në rrugën e Zotit.”

Pra, Zoti do t’i dallojë me mëshirën e Vet besimtarin e devotshëm dhe ushtarin besnik. I pari kalon natën duke e adhuruar Zotin dhe duke qarë prej frikës së Tij, ndërsa i dyti rrezikon jetën e vet që t’i ofrojë siguri të tjerëve andaj edhe meriton këtë gradim te Zoti.

Përfundim

Sot, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjet për shndërrimin e FSK-ës në ushtri të rregullt. Është një ëndërr jona e kamotshme. Me këtë Kosova merr formë shtetërore më të qartë. Ne, qytetarët, do të ndihemi më të sigurt, më të qetë, sepse kemi ushtrinë tonë e cila na ruan dhe kujdeset për ne, andaj e kemi për detyrim fetar që të mos kursehemi nga lutjet drejtuar Allahut të Lartmadhëruar që ta ruajë vendin dhe popullin tonë, të na begatojë me mirësi e siguri, ta ruajë dhe ta forcojë ushtrinë tonë, t’i begatojë gjithë ata ushtarë me shëndet, forcë, kurajë, guxim e gatishmëri për të qenë gjithmonë në ruajtje dhe shërbim të vendit dhe popullit të tyre.

Përhajr na qoftë ushtria, Zoti e begatoftë me të mira vendin dhe popullin tonë!

**Në të gjitha xhamitë e Kosovës, me rekomandim të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës u ligjërua për ruajtjen e sigurisë dhe për rëndësinë e saj fetare e shoqërore. Kjo vjen si shkak i miratimit të ligjeve për transformimin e FSK-së në Ushtri të rregullt nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.*

Prishtinë, 14 dhjetor 2018



Elma Bojaxhiu - Mehaj,

Ku ta gjejmë qetësinë?!

Kur jemi në vetmi e duam më shumë Zotin.. e ndiejmë thellësisht në shpirt, jo se nuk e duam çdo ditë, jo se nuk e mendojmë çdo herë... por në vetmi dukemi se jemi më afër Madhësisë së Tij.

Atëherë kur shpirti qetësohet, përulet duke e kujtuar vetëm Atë, duke menduar edhe më shumë rreth krijimtarisë së Tij.

Nga mirësitë e Tij mbulohemi çdo ditë dhe s'e kuptojmë, por në çastin e vetmisë e dimë sa pak i mendojmë..

Tani e shoh se yjet shndrisin edhe më shumë, a thua vallë sonte çdo gjë po e ndiejme mall?!

Ah sa pak mundohemi për gjetjen e qetësisë shpirtërore, ndërsa etja shuhet vetëm me kujtimin e Zotit.

Të mos e humbim ilaçin kur e dimë si të shërohemi nga sëmundja. Zbute zemrën me fjalën e Zotit.. shndërroi disa frymëmarrje në punë të mira!

Miqësohu me njerëz që e ndezin dritën brenda vetes çdo natë, duke iu lutur vetëm Atij.

Nëse zemrat na janë ngurtësuar, istigfarin gjuha e ka harruar.

Larg çdo kotësie për shpirtin të jemi, më afër do ta gjejmë Zotin, mbase ashtu tha i Lartësuar “... Unë jam afër...” (El-Bekare)

Në mes të krahavorit tënd, Ai të do.. të do dhe të pret që balli yt të prekë sexhdenë.. që shpirti yt të gjejë qetësinë.

06.10.2018

Atdhe Brahimi

Nënës

*Sa të jesh gjallë do të të dëgjoj,
kur të vdesësh do të të kujtoj,
lutje për ty do të bëj
që Zoti shpirtin tënd ta mëshirojë,
kështu më mëson feja ime e vërtetë,
që thotë se nën këmbët e nënës
është i bukuri Xhennet.*

Ilmi Rexhepi

Po t'vjen era, msuese, si e nanes teme¹

Gënjente mësuesja kur thoshte
 “Ju dua të gjithë!”,
 Tedin e vetmuar e të parregulluar
 E urrente dhe nuk e donte hiç

Kur merrte hartimet
 Ajo duke i kontrolluar
 Me inat Tedit ia shkruante iksat
 Dhe duke u shfryrë notën “pamjaftuar”

Kështu gjersa një ditë
 Drejtori kishte urdhëruar:
 Lexojini, të nderuar mësues
 Vlerësimet për nxënësit tuaj!

Çuditet mësuesja
 Me këtë Tedin e urryer
 Se në vlerësim gjen të shkruar
 Në klasë të parë qenkësh i shkëlqyer

Zbutet mësuesja
 Kur mëson për Tedin e zi
 Se duke qenë ai në klasë të dytë
 Me kancer i ishte sëmure nëna e tij

Pendohet mësuesja
 Për Tedin e pashoqëruar
 Kur mëson se në klasë të tretë
 atij nëna e vet jetë i paska ndërruar

Për klasën e katërt mësuesja
 E diti hala pa e lexuar
 Se Tedi ma
 As i shkëlqyer, as i rregulluar

Dhe vjen dita kritike
 Ditëlindja e saj
 Dhurata i sjellin nxënësit

Të gjitha të shkrira në ar

Të gjitha, thuaaja,
 Se pati përjashtim,
 Tedi i dhuroi veç një kuti,
 Dhe, si ai, me ngurrim

Seç qeshën nxënësit
 Dhe gazi atyre edhe më shumë iu shtua
 Kur nga kutia e Tedit mësuesja po nxirrte
 Gjerdan me rruaza mangu dhe parfum gati të
 harxhuar

Po mësuesja e çmoi më së shumti
 Se menjëherë e mori vesh
 Që Tedi i kish' sjellë dhuratë
 Kutinë e nënës së vet

Vendosi gjerdanin në qafë
 E u lye me atë parfum,
 Si juve tash, mësueses dhe Tedit atëherë,
 Fytyrat iu mbushën me lot si lumë

Po nuk u shkoq atë ditë Tedi prej shkolle
 Priti mësuesen te dera si zog në degë peme
 S'mujti me shkue pa i than':
 Po t'vjen era, msuese, si e nanes teme!

Shkëlqeu pastaj Tedi
 Edhe me shokë u shoqërua
 Vazhdon historia e tij
 Kur për kirurg u diplomua

1. Kthim në poezi i tregimit të njohur për Tedin

Myftiu Tërnavë mori pjesë në forumin për promovimin e paqes në Abu Dabi

Prishtinë, 4-7 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij, mori pjesë në Forumin e Pestë Ndërkombëtar të Promovimit të Paqes në Shoqëritë Islame, me titullin “Aleanca e virtyteve, mundësi për paqen globale”, që u mbajt në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe. Ky është forumi i pestë për promovimin e paqes në shoqëritë islame, zgjati nga data 5 deri më 7 dhjetor. Në këtë forum morën pjesë më shumë se 800 dijetarë dhe mendimtarë me ndikim në botë nga 120 vende, përfshirë këtu ministra të Punëve Fetare, myftinj, përfaqësues nga komuniteti mysliman, si dhe delegatë nga Kombet e Bashkuara dhe organizatat e të drejtave të njeriut në mbarë botën. Studiuesit dhe intelektualët diskutuan metodologjinë e krijimit të një aleance virtytesh për të arritur një diskurs botëror të miqësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, bazuar në vlerat dhe virtytet e përbashkëta.

Ky forum u organizua nën patronazhin e Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, më konkretisht

nga Ministria e Punëve të Jashtme. Në ceremoninë e hapjes ishte prezent ministri i Punëve të Jashtme dhe i Bashkëpunimit Ndërkombëtar të EBA-së, sheiku Abdullah bin Zajed. Krahas personaliteteve nga e gjithë bota, në këtë forum mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij.

Fjalimin e parë në këtë ceremoni hapëse e paraqiti ambasadori për Liritë Fetare i SHBA-së, z. Sam Brownback, i cili në fjalën e tij veçoi përkushtimin dhe angazhimin e presidentit Trump, zëvendës-presidentit Pens, si dhe sekretarit të SHBA-së, z. Pompei, për liritë fetare anekënd botës, duke theksuar faktin se SHBA-ja nuk do të tolerojë diskriminimin në baza fetare. Ai gjithashtu ftoi liderët fetarë që të promovojnë paqen, tolerancën në xhamitë, kishat, sinagogat dhe vendfajlet e tyre.

Më pas para të pranishmëve për një fjalë rasti u paraqit kryetari i këtij forumi, dijetari i mirënjohur i botës islame, z. Abdullah bin Bejja, i cili u fokusua në përqendrimin dhe forcimin e paqes, duke luftuar

çdo lloj të ekstremizmit dhe radikalizmit. Ai ftoi në mënyrë të veçantë mediet që të luajnë rolin e tyre në parandalimin e dhunës.

Në hapje të këtij forumi folën edhe sekretari gjeneral i Ligës së Botës Islame, dr. Abdulkerim al Isa, kryetari i universitetit të Azharit, dr. Muhamed al Muharsavi, ministri për Çështje Fetare i Egjiptit, z. Muhamed Xhuma, këshilltari i sekretarit gjeneral të OKB-së për parandalimin e gjenocidit, dr. Adama Diang, këshilltari i emirit të Kuvajtit, dr. Abdullah Matuk, i cili i njohu të pranishmit me fillimin e realizimit të iniciativës “Ofrimi i ushqimit për 1 miliard nevojtarë”. Ai tha se kjo iniciativë kapi shifrën e papritur për ushqimin e 2.5 miliardë nevojtarëve anekënd botës përmes projekteve të ndryshme. Gjithashtu në këtë ceremoni u paraqitën edhe rabini David Rosen dhe znj. Sara Khan nga Britania e Madhe. Gjatë kësaj ceremonie u dha edhe çmimi “Imam Hasan” për paqe për vitin 2018, i cili iu nda dy presidentëve, atij të Eritresë dhe të Etiopisë, në shenjë përkushtimit dhe nënshkrimit të aktit të paqes mes dy shteteve. (R.S & B.M)



Myftiu Tërnavë vizitoi Ambasadën e Kosovës në Abu Dabi

Prishtinë, 6 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef.Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij, vizitoi Ambasadën e Republikës së Kosovës në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe. Myftiu u mirëprit nga i ngarkuari me punë në këtë ambasadë, z. Amir Ahmeti, i cili pasi i dëshiroi mirëseardhje Myftiut Tërnavë, e njohu atë përkitazi me aktivitetet e ambasadës në shtetin e EBA-së.

Ai falënderoi përzemërsisht Myftiun Tërnavë për këtë vizitë duke i dëshiruar qëndrim të këndshëm në Abu Dabi, si dhe falënderoi atë dhe institucionin e BIRK-ut për ndihmën që po jep në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës në Kosovë. Nga ana e tij, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, fillimisht e uroi për hapjen e ambasadës e më pas e falënderoi z. Ahmetin për pritjen dhe theksoi se BIRK-u vazhdimisht ka

dhënë kontribut për të gjitha proceset në të cilat ka kaluar Kosova deri më tani dhe do të japë edhe më kontribut dhe se marrëdhëniet e Kosovës me botën arabe do të intensifikohen për realizimin e projekteve në dobi të qytetarëve të Kosovës. Myftiu Tërnavë çmoi përkrahjen që kanë dhënë këto vende në veçanti EBA-në për integrimin e Kosovës në mekanizmat rajonalë dhe ata ndërkombëtarë. (R,S& B.M)



Myftiu Tërnavë u prit në takim nga Abdulla bin Beyya

Prishtinë, 7 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef.Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij, u prit në takim nga sheiku Abdulla bin Beyya, kryetar i Forumit Ndërkombëtar të Promovimit të Paqes në Shoqëritë Islame. Në këtë takim, Myftiu Tërnavë, falënderoi kryetarin Abdulla bin Beyya për kontributin e tij në arenën ndërkombëtare dhënë për promovimin e paqes, e më pas e njohu me punën dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Myftiu Tërnavë çmoi përkrahjen që ka dhënë populli dhe Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe gjatë dhe pas luftës, si dhe falënderoi atë për realizimin e shumë



projekteve në të mirë të qytetarëve. Kosova është shumë mirënjohëse për këto ndihma dhe për përkrahjen që po jep EBA-ja në

arenën ndërkombëtare për integrimin e Kosovës në mekanizmat rajonalë dhe ata ndërkombëtarë. (R,S& B.M)

Myftiu Tërnavë merr pjesë në Forumin për promovimin e paqes në shoqëritë islame në Abu Dabi

Prishtinë, 8-9 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij, mori pjesë në forumin për promovimin e paqes në shoqëritë islame që u zhvillua në Abu Dabi më 8-9 dhjetor me temën “Adresi-mi i sfidave globale: Të menduarit

dhe veprimi së bashku”. Këtë konferencë e organizoi Këshilli Evropian për Liderët Fetarë. Në këtë konferencë një fjalë rasti pati edhe Myftiu Tërnavë. Diskutantët kanë diskutuar në punëtori duke kontribuar me ide dhe mendime të ndryshme në lidhje me temën në fjalë. Në këtë konferencë me studiues nga

e tërë bota u diskutua dhe trajtua roli dhe përgjegjësia e liderëve fetarë në shoqëri në përgjithësi. Po ashtu vend të rëndësishëm në këtë diskutim zuri edhe roli dhe përgjegjësitë e liderëve fetarë në çështjet e migrimit dhe kundër urrejtjes. (R.S& B.M)



Myftiu Tërnavë u prit në takim nga drejtori i Fondacionin “Muhamed bin Rashid Al-Maktoum”, z. Saleh Zaher

Prishtinë, 10 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij, vizitoi Fondacionin “Muhamed bin Rashid Al-Maktoum”, ku u prit në takim nga drejtori gjeneral, z. Saleh Zaher në Dubai. Z. Zaher falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën, duke theksuar se institucioni i tij ka një bashkëpunim shumë të ngushtë dhe të mirë me BIRK-un dhe është i përkushtuar për zgjerimin e bashkëpunimit me BIRK-un.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi nikoqirin për pritjen dhe theksoi se thellimi i bashkëpunimit me këtë institucion është shumë i rëndësishëm. Myftiu po ashtu falënderoi qeverinë e Dubait për përkrahjen



dhe mbështetjen e dhënë për BIRK-un, për realizimin e shumë projekteve. Myftiu Tërnavë po ashtu falënderoi edhe qeverinë dhe popullin e Emirateve të Bashkuara Arabe për ndihmën e pakursyer që i kanë dhënë popullit të Kosovës para, gjatë dhe pas luftës. Gjatë takimit të dy palët u dakorduan për realizimin e disa projekteve vakëfore për nevoja të BIRK-ut. (R.S& B.M)

Myftiu Tërnava mori pjesë në konferencën islame globale “Uniteti Islam – Rreziqet e etiketimit dhe përjashtimit”, që u mbajt në Mekë

Prishtinë, 12 dhjetor 2018

Nën patronatin e mbretit të Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz Al Saud, në Mekë u mbajt konferenca islame globale me temën “Uniteti Islam – Rreziqet e etiketimit dhe përjashtimit”, nën organizimin e Ligës Botërore Islame -RABITA.

sekretari gjeneral dr. Muhamed Abdul Kerim Al Isa, i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit të cilët iu përgjigjën ftesës së RABITAS dhe theksoi se ky tubim global është një shpresë e madhe për unitet. Ai theksoi se pas hulumtimeve është konstatuar se mungesa e dialogut të singurtë dhe të respektuar dhe e

saudit bëri thirrje të hulumtohen dhe të luftohen të gjitha shkaqet që nxisin këtë fenomen.

Në emër të mbretit të Arabisë Saudite foli këshilltari special dhe emiri i Mekës, Halid Al Fejsal. Duke i përshëndetur të gjithë pjesëmarrësit dhe duke u dëshiruar mirëseardhje në këtë konferencë të



Hapja e konferencës filloi me lexim të Kuranit nga dr. Muvafak Dejlemi. Fjalën hyrëse e mbajti Myftiu i Libanit dr. Abdulatif Fajez Derjan, cili theksoi rëndësinë e kësaj konference globale, se Bota Islame sot po ballafaqohet me një kërcënim serioz nga këto dy çështje të cilat shkaktojnë përçarje në mes të Ummetit. Ky takim global synon ofrimin dhe bashkëpunimin mes myslimanëve anekënd botës.

Në fjalën e tij Sekretari Gjeneral i OBI-së dr. Jusuf Al Uthajmin shpallosi aktivitetet dhe aktet e ndërmara në nivel politik dhe global për të thirrur për unitet dhe bashkëpunim, duke theksuar themelimin e shumë mekanizmeve dhe institucioneve në nivel global.

Në hapjen e konferencës foli edhe

bashkëbisedimit është një prej shkaktarëve të përçarjes, gjithashtu etiketimi i padrejtë është një shkak tjetër për përçarje.

Ai njoftoi se kësaj ftese iu përgjigjën delegacione zyrtare nga më shumë se 127 shtete. Ai shpallosi aktivitetet e kësaj organizate globale të ndërmara kundër këtyre dy fenomeneve dhe rolit të tyre në përçarjen e unitetit islam, dhe kërkoi që konferenca të dalë me kontribut të madh kundër kësaj dukurie të rrezikshme.

Pastaj fjalën e mori Myftiu i Arabisë Saudite, Abdul Aziz Al-Sheikh, cili theksoi rëndësinë e kësaj konference duke u përqendruar në citatat kuranore dhe thëniet profetike që thërrasin për unitet dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Myftiu

rëndësishme, ai përcolli edhe përshëndetjet e mbretit Selman bin Abdulaziz Al Saud. Theksoi se Arabia Saudite është e përkushtuar për unitet dhe bashkëpunim.

Gjatë ceremonisë hapëse folën edhe Kryetari i Këshillit të lartë për Fetva në Algjeri dr. Bu Abdullah Muhamed Gulam, Myftiu i Egjiptit dr. Shevki Alame, sekretari, kryetari i Këshillit të Emirateve për Fetva Abdulla bin Bejah, Myftiu i Saudisë, Abdul Aziz Al Sheikh. Myftiu i Saudisë tha se uniteti është një nga themelet bazë të këtij umeti, i cili bashkohet në adhurim të Allahut Një, i Cili na porosi ti në ajete të shumta për unitet, gjithashtu edhe porositë profetike të shumta të cilat ftojnë për unitet dhe ndalojnë përçarjen. Konferen-

ca zgjati dy ditë.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef.Tërnavë, mbajti një fjalim në Konferencën e Ligës Botërore Islame me temën “Uniteti Islam – Rreziqet e etiketimit dhe përjashtimit”, e cila u mbajt në Mekë të Arabisë Saudite. Myftiu Tërnavë tha para të pranishmëve se ndodhet këtu

për të folur për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e unitetit islam nga këndvështrimi fetar. Ai specifikoi se takimet e tilla të këtij niveli janë një element shtytës i fortë që të japim edhe më shumë kontribut për përhapjen e kulturës së afrimit në shoqëritë tona, në të njëjtën kohë duke tërhequr vërejtjen nga logjika e përjashti-

mit dhe ekstremizmit.

Krejt në fund ai falënderoi mbretin e Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz Al Saud, si dhe sekretarin gjeneral të RABITA-sdr. Muhamed Abdulkerim al Isa për organizimin dhe ftesën.

Në këtë konferencëmorën pjesë delegacione zyrtare nga më shumë se 127 shtete. (R.S).

Myftiut Tërnavë i hapen dyert e Qabesë

Prishtinë, 13 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef.Tërnavë, është zgjedhur në mesin e 20 personaliteteve për t’u falur në brendësinë e Qabesë. Ai u përzgjodh në mesin e 1200 personaliteteve nga 127 shtete, të cilat kanë marrë pjesë në Konferencën e Ligës Botërore Islame. Kjo është hera e parë që një myfti nga Kosova falet në brendësinë e Qabesë.



Myftiu Tërnavë u prit në takim nga sekretari i përgjithshëm i Rabitas, Al Isa

Prishtinë, 14 dhjetor 2018

Delegacioni i BIK-ut në krye me Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnavën, që mori pjesë në konferencën islame globale “Uniteti Islam – Rreziqet e klasifikimit dhe

përjashtimit”, e cila u mbajt në Mekë, nën patronatin e mbretit të Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz Al Saud, organizimin e së cilës e ka bërë RABITA; është pritur në takim zyrtar të veçantë nga

sekretari gjeneral dr. Muhamed Abdul Kerim Al Isa.

Nikoqiri falënderoi shumë Myftiun Tërnavë për pjesëmarrjen e tij në këtë konferencë duke falënderuar edhe për kontributin e tij gjatë



konferencës me kumtesën e tij. Ai gjithashtu çmoi lart aktivitetin e BIK-ut dhe çmoi lart gjithashtu edhe bashkëjetesën dhe tolerancën që promovon BIK-u, dhe me të cilën veçohet populli shqiptar.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë në emër të delegacionit falenderoi nikoqirin për mikpritje dhe e përgëzoi sekretarin gjeneral të RABITAS për suksesin e kësaj konfer-

ence globale.

Gjithashtu Myftiu e njohu nikoqirin me zhvillimet e fundit në Kosovë me theks të veçantë me aktin e formimit të Ushtrisë së Kosovës si forcë sigurie e paqeje për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Nikoqiri e uroi Myftiun Tërnavë për këtë akt kaq të rendesishëm duke i dëshiruar Kosovës dhe popullit të saj prosperitet, siguri dhe mirëqenie.

Ai gjithashtu shprehu gatishmërinë e RABITAS për thellim bashkëpunimi me BIK-un për realizimin e projekteve të ndryshme.

Myftiu Tërnavë gjithashtu uroi dr. AL Isa për çmimin e fituar për "Mesatarizëm", duke çmuar shumë lart rolin dhe aktivitetet e RABITAS në ofrimin e një qasjeje tolerante dhe mesatare. (R.S&B.M)

U mbajt mbledhja e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës

Prishtinë, 20 dhjetor 2018

Më 20.12.2018, u mbajt mbledhja e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Mbledhjen e hapi kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef.Tërnavë, i cili u uroi

mirëseardhje anëtarëve të Kryesisë dhe luti Zotin që t'u japë shëndet dhe punë të begatshme. Në rend të ditës së kësaj mbledhjeje ishin leximi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kryesisë,

shqyrtimi dhe miratimi i projektbuxhetit të Kryesisë së BIRK-ut për vitin 2019, shqyrtimi dhe miratimi i projektbuxheteve të këshillave të BI-së për vitin 2019, si dhe lëndë të tjera. (R.S).



Myftiu Tërnavë priti në takim atasheun për çështje fetare në Ambasadën e Turqisë z. Nevzat Akin

Prishtinë, 24 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim atasheun për çështje fetare në Ambasadën e Turqisë z. Nevzat Akin. Myftiu

Tërnavë fillimisht e falënderoi atasheun për vizitën, më pas e njohu me punët dhe funksionimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Nga ana e tij, atasheu Nevzat Akin falën-

deroi Myftiun Tërnavë për pritjen si dhe shprehu gatishmërinë që edhe më tej të intensifikohet bashkëpunimi me Bashkësinë Islame të Kosovës. (R.S).



Myftiu Tërnavë priti në takim kryetarin e Odës së Avokatëve të Prishtinës z. Nasuf Hasani

Prishtinë, 24 dhjetor 2018

Myftiu Naim ef.Tërnavë, priti në takim kryetarin e Odës së Avokatëve në Prishtinë, Nasuf Hasanin. Në këtë takim, Myftiu Tërnavë i njohu mysafirët përkitazi me organizimin dhe funksionimin e BIRK-ut si dhe për aktivitetet dhe rolin që ka ky institucion në frymën e zhvillimeve të përgjithshme të Kosovës.

Nga ana e tij, kryetari i Odës së Avokatëve –dega Prishtinë, Nasuf Hasani, shprehu falënderime për përmikpritjen dhe çmoi kontributin e Myftiut Tërnavë për tolerancën dhe bashkëpunimin që kanë komunitetet fetare



në Kosovës dhe rolin e BIRK-ut për një Kosovë të qetë dhe stabile. Ai po ashtu uroi Myftiun Tërnavë

va me rastin e zgjedhjes Myfti i BIRK-ut, duke i dëshiruar shëndet dhe sukses në punë. (R.S).

Ministri i Mbrojtjes z. Rrustem Berisha priti në një takim Myftiun Tërnavë

Prishtinë, 26 dhjetor 2018

Myftiu Tërnavë falënderoi ministrin për pritjen dhe shprehu gëzimin që Kosova arriti të formojë ushtrinë, e cila është garanci e fortë për paqen dhe sigurinë e vendit tonë dhe rajonit dhe theksoi se BIK-u ka kontribuar në të kaluarën dhe do të kontribuojë për forcimin e ushtrisë. “Zoti ju ndihmoftë në rrugën tuaj për ndërtimin e kapac-

iteteve të plota ushtarake. Na ka gëzuar pa masë edhe përkrahja e miqve tanë ndërkombëtarë në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe miqtë e tjerë të shtetit tonë”- tha Myftiu Tërnavë. Ministri falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe theksoi se kjo vizitë është shumë domethënëse dhe që do t'i shërbejë zhvillimit dhe

ecjes përpara të proceseve shtetformuese të Kosovës, dhe se roli i BIK-ut është shumë i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë në Kosovë. Ministri Berisha theksoi se ushtria e Kosovës do të jetë forcë paqësore që do t'u dalë në ndihmë dhe përkrahje të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. (R.S)



Myftiu Tërnavë priti në takim përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë z. Suat Faruk Giray

Prishtinë, 26 dhjetor 2018

Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë z. Suat Faruk Giray, i cili po viziton Kosovën me qëllim të dorëzimit të tri objekteve të perfunduara nga Drejtoria e Vakëfeve, të cilat janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit me Bashkësinë Islame të Kosovës. Myftiu Tërnavë e falënderoi Drejtorinë e Vakëfeve të Turqisë për realizimin e projekteve me rëndësi të veçantë sidomos në fushën e trashëgimisë kulturore islame në vend. Z Suat Faruk Giray e njohu Myftiun Tërnavë edhe me planifikimin e punimeve për vitin 2019. (Vedat Sahiti)



Myftiu Tërnavë mbajti hytbe në xhaminë e vjetër në Podujevë

Prishtinë, 28 dhjetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me një pjesë të kabinetit të tij qëndroi në Podujevë ku mbajti hytbenë në xhaminë e vjetër në Podujevë, duke iu drejtuar atyre me këshilla në këtë ditë të madhe dhe duke përçuar mesazhe paqeje. Ai tha se Islami gjithnjë thërret për bashkëjetesë, harmoni, humanitet

e mirësi, duke u larguar nga çdo gjë që shkon në dëm të individit, familjes dhe shoqërisë mbarë. Ai çmoi lart punën dhe angazhimin e kryetarit të KBI-së së Podujevës Osman ef. Kurtolli, si dhe përkushtimin dhe punën e mirë që po bën imami i xhamisë Imri ef. Llugaliu, si dhe xhematin e nderuar.

Ai në këtë hytbe foli për Islamin si fe e vlerave dhe e virtyeteve, duke

thënë se Islami është feja që Zoti zgjodhi për njerëzimin. Është fe e përsosur në mësim dhe porosi, fe objektive kryesore të së cilës është dinjiteti i njeriut, krijesës më të rëndësishme të Zotit.

Namazit të xhumasë i priu krye-imami i Republikës së Kosovës Sabri ef. Bajgora.



Kuvendi i BIRK-ut miratoi buxhetin e Kryesisë për vitin 2019

Prishtinë, 29 dhjetor 2018

Kuvendi i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2019), të cilën e kryesoi dr. Ajni ef. Sinani-kryetar, në rend dite pati shqyrtimin dhe miratimin e projektbuxhetit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës për vitin 2018. Ai falënderoi anëtarët e Kuvendit për kontributin që janë duke dhënë dhe kërkoi që amanetin që kanë nga xhemati ta çojnë në vend pasi ka përgjegjësi para Zoti dhe para popullit.

Në mbledhjen e Kuvendit të BIRK-ut që i pranishëm edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë i shoqëruar nga anëtarët e Kryesisë së BIRK-ut dhe bashkëpunëtorët e

tij. Në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi të gjithë kuvendarët, kryetarët e këshillave të BI-së së Kosovës, administratën, imamët, stafin e Medresesë "Alauddin" dhe Fakultetin e Studimeve Islame për kontributin që janë duke dhënë në zhvillimin dhe avancimin e jetës fetare në Kosovë. Ai tha se në përgjithësi ky vit ka qenë i bereqetshëm dhe i suksesshëm për BIRK-un, pasi që kemi pasur një punë sistematike dhe pa probleme të natyrave të mëdha. Mundohemi vazhdimisht që jeta fetare të avancohet dhe të jetë edhe më aktive dhe më gjithëpërfshirëse në mësimin e bazave të Islamit.

Ai kërkoi që të punohet edhe më

shumë për ngritjen e vëllimit të punëve, që amanetin që kanë marrë përsipër ta kryejnë me përgjegjësi të plotë. Ai tha se është duke punuar shumë për ngritjen infrastrukture të këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe për përmirësimin e jetës së besimtarëve gjithandej Kosovës.

Para kuvendarëve të BIRK-ut, projektbuxhetin e paraqiti drejtori financiar Kasim ef. Gërguri, i cili arsyetoi dhe sqaroi projektin e buxheti për vitin e ardhshëm. Pas shqyrtimit, Kuvendi i BI-së së Kosovës me unanimitet miratoi buxhetin e Kryesisë për vitin 2019.

Në mbledhje u shtruan edhe çështje të tjera të ndryshme.



Themelimi i Ushtrisë forcon identitetin tonë shtetëror

Miratimi i ligjeve për FSK-në që e shndërroi atë edhe praktikisht në ushtri, për Kosovën e popullin e saj paraqet një ndër momentet më të rëndësishme në historinë tonë më të re. Me themelimin e Ushtrisë së Kosovës, përveçqë realizohet një ndër idealet e dëshmorëve tanë, vihet në vend një e drejtë e mohuar deri

tash për shtetin dhe popullin tonë. Po ashtu, me themelimin e Ushtrisë, forcohet identiteti ynë shtetëror, si dhe mbrohet e avancohen sovraniteti e integriteti i vendit.

FSK-ja me misionin që ka marrë nga Kuvendi i Kosovës, si dhe me mbështetjen e marrë nga aleatët tanë strategjikë, përveçqë do të jetë garantuëse dhe mbrojtëse e sovranitetit dhe integritetit të vendit, gjithsesi do jetë një faktor stabiliteti në rajon dhe më gjerë. Po ashtu Ushtria e Kosovës do jetë edhe partnere e aleate e NATO-s për ruajtjen dhe garantimin e paqes dhe

sigurisë në botë.

Në këtë ditë të veçantë për Kosovën, edhe një herë përkujtojmë dëshmorët e vendit, urojmë e përgëzojmë popullin e institucionet e Kosovës, urojmë ushtarët, oficerët dhe nënoficerët e parë të Ushtrisë së Kosovës, si dhe falënderojmë sinqerisht aleatët tanë që mbështetën e përkrahën themelimin e ushtrisë së vendit tonë.

Zoti e bekoftë Ushtrinë tonë, Zoti e ruajttë vendin tonë!

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës

Kosova u përfaqësua nga Vedat ef. Sahiti në konferencën ndërkombëtare në Kajro

Më 16.10.2018, në Kajro, u mbajtën punimet e konferencës ndërkombëtare, të organizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm Botëror i Autoriteteve Fetare per Fetva, kryesuar nga Myftinia e Egjiptit, me titull: Përtërirja në Fetva – teoria dhe aplikimi.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të më shumë se 73 shteteve të botës, edhe Koso-

va, gjegjësisht Bashkësia Islame e Kosovës u përfaqësua nga këshilltari i lartë i Myftiut, Vedat ef. Sahiti, i cili është sekretar i Këshillit të Lartë për Fetva të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe anëtar i Këshillit për Fetva të Këshillit të Shteteve të Evropës.

Temat që u trajtuan në këtë konferencë janë nga të gjitha fushat e jetës njerëzore, duke filluar nga ato

shoqërore, ekonomike e politike.

Emrat më eminentë të dijetarëve të fesë islame u paraqitën me kumtesat e tyre dhe, pas diskutimeve, u publikuan konkluzionet në të cilat arriti Këshilli më i Lartë i këtij trupi, i kryesuar nga kryetari i këtij organi, njëherit edhe Myfti i Egjiptit, prof. dr. Shevki Ibrahim Alam-i. (Vedat Sahiti)



Këshilltari i Myftiut Vedat Sahiti mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut

Prishtinë, 14 dhjetor 2018

Me ftesë të Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, me seli në Gjenevë, këshilltari i Myftiut të Kosovës Vedat Sahiti mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga kjo zyrë, në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Liritë Fetare, e cila u mbajt në Colonge të Francës. Kjo punëtori u mbajt me rastin e 70-vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe ka për qëllim gjetjen e mekanizmave ligjorë, forcimin e rolit të bashkësive fetare dhe liderëve fetarë për implementimin, promovimin dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç është



e drejta e besimit, të drejtat e pakicave etj. Në këtë punëtori morën pjesë ekspertë të ndryshëm nga vende të ndryshme të botës. (R.S).

U zhvilluan punimet e Këshillit të Lartë Euroaziatik për Fetva

Prishtinë, 21 dhjetor 2018

Në Stamboll të Turqisë, janë zhvilluar punimet e Këshillit të Lartë për Fetva pranë organizatës së Këshillit Islamik të Euro-Azisë. Në këtë forum nga Kosova mori pjesë këshilltari i Myftiut të Kosovës, z. Vedat Sahiti. Në hapje të punimeve, të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua kryetari i Kryesisë së Çështjeve Fetare në Republikën

e Turqisë, prof. dr. Ali Erbash, i cili shprehu mirënjohje të lartë për përfaqësuesit e shteteve anëtare të këshillit të Euro-Azisë, si dhe për kontributin e tyre në avancimin e studimeve të çështjeve fetare në kohët moderne dhe gjetjen e zgjidhjeve të duhura nën dritën e burimeve të pastra të së drejtës islame. Ky takim do të trajtojë tema me interes të veçantë për besim-

tarët myslimanë të shteteve të organizatës së Euro-Azisë, siç është fusha e metodologjisë së nxjerrjes së fetvave nga institucionet bartëse të çështjeve islame, si dhe trajtimi i disa çështjeve konkrete nga fusha socio-ekonomike në kohët moderne. (R.S)



Delegacioni i Vakëfeve të Turqisë vizitoi Pejën dhe Mamushën

Prishtinë, 28 dhjetor 2018

Këshilltari i Myftiut të Kosovës, Vedat Sahiti, i shoqëruar nga delegacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, në krye me z. Suat Faruk Giray, vizituan qytetin e Pejës dhe atë të Mamushës, për të parë nga afër realizimin e punimeve të projekteve për restaurimin e monumenteve të rëndësishme të kulturës islame në Kosovë.

Ata vizituan objektin e Xhamisë së Çarshisë në Pejë, si dhe Sahat Kullën dhe objektin e Qendrës Islame në Mamushë, të cilat janë duke u restauruar dhe pritet që të përfundojnë gjatë vitit 2019.



Vendoset gurthemeli i xhamisë “Buhara” — Kradolf, Schönenberg, Zvicër

Më 15 shtator me këndimin e tekmbireve dhe të ajeteve kuranore, në mënyrë solemne është vënë gurthemeli i xhamisë “Buhara” në Kradolf, Schönenberg të Zvicrës. Në këtë manifestim morën pjesë drejtori për Diasporë i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, mr. Ekrem Simnica, kryetari i BFI-së të Maqedonisë, haxhi Sylejman Rexhepi, hoxhallarë e shumë qytetarë të tjerë.

Drejtori Simnica përcolli urimet

dhe përgëzimet e kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim Tërnavë, duke theksuar se kjo xhami përpos kryerjes së namazit në të, do të shërbejë edhe si një qendër edukative-arsimore për fëmijët tanë shqiptarë që jetojnë në diasporë. “Xhamitë luajnë rolin e afritit mes myslimanëve dhe rrezatojnë paqe, siguri, tolerancë, respekt ndaj tjetrit, për të jetuar të gjithë në paqe e lumturi”, tha

mes të tjerash drejtori Simnica. Ai po ashtu potencoi se BIRK-u është i përkushtuar që të forcojë dhe të shtojë komunikimin me xhamitë shqiptare në diasporë, me qëllim të bashkërenditjes së aktiviteteve në të mirë të mërgatës sonë.

Vlen të theksojmë se gjatë mbrëmjes në aktivitetin e organizuar u mbledhën 1.184.000 franga zvicerane për ndërtimin e kësaj xhamie. (R.S.& E.S)



Në Troisdorf të Gjermanisë u vendos gurthmeli i xhamisë së re

Më 29 shtator, delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës në përbërje nga drejtori për Diasporë në Bashkësinë Islame të Kosovës mr. Ekrem ef. Simnica dhe dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë dr. Fahrush ef. Rexhepi, mori pjesë në ceremoninë e hedhjes së gurthemelit të xhamisë së re “Ebu Hanife” në qytetin Troisdorf të Gjermanisë..

Në këtë ceremoni, së bashku me një numër të madh të besimtarëve myslimanë nga qyteti i Troisdorfit si dhe nga rrethet e tjera, morën pjesë edhe zv/kryetari i Unionit të Qendrave Islame Shqiptare-Gjermani, Rexhep ef. Sulejmani, drejtori për Diasporë



i BFI-së, dr. Selver Xhemali, Myftiu i Shkodrës Muhamed ef. Sytari, kryetari i komunës së qytetit të Troisdorfit, përfaqësues

të Kishës Katolike dhe të Kishës Protestante, si dhe një numër i madh i teologëve dhe imamëve të xhamive të Gjermanisë.

Drejtori për Diasporë vizitoi xhaminë “Nurul Islam”

Më 30.08.2018, vizitoi xhaminë “Nurul Islam” M.Gladbach, ku përveç tjerash mbajti ligjëratë pas namazit të drekës dhe urojë dhe përshëndeti kryesinë, imamin e nderuar dhe xhematin e kësaj xhamie me rastin e blerjes së objektit për xhami dhe fillimet e akti-

viteve në këtë objekt, drejtori urojë edhe në emrin e BIK-ut në emrin e organeve udhëheqëse të BIK, si dhe në emrin e myftiut Naimef. Ternava, për këtë të arritur madhore ishte mysafir në xhematin e hoxhës së nderuar Besnik Kadriolli, njëherit edhe anëtar në kuadër

të Unionit të Qendrave Islame Shqiptare-Gjermani. Ai falënderoi xhematin për ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm të tyre për vendlindjen dhe për institucionet tona fetare-arsimore: Medresenë “Alauddin” dhe Fakulltetin e Studimeve Islame në Prishtinë. (E. Simnica)



Bashkësia Islame e Kosovës shpërndau 50 çanta me materiale shkollore për fëmijët e Hanit të Elezit

Prishtinë, 3 dhjetor 2018

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, nëpërmjet shoqatës së saj bamirëse “Bereqeti”, shpërndau 50 çanta me materiale shkollore për fëmijët e shkollave fillore të Hanit të Elezit. Realizimi i këtij projekti erdhi si rezultat i bashkëpunimit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Qeverisë së Dubait, respektivisht Organizatës për

Humanitet dhe Bamirësi “Muhamed bin Rashid al Maktum”. Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Hanit të Elezit z. Musa Vila falënderoi Kryesinë e BIRK-ut për këto ndihma, të cilat i quajti shumë të domosdoshme për këta nxënës. Këto çanta u shpërndanë në degët e shkollës “Ilaz Thaçi” në fshatrat Seçisht dhe Krivenik. Vlera e një çante është afër 30 euro.

Nga ana e tij, drejtori i shoqatës “Bereqeti”, z. Fitim Flugaj tha se aksioni i shpërndarjes së këtij donacionido të vazhdojë në tërë territorin e Kosovës, në afro 100 fshatra të thella të Kosovës, më konkretisht në tetë komuna, kryesisht në zonat rurale, me qëllimin e vetëm që këta fëmijë ta ndiejnë vetën të inkurajuar për mësim. (R.S).



Bereqeti organizon takimin vjetor të shoqatës

Prishtinë, 24 dhjetor 2018

Shoqata humanitare bamirëse “Bereqeti” që vepron në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti takimin e saj vjetor. Në këtë takim morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë, drejtori i Bereqetit, Fitim Flugaj dhe koordinatorët lokalë të Bereqetit. Takimi filloi në Medrese, kurse në selinë e Kryesisë u mbajtën fjalimet, kurse promov-

imi me video i aktiviteteve të shoqatës u ndoq nga mediet e vendit.

Fjalën përshëndetëse në këtë takim e mbajti kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim Tërnavë, i cili shprehu mirënjohje për punën dhe aktivitetin humanitar që po bën “Bereqeti”, duke çmuar punën e secilit që ka kontribuar për ecjen para të aktiviteteve të shoqatës “Bereqeti”. Ai, nga ana e tij, po ashtu edhe njëherë rikonfirmoi mbështetjen e

pa rezervë të Kryesisë së BIRK-ut për “Bereqetin” dhe ndihmën në të gjitha projektet e saj në mënyrë që ndihmat dhe aktiviteti humanitar të mbërrijë aty ku ka nevojë. Aipo ashtu ka falënderuar të gjithë bamirësit që i kanë besuar “Bereqetit” dhe kanë sjellë ndihma në mënyrë që këto të arrijnë te familjet nevojtare dhe skamnore dhe te shtresat e ndryshme të shoqërisë me nevojë. (R.S).



U nis grupi i radhës për kryerjen e Umres

Prishtinë, 26 dhjetor 2018

Nën organizimin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, më 26 dhjetor 2018, u nis grupi i radhës për kryerjen e Umres. Ky grup fillimisht do ta vizitojë Mekën, ku do të qëndrojnë 6 ditë, për të vazhduar më pas me vizitat në Medinë, ku do të qëndrojnë 4 ditë. Këtij grupi do t'i prijë drejtori i medresesë së mesme “Alauddin” z. Jakup Çunaku.



Orhan Bislimaj mori titullin akademik: “Doktor i shkencave islame në fushën e akaidit”

Më datë 30.11.2018 (e premte), kandidati Orhan Bislimaj nga Prizreni, e mbrojti me sukses temën e doktoratës në Universitetin Internacional të Novi Pazarit, në Fakultetin e Studimeve Islame në Novi Pazar, me titull: “Statusi i besëtytnive në besimin islam (rasti i Kosovës)”. Komisioni profesional i mbrojtjes, i përbërë nga: prof. dr. Mevlud Dudiç (kryetar), prof. dr. Metin Izeti (mentor), dhe doc. Adnan Ismaili (anëtar), e çmoi lart punën e kandidatit dhe e vlerësoi maksimalisht. Në bazë të statutit të Universitetit, Komisioni, una-

nimisht e shpalli Orhan Bislimaj “doktor i shkencave islame në fushën e akaidit”.

Orhan (Ibish) Bislimaj, është i lindur në Prizren, më 01.09.1977. Në vitin 1997 ka mbaruar Mëdresenë “Alauddin” të Prishtinës – Paralelja në Prizren. Në vitin 2002, ka mbaruar Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Në vitin 2003, ka mbaruar Fakultetin Filologjik – dega e Orientalistikës në Prishtinë. Në vitin 2011, ka mbaruar magjistraturën në Universitetin Shtetëror të Tetovës në Tetovë. Ka botuar 4 vepra autoriale dhe një vepër tjetër

përkthim nga gjuha arabe, kryesisht në fushën e akaidit. Është autor i mbi 70 punimeve profesionale, të botuara në revista të ndryshme, në Kosovë dhe jashtë saj. Pjesëmarrës në disa konferenca dhe sesione shkencore. Aktualisht, është i punësuar në detyrën sekretar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit. Është i martuar dhe ka tre fëmijë. Jeton në fshatin Kobajë, KK Prizren. Me këtë rast, Orhan Bislimajn e urojmë për gradën shkencore të doktoratës, me dëshirat më të mira për shëndet e suksese në jetën akademike. (Faruk Ukallo)



Dua e hatmes në xhaminë e Lumishtës

Me rastin e përfundimit të hatmes së parë të Kuranit në xhaminë e Lumishtës, më datë 15 shtator 2018, nën ombrellën e KBI-së në Malishevë, me një organizim solemn dhe në prezencën e imamëve, xhematit dhe familjarëve të shumtë; u bë Duaja e Hatmes. Pas leximit të Kuranit, programin e hapi imami i xhamisë Xhemajli ef.



Kastrati, i cili u shpreh i gëzuar për rezultatet e arritura dhe falënderoi mualimen, familjarët dhe të gjithë kontribuesit për mbajtjen e rregullt të mësimbesimit në xhami.

Në vazhdim, fjalën e mori kryetari i KBI-së në Malishevë, Xhevat ef. Kryeziu, i cili ndër të tjera tha: “Sot është një ditë historike për KBI-në, xhaminë, xhematin, familjarët dhe të gjithë besimtarët e vendit tonë, sepse me këtë punë dhe angazhim është arritur edhe një ndër qëllimet sublimë të thirrjes islame që është mësimi dhe leximi i drejtë i fjalës së Allahut xh.sh...”, kryetari Kryeziu e përfundoi fjalimin e tij duke falënderuar të gjithë kontribuesit me theks të veçantë mualimen Elmunevere Paqarizin, e cila ka mbajtur mësimbesim të rregullt në këtë dhe në disa xhami të tjera në territorin e KBI-së në Malishevë dhe ka arritur rezultate të rëndësishme në mësimleximin e fjalës së Allahut xh.sh. si dhe në ngritjen e vetëdijes fetare te gjinia femërore duke mbajtur ligjëratat të ndryshme.

Në emër të prindërve fjalën e mori haxhi Resim Morina, muteveli i xhamisë dhe njëri ndër kontribuesit e rëndësishëm për mbarëvajtjen e mësimbesimit në këtë xhami, i cili u shpreh shumë i emocionuar duke theksuar se ky moment është gëzimi më i madh për të dhe për të gjithë familjarët e tjerë. Ai falënderoi të gjithë ata që kontribuan për t'u arritur këto rezultate të mëdha.

Në fund, duan e hatmes e bëri imami i xhamisë së Malishevës Fatmir ef. Krasniqi. Nxënësit të cilët kanë kryer hatme janë: Medina Zogaj, Ezana Zogaj, Edisona Kastrati, Mimoza Kastrati, Mirdit Kastrati, Drilona Paqarizi, Drena Paqarizi, Fatlinda Paqarizi, Besarta Morina, Mentor Morina, Hanife Zogaj, Fjolla Kastrati dhe Altion Kastrati.

Këshilli i Bashkësisë Islame i Prizrenit

Shpall:

KONKURS

Për vendin e lirë të punës:

Kryeimam i Këshillit të BI-së në Prizren.

Kandidati i interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të ketë kryer Medresenë, Fakultetin e Studimeve Islame, në Prishtinë ose jashtë vendit;
2. T'u përmbahet Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, rregulloreve e vendimeve të Kryesisë dhe të Këshillit të BI-së të Prizrenit;
3. Të ketë aftësi komunikuese dhe organizative për çështje fetare;
4. Të jetë i shëndoshë psikikisht dhe fizikisht;
5. Të ketë pesë (5) vjet përvojë pune në Bashkësinë Islame.
6. Të mos ketë vërejtje për punën e tij në të kaluarën;

Krahas kërkesës për punësim, duhen bashkëngjitur edhe këto dokumente:

1. Diploma e Medresës dhe e Fakultetit;
2. Certifikata e lindjes;
3. Certifikata shëndetësore (pasi të pranohet);
4. Certifikata se nuk është nën hetime ose i dënuar (nga Policia e Kosovës);
5. Vërtetimi për përvojën e punës;
6. Deklarata me shkrim se ka për t'i kryer të gjitha shërbimet fetare;
7. Kopja e letërnjoftimit;
8. CV – ja, të dhënat personale, kualifikime ose dëshmi për aftësim profesional

Të gjitha dokumentet të jenë në origjinal!

Vërejtje:

Dokumentet dorëzohen në zyrën e Këshillit të BI-së të Prizrenit.

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në revistën “Dituria islame”.

Këshilli i Bashkësisë Islame i Vushtrrisë

Shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës:

1. Imam, hatib, mual-lim në xhaminë "Haxhi Ejup" në qytet
2. Imam, hatib, mual-lim në xhaminë e fshatit Stanoc i Epërm
3. Imam, hatib, mual-lim në xhaminë e fshatit Bajskë,
4. Imam, hatib, mual-lim në xhaminë e fshatit Begaj
5. Imam, hatib, mual-lim në xhaminë e fshatit Studime e Epërme
6. Imam, hatib, mual-lim në xhaminë e fshatit Reznik,
7. Imam, hatib, mual-lim në xhaminë e fshatit Dumnice e Mesme.
8. Punëtor teknik në administratën e KBI-së së Vushtrrisë.

Për vendet e punës 1-7, kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë të kryer Medresenë, FSI-në ose Fakultetin e Studimeve Islame jashtë vendit (diploma e vërtetuar nga Kryesia);
2. T'u përmbahen Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, rregulloreve dhe vendimeve të Kryesisë dhe atyre të Këshillit;
3. Të kenë aftësi komunikuese dhe organizative për çështje fetare;
4. Të jenë të shëndoshë psikikisht dhe fizikisht;
5. Të mos kenë vërejtje në punë, nëse paraprakisht kanë qenë të punësuar;
6. Të ndërmarrin iniciativë dhe të kenë kreativitet në punë;
7. Të jenë nënshtruar të Republikës së Kosovës,
8. Ndërkaq për vendin e punës nr.8, kandidatit i mjafton të ketë të kryer shkollën e mesme

*Dokumentet e kërkuara:**Krahas kërkesës për punësim, duhen bashkëngjitur edhe këto dokumente:*

- * Diploma e Medresesë dhe e Fakultetit;
- * Certifikata e lindjes;
- * Certifikata shëndetësore;
- * Certifikata se nuk është nën hetime ose i dënuar;
- * Vërtetimi për përvojën e punës;
- * Deklaratë me shkrim se ka për t'i kryer të gjitha shërbimet fetare;
- * CV – ja, të dhënat personale, kualifikimet ose dëshmitë për aftësim profesional;
- * Letërnjoftimi (fotokopje).

*Të gjitha dokumentet të jenë në origjinal!**Vërejtje:**Dokumentet dorëzohen në zyrën e Këshillit të BI-së në Vushtrri. Dokumentet e pakompletuara, si dhe ato që arrijnë pas afatit të paraparë, nuk do të merren në shqyrtim.**Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike, nga dita e publikimit në revistën "Dituria islame".*

Këshilli i Bashkësisë Islame i Suharekës

Shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lirë të punës në KBI të Suharekës

1. Imam, hatib dhe mual-lim në xhaminë e fshatit Samadraxhë K.K. Suharekë
2. Imam, hatib dhe mual-lim në xhaminë e fshatit Bllacë K.K. Suharekë
3. Imam, hatib dhe mual-lim në xhaminë e fshatit Mushtisht II K.K. Suharekë
4. Imam, hatib dhe mual-lim në xhaminë e fshatit Nishor K.K. Suharekë

Kandidati i interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të ketë të kryer së paku medresenë ose FSI-në në Prishtinë, ose fakultetin e studimeve Islame jashtë vendit (diploma e nostrifikuar nga kryesia e BIRK-ut);
2. T'u përmbahet Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, rregulloreve dhe vendimeve të saj dhe atyre të Këshillit;
3. Të ketë aftësi komunikimi dhe organizimi të çështjeve fetare;
4. Të jetë i shëndoshë psikikisht dhe fizikisht;
5. Të mos ketë vërejtje në punën paraprake (nëse ka qenë në punë më parë);

Kandidati krahas kërkesës duhet t'i dorëzojë edhe këto dokumente:

- * Diplomën e medresesë respektivisht të Fakultetit;
- * Certifikatën e lindjes;
- * Certifikatën e mjekut (pasi të pranohet);
- * Certifikatën që nuk është nën hetime;
- * Të ketë aftësi profesionale në komunikim.

*Të gjitha dokumentet të jenë në origjinal!**Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim.**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në revistën "Dituria islame".*

A man wearing a white turban and a dark robe is shown reading a book. He has a mustache and is looking down at the text in the book. Behind him is a large, circular calligraphic emblem on a light-colored wall. The emblem contains stylized Arabic script, including the word 'الله' (Allah) and the phrase 'الحمد لله' (Praise be to Allah).

